


# ETIKA

Revistë edukative - kulturore

Nëntor 2011 • Numri: 44 • E përmuaajshme

Shqipëri: 150 Lek  
Kosovë: 1 Euro  
Maqedoni: 60 Den  
Europa: 2 Euro

## Drejt Qabesë....



# EDITORIAL

Cila është kibla juaj?

Veriu, jugu, lindja, perëndimi, cila?

Drejtimi në hapësirë, i marrë në vete, nuk ka kuptim. Në qoftë se drejtimet shprehin preferencën e besimit dhe të formës së jetës, aty zë fill edhe preferenca për kiblen dhe islami kërkon prej besimtarëve të drejtohen drejt shtëpisë së Allahut.

Ndër punët e para që bën çdo mysliman, kur shkon në një vend të ri, është të gjejë drejtimin e kibles, sepse pas saj vjen menjëherë namazi, që është akti i daljes para fronit të Zotit dhe akti i perceptimit të ekzistencës. Namazi është veprimi, kur ne qëndrojmë pesë herë në ditë gatitë dhe themi: "I përgjigjëm thirrjes Tënde, o Zot!" Namazi është përfaqësimi më kuptimplotë i të qenit rob i Zotit.

Qabeja përfshihet në botën e myslimanit si një realitet krejt i ndryshëm gjatë muajve të haxhit...

Qabeja, së cilës besimtari i drejtohet pesë herë në ditë kur falet, në muajt e haxhit gjendet përpara tij në horizont, gati për ta parë konkretisht me sytë e tij, për t'u rrotulluar si flutura rreth saj dhe për t'u kapur pas kindave të mbulesës së saj...


Qabeja ndodhet aty gjatë gjithë stinëve, orëve, minutave dhe sekondave të vitit, për t'u takuar me ata që i vijnë aty dhe ata që drejtohen drejt saj në namaz.

Sipas asaj që Kurani na mëson, ngado që të drejtohet njeriu, aty do ta gjejë edhe Zotin. Allahu, pa dyshim, nuk ka nevojë t'i caktohet një vend dhe hapësirë për të ekzistuar. Në këtë kuptim, të drejtohesh drejt Qabes, nuk do të thotë kurrë se e adhuron atë.

Qabeja është vendi ku fokusohen zemrat në monoteizëm (tevhid) dhe hyjnësinë e Zotit (ubudijet). Në këtë kuptim, Qabeja është më shumë se një ndërtesë e ngritur me gurë. Ndoshta Qabeja është vetë zemra. Mund të thuhet se zemrat që rrinë gjithë kohës duke u drejtuar nga Qabeja, e kanë shndërruar atë në zemrën e mbrijtur me tevhid të një besimtari. Junus Emreja bën një lidhje të tillë mes Qabes, kibles dhe zemrës:

*Nëse e kërkon Allahun, kërkoje në zemër,  
Nuk është as në Kudus, as në Mekë e as në haxh.*

# Do të lexoni:



4

**Ahmet Tashgetiren /**  
Shoqëritë me kiblën e gjallë



**Ahmet Tashgetiren / 4**

**Ajni Sinani / 8**

**Hamdi Nuhiju / 10**

**Dalila Karakaçi / 14**

**M. Sami Ramazanoglu / 19**

**Dritan Kiçi / 20**

**Ma. Muhidin Ahmeti / 22**

**Vahidin Beluli / 26**

**Filiz Konxha / 28**

**/ 30**

**Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz / 32**

Shoqëritë me kiblën e gjallë

Muhamedi (a.s.) a do ta  
mashtron te vjetvete?

Roli i fesë në të ardhmen

Shkodra dhe rrëthinat e saj

Ndërtimi i Qabes

Hiri i Perëndisë te "Hapja" (Fatiha)  
e Kur'anit Fisnik

Meka dhe Qabeja, burim dhe  
qendër shpirtërore e botës

Edukata fetare në shkollat publike  
do të bëhet realitet  
apo do të mbetet iluzion

Kurbani

Fotoja e Muajit

Të drejtohesh nga Allahu fizikisht  
dhe shpirtërisht

14

**Dalila Karakaçi /**  
Shkodra dhe rrëthinat e saj



28

**Filiz Konxha /**  
Kurbani



Viti: VI | Numri: 44 | Nëntor 2011

**Drejtor & Kryeredaktor:**

**Alban Kali**

albankali@yahoo.com  
+355 67 20 8677

**Redaktor:  
Zija Vukaj**

**Korrektore:  
Ma. Irida Hoti**

**Përkthyesit:**

**Albert Halili / Arjan Ymeraj / Artur Tagani  
Elona Sytari / Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha**

**Kopertina:  
Edison Çeraj**

**Dizajn-Grafik:  
Bledar Xama**

**Për artikuj:**

e-mail: revistaetika@progresibotime.com  
e-mail: kosova@progresibotime.com  
e-mail: maqedoni@progresibotime.com

# Nëntor 2011

40

*Osman Nuri Topbash /  
Bajrami dhe Kurbani*



56

*Mustafa Erish /  
Historia e dy vellezërve në Kuran*



67

*Ma. Ermal Nurja /  
Historiku i ndërtimit të Qabes*



**PROGRESI**  
BOTIME  
[www.progresibotime.com](http://www.progresibotime.com)

**Adresa:**  
**L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi**  
**Shkodër / Albania**  
**Tel: +355 22 254 634**  
**Fax: +355 22 254 633**

**Zyra e përfaqësimit Maqedoni**

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25  
Shkup / Maqedoni  
+389 71 956 271

**Zyra e përfaqësimit Kosovë:**

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin  
Prizren / Kosovë  
Tel: +381 29 222 795  
Fax: +381 29 222 797  
+377 4411 98 48

**Çmimi:**

**Shqipëri: 150 Lekë**

**Abonim (një vjetor): 1500 Lekë**

**Kosovë: 1 Euro**

**Abonim (një vjetor): 10 Euro**

**Maqedoni: 60 DEN**

**Abonim (një vjetor): 720 DEN**

**Europë: 2 Euro**

**Abonim (një vjetor): 24 Euro**

Një vend për të gjithë  
Të gjithë për një vend

Një Ajet - Një Hadith

Bajrami dhe Kurbani

Dispozitat e namazit kaza  
dhe namazeve sunete

Fqinji i pangrënë

Përplasja e injorancës

Historia e dy vellezërve në Kuran

Nji hap përparimit

Mbikëqyrja e Allahut

Letërsia Islame

Xhamia e Kordovës

Historiku i ndërtimit  
të Qabes

Kur koha bën të vetën  
në martesë...

Superbrokoli kundër kancerit

Gjethja artificiale prodhon energji

Shkëmbim historik midis  
Hamasit dhe Izraelit

**35 / Ma. sci. Zymer Ramadani**

**38 -39/**

**40 / Osman Nuri Topbash**

**46 / Ma. sci. Flamur Sofiu**

**50 / Prof. dr. Ismail L. Çakan**

**52 / Eduard W. Said**

**56 / Mustafa Erish**

**58 / Zani i s'kaluemes**

**60 / Imam Naim Drijaj**

**62 / Ma. Artur Tagani**

**64 / Enciklopedi Islame**

**67 / Ma. Ermal Nurja**

**70 / Familja**

**72 / Shëndeti**

**73 / Teknologji**

**74 / Aktualitet**

# Shoqëritë me Kiblën e gjallë

Ahmet Tashgetiren

*“Dola para fronit tënd...”*

*“U lidha pas Kuranit...”*

*“Kibla është drejtimi im...”*

*“Qabja është kibla ime...”*

Po të kemi parasysh rruzullin tokësor, shohim se miliona myslimanë përqendrohen me zemër pesë herë në ditë në namaz dhe i drejtohen Qabes...

Miliona zemra lidhen me Qaben.

Kibla i mbledh rreth vetes zemrat e tyre dhe ia paraqet ato Krijuesit të gjithësisë si një të vetme.

Pesë herë në ditë Krijuesit i ofrohet një buqetë e formuar prej miliona zemrash...

Qëndrimi rreth kibles është një gjendje ndërgjegjësimi, që e mban në mënyrë të vazhdueshme zemrën në drejtimin e përpiktë, që e bën atë të fortë dhe e shpëton nga shkujdesja, devijimi dhe konfuzioni.

Feja islame e ka formësuar këtë të vërtetë si zemra e gjallë që është e pashmangshme.

Pa namaz dhe pa kible, mysliman i nuk e kuption dot jetën e tij.

Ashtu sikurse namazi e thërret njeriu të dalë para Krijuesit të tij në sabah, drekë, iqindi, aksham dhe jaci, pra në të gjitha çastet që i falin kuptim ditës, duke siguruar në këtë mënyrë një lidhje shpirtërore të vazhdueshme mes njeriut dhe Zotit, ashtu edhe përpikmëria në çështjen e kibles kryen një mision të rëndësishëm, duke e larguar zemrën gjatë namazit nga shkujdesja, konfuzioni dhe përhumbja pas kësaj bote.

Përpikmëria për kiblen është domosdoshmëri e vetë-dijes për udhën e drejtë (istikamet), që duhet të ketë çdo mysliman. Në qoftë se personaliteti i myslimanit varet nga domosdoshmëria për të qenë në rrugën e drejtë dhe në asnjë rrugë tjeter përvëç saj, atëherë edhe zemra varet nga nevoja e caktimit të një kible absolute brenda saj.

Kibla është shigjeta e busullës së rrugës së drejtë që ka zënë vend në zemër.

### "Fe ejne tedhhebun? Ku po shkoni?"

Njeriu është në udhëtim të vazhdueshëm mbi sipërfaqen e tokës. Jeta është udhëtim, prandaj edhe pyetja në lidhje me të cilën përqendrohet zemra tek kundron qielin, tokën dhe nëntokën është:

Cila është kibla juaj?

Veriu, jugu, lindja, perëndimi, cila?

Drejtimi në hapësirë, i marrë në vete, nuk ka kuptim. Në qoftë se drejtimet shprehin preferencën e besimit dhe të formës së jetës, aty zë fill edhe preferenca për kiblen dhe islami kërkon prej besimtarëve të drejtohen drejt shtëpisë së Allahut.

Ndër punët e para që bën çdo mysliman, kur shkon në një vend të ri, është të gjejë drejtimin e kibles, sepse pas saj vjen menjëherë namazi, që është akti i daljes para fronit të Zotit dhe akti i perceptimit të ekzistencës. Namazi është veprimi, kur ne qëndrojmë pesë herë në ditë gatitu dhe themi: "I përgjigjем thirrjes Tënde, o Zot! Namazi është përfaqësimi më kuptimplotë i të qenit rob i Zotit."

Në qoftë se një mysliman nuk e ka humbur ndjeshmërinë e tij ndaj namazit, kjo do të thotë se ai nuk i ka humbur as lidhjet e tij shpirtërore me Zotin.

Njeriu që nuk i ka humbur lidhjet shpirtërore

me Zotin e tij, nuk e ka humbur as vetëdijen, në lidhje me rëndësinë e kibles.

Këta janë damarët që ushqejnë njëri-tjetrin për personalitetin e myslimanit.

Në të kundërt, njeriu që nuk kërkon ta gjejë kiblen e tij në vendin që shkon për herë të parë, ka problem me namazin e tij.

Njeriu që ka probleme me namazin, do ta ketë të vështirë të çojë një jetë sipas përpikmërisë së myslimanit.

Në këtë kuptim, përpikmëria e treguar ndaj kibles, është si një lloj rigjallërimi i vetëdijes për personalitetin e një myslimanit.


Qabeja përfshihet në botën e myslimanit si një realitet krejt i ndryshëm gjatë muajve të haxhit...

Qabeja, së cilës i drejtohet pesë herë në ditë kur falet në muajt e haxhit, gjendet përpara tij në horizont, gati për ta parë konkretisht me sytë e tij, përt' u rrotulluar si flutura rreth saj dhe përt' u kapur pas kindave të mbulesës së saj...

Haxhi është obligim të kryhet një herë në jetë, për ata që kanë mundësi ta kryejnë këtë detyrë.

Qabeja ndodhet aty gjatë gjithë stinëve, orëve, minutave dhe sekondave të vitit, përt' u takuar me ata që i vijnë aty dhe ata që drejtohen drejt saj në namaz.

Qabeja është shtëpia e parë, e ndërtuar përhir të Allahut, mbi sipërfaqen e tokës.



Sipas asaj që Kurani na mëson, ngado që të drejtohet njeriu, aty do ta gjejë edhe Zotin. Allahu, pa dyshim, nuk ka nevojë t'i caktohet një vend dhe hapësirë për të ekzistuar. Në këtë kuptim, të drejtohesh drejt Qabes, nuk do të thotë kurrë se e adhuron atë.

Qabeja është vendi ku fokusohen zemrat në monoteizëm (tevhid) dhe hyjnësinë e Zottit (ubudijet). Në këtë kuptim, Qabeja është më shumë se një ndërtesë e ngritur me gurë. Ndoshta Qabeja është vetë zemra. Mund të thuhet se zemrat që rrinë gjithë kohës duke u drejtuar nga Qabeja, e kanë shndërruar atë në zemrën e mbrujtur me tevhid të një besimtarit.

Fakti që sufitë angazhohen të jenë përherë të lidhur me zemër me Qaben, madje edhe t'i jepin herë pas here rëndësi edhe më të madhe botës së zemrës, duhet të jetë rezultat i shndërrimit të Qabes në zemrën e vërtetë që rreh.

Besimtarët shkojnë në haxh, ndalen në Arafat, zhvishen nga statusi social që kanë në këtë botë, shohin me sy mahsherin, qëndrojnë përpara fronit të Zottit, jepin llogari për regjistrat e tyre të jetës, përtërijnë me anë të përgjërimeve të thella dhe kërkeseve përfalje qelizat e tyre, përfjetojnë një takim me shpirt me Qaben, sillen si të dashruar përreth saj, gdhendin në zemra çdo vijë të sajën, freskojnë zotimin e Kibles dhe në fund kthehen në shtëpinë e tyre.

Ashtu sikurse besimtarit hyn në xhami, takohen me trup dhe me shpirt me namazin, pajiset me kijame, ruku dhe sexhde gjatë namazit dhe pastaj kthehet sërisht në jetën e përditshme të kësaj bote...

Gjallëria e zemrës synon të parandalojë nje-

riun nga konfuzioni i jetës.

Në të kundërt, kur njeriu shkon pranë Qabes, madhështia e saj e rrëthon atë nga çdo anë dhe bën që ai të rrotullohet si flutura rrëth saj.

A është e mundur të shkosh në Arafat dhe të mos bësh dua? Kur disa miliona zemra rrahin për t'u futur nën mbrojtjen e mëshirës hyjnore, a është e mundur të ndahesh prej tyre dhe të shëtitësh nëpër vende të tjera?

Kur hyn në xhami, njeriu e rrëthon xhamia. Në çdo xhami, në çdo mihrab gjenden se s'bën reflektimet e përshtipartshmërisë së Qabes.

Kjo klimë i ngjan inkubatorit, ku ruhet dhe këqyret foshnja e porsalindur; në një farë kuptimi, klima sterile dhe e pastruar nga fëlliqësia dhe mëkatet sa më shumë të jetë e mundur.

Por në këto vende nuk rrihet vazhdimi.

Haxhi kryhet një herë në jetë dhe ditët e tij janë të kufizuara; ato shkojnë e vijnë. Njerëzit shkojnë dhe kthehen nga tokat e shenjta.

Koha e namazit është e kufizuar. Po të mblidhni kohën që ju duhet për të falur pesë kohët e namazit, bëjnë a s'bëjnë 2 orë në total. Nga xhamia, do s'do, do të dalësh.

Përjashta xhamisë të pret një jetë që nuk është aspak sterile.

Ja pra, merita është të arrish të ruash klimën e përjetuar nga vendet ku gjuhet me gurë shejtani dhe nuk mund të futet aty, edhe kur të ndahesh nga ato vende dhe të kthehesë në realitetin e kësaj bote.

Pyetja jetike është:

Ai që shkon në haxh, a përfshihet brenda Qabes dhe, pasi ta kryejë haxhin, a jeton duke



*A është e mundur të shkosh  
në Arafat dhe të mos bësh dua?  
Kur disa miliona zemra rrahin  
për t'u futur nën mbrojtjen  
e mëshirës hyjnore,  
a është e mundur të ndahesh  
prej tyre dhe të shëtitësh  
nëpër vende të tjera?*

ndjerë të rrahurat e një damari të Qabes në zemrën e tij?

Besitmari që qëndron në namaz, a mund të krijojë një jetë brenda përpikmërisë së rrugës së drejtë, të cilën e fiton falë Kibles dhe e ndërton kur del para Zotit?

**Një fjalë e urtë e popullit turk thotë: "Kali i lodjur nuk njeh kible."**

Kjo do të thotë se kali që nuk i ka të shëruara këmbët dhe trupin, nuk mund të arrijë të mbajë një drejtim. Goditja më e vogël e gjunjëzon dhe e hedh tej.

Dhe njeriu nuk është më ndryshe.

Edhe pse nuk është një çështje e rezistencës fizike, përpikmëria e treguar nga ana e njeriut në lidhje me kiblen, nuk ka dyshim se është një çështje e rezistencës shpirtërore.

Njeriu që shkon në haxh, duhet ta gdhendë në zemër lutjen që bëhet në Arafat.

Ai që bën tavaf rreth Qabes, duhet ta gdhendë në zemrën e tij Qaben si shigjeta e busullës së kibles.

Ai që hyn në xhami, duhet ta ngarkojë në

rrahjet e zemrës harmoninë e drejimit drejt kibles.

Shoqëria myslimane duhet shndërruar në shoqëri të kibles.

Nuk është e lehtë të shpjegosh brenda përpikmërisë së një myslimani, rastin kur një shoqëri e përbërë nga dhjetëra mijëra individë, që çdo vit shkojnë të takohen me Qaben, përjeton probleme kur dëshiron të krijojë lidhje me kiblen e saj.

I këshillojmë ata që edhe këtë vit do të nisen për udhëtimin e shenjtë që, pa u nisur mirë, le t'i përgatisin zemrat e tyre brenda Qabes, që të marrin konsistencën e duhur të besimit dhe të marrin ç'të jetë e mundur prej Qabes, në mënyrë që, kur të kthehen në vendet e tyre, të mund të ndërtojnë shoqëri, kibleja e të cilave është e këndellur.

Kur shoqëria myslimane në vende të ndryshme do të shpëtojë nga të qenët shoqëri që e ka humbur kiblen e vet, atëherë edhe bota do të ndryshojë.

# Muhamedi (a.s.)

## a do ta mashtronate vetveten?

Ajni Sinani

"Muhamedi është i Dërguari i Allahut..." (El Fet'h: 29).

**Sikur Kurani të ishte shkruar nga Muhamedi (a.s.) dhe sikur vërtet Muhamedi (a.s.) të mos ishte i dërguar prej Zotit të botëve, a do të mund të mashtronate vetveten? Po të mos ishte i bindur thellësisht në pejgamberinë e tij a do të mund ta rrezikonte jetën e tij?!**

**f**jeti vijues është nga Kurani fisnik, i cili është fjalë dhe libër i Allahut. Në të Zoti i thotë të dërguarit të Tij:

**"O ti i dërguar! Komunikoje atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer mesazhin (risalen). Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon."** (El Maide, 67)

Aisha, nëna e besimtarëve - Allahu qoftë i kënaqur me të - për shpalljen e këtij ajeti tregon: I Dërguari i Allahut e kaloi një natë dhe unë isha pranë tij. Unë i thashë: "O i Dërguari i Zotit, çfarë ke?" Ai tha: "Sikur një njeri i mirë nga sahabët e mi të më ruante natën." Ajo tregon: "Derisa ne ishim aty, dëgjova zërin e një arme. I Dërguari i Allahut, paqja e Zotit qoftë mbi të, pyeti: 'Kush është?' Ata thanë: "Sadi dhe Hudhajfa. Erdhëm për të të ruajtur." Pejgamberi i Allahut fjeti deri sa u shpall ky ajet (67 nga sureja El Maideh). Kur u shpall ajeti, tregon hazreti Aishja, Pejgamberi i Allahut, paqja qoftë mbi të, e nxori kokën dhe tha: "Shkonit ju o njerëz, tani po më ruan Allahu."

Një studiuese belge që është marrë me studimin e biografisë së të Dërguarit të Allahut, kur arrin në këtë ndodhi, ndalon dhe thotë: "Nëse ky njeri do t'i mashton-

te të gjithë njerëzit, ai nuk do ta mashtronate vetveten dhe nuk do ta rrezikonte jetën e tij. Nëse ai nuk do të kishte bindje të thellë se është Pejgamber i Zotit dhe nëse nuk do të ishte i sigurt se Zoti do ta ruante atë, Muhamedi nuk do të vepronte ashtu dhe nuk do të kërkonte nga rojet që të largoheshin dhe të shkonin. Ky veprim është dëshmi e fortë që tregon besimin e Muhemedit në Krijuesin e tij." Studiuesja belje e impresionuar dhe duke mos mundur ta përbante veten e pranoi Islamin duke deklaruar: "Unë pohoj me bindje dhe siguri të plotë se: Nuk ka zot përvëç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar Tij".

Biografia e Pejgamberit, paqja qoftë mbi të, ka shumë dëshmi dhe mrekulli që vërtetojnë se ajo që ai ka thënë dhe vepruar është e vërtetë nga Zoti i plotfuqishëm, Krijuesi i gjithësisë.

Një herë erdhi një beduin, i cili nxori shpatën e tij dhe tha:

- O Muhamed, kush të mbron nga unë?

Pejgamberi (a.s.) i tha:

- Allahu.

Beduinit filloi t'i dridhej dora dhe i ra shpata. Pastaj Pejgamberi i Zotit e mori shpatën dhe i tha: Po tani ty kush të mbron nga unë? A do të ishte kaq i bindur dhe a do ta thoshte me kaq siguri këtë, sikur vërtet Muhamed (a.s.) të mos ishte i Dërguari i Allahut?!

Ne betejën e Hunejnit kur ushtria e jobesimtarëve u kishte dalë befas në pritë myslimanëve u krijuar një gjendje kaotike dhe myslimanët filluan të iknin nga fushë beteja dhe të largoheshin nga të mundnin. I vetmi që nuk bëri asnjë hap prapa por qëndroi përballë ushtrisë armike, ishte Pejgamberi (a.s.) duke i ftuar myslimanët që të qëndronin duke thirrur me zë të lartë: "Unë nuk jam pejgamber i rrejshëm, unë jam biri i Abdul Mutualibit". Kur panë vendosmërinë e Pejgamberit (a.s.), myslimanët filluan të ktheheshin në betejë dhe të mblidheshin përreth tij. Sikur Muhamed (a.s.) të mos ishte vërtet pejgamber i Zotit, ai nuk do të vepronët në mënyrë të tillë duke rrezikuar jetën e tij!

Gjatë hixhretit të tij, Pejgamberi (a.s.) së bashku me mikun e tij Ebu Bekrin u strehuan në shpellën Theur. Idhujtarët mekas që ishin në kërkim të tyre arritën deri te hyrja e shpellës. Ebu Bekri kur i pa ata u frikësua për Pejgamberin. Mirëpo Muhemedi (a.s.) i tha: "O Ebu Bekr! Çfarë thua për dy persona kur i treti i tyre është Allahu? Mos u pikëll! Allahu është me ne". Vallë a mund të dalin këto fjalë në çaste të tillë aq kritike nga goja e një mashtruesi?!

Suraka in Malik ishte vënë për ta gjetur Pejgamberin me qëllim që t'ia dorëzonte idhujtarëve kurejshitë dhe të merrte si shpërblim 100 deve të caktuara nga ata. Kur Ebu Bekri pa Surakën tha: -O i dërguar i Allahut, një kalorës po na vjen pas. Pejgamberi (a.s.) filloi të lutej: "O Zot na ruaj nga e keqja e tij me atë që do dhe ashtu si do. Tije i plotfuqishëm për gjithçka që dëshiron".

Në atë moment këmbët e kalit të Surakës zhyten në rrërë dhe Suraka rrëzohet. Suraka tentoi edhe dy herë dhe Pejgamberi u lut me të njëjtën lutje. Tri herë Suraka u rrëzua së bashku me kalin e tij. Pas kësaj tregon Suraka:

-E kuptova se Muhemedi ishte njeri i mbrojtur nga të bërit keq.

Ai kërkoi prej Pejgamberit (a.s.) siguri duke thënë:

-O Muhamed, të lutem më mbro nga zhytja në rrërë.

Pejgamberi (a.s.) iu përgjigj:

-Je i mbrojtur.

Suraka përsëri i tha:

-O Muhamed, më jep të paktën diçka.

Pejgamberi (a.s.) i tha:

-Të premtoj byzylykët e Kisra-s.

I hutuar Suraka e pyeti:

-Kisra-s, mbretit të persëve?

Pejgamberi i tha:

-Po.

Suraka tregon:

-Megjithëse nuk isha mysliman i besova dhe i thashë përsëri:

-A ma premton këtë duke ma shkruar në një letër, o Muhamed? Pejgamberi i tha po dhe e urdhëroi Ebu Bekrin që t'ia shkruante këtë premtim në letër. Suraka e ruajti ketë letër. Tetë vjet më vonë kur myslimanët e liruan Mekën dhe hynë në të në mënyrë madhështore Suraka e pranoi Islamin.

Pasi vdiq Pejgamberi (a.s.), në kohën kur Omeri ishte udhëheqës, myslimanët fituan ndaj persëve dhe pasuritë e Kisra-s i sollën në Medinë. Bashkë me pasuritë e tjera ishin edhe byzylykët e tij, që Pejgamberi (a.s.) ia kishte prem-

tuar Surakës para 15 vjetësh. Omeri ngjitet në mimber të xhamisë, ku duke qarë e thërret Surakën që ishte i moshuar dhe i thotë: -O Suraka, Pejgamberi i Allahut të premtoi byzylykët e Kisra-s të persëve. Merri dhe vendosi në duart e tua që të besojnë njerëzit!

Suraka dhe të gjithë njerëzit që ishin në xhami filluan të qajnë me të madhe duke thënë: -Të vërtetët e ka thënë i Dërguari i Allahut.

Shtrrohet pyetja, çfarë e shtyri Pejgamberin (a.s.) që t'ia ekspozonte mesazhin e tij një rreziku të madh duke bërë një premtim aq të largët dhe madje të pamundshëm sidomos kur kemi parasysh çastet dhe situatën kur ai e bëri këtë premtim.

Për rrjedhim, secili prej nesh, kur lexon biografinë e Muhamedit (a.s.) nuk i mbetet tjetër, veçse i impresionuar ashtu sikurse studiuesja belge, të thotë: "Unë pohoj me bindje dhe siguri të plotë se: Nuk ka zot përvëç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari Tij".



# Roli i fesë në të ardhmen

Hamdi Nuhiju

## HYRJE

Sipas klasikëve të marksizmit, feja është opium i popullit dhe, si i tillë, duhet të largohet nga populli dhe të izolohet nga shoqëria. Ky mendim verboi shoqërinë perëndimore për shumë shekuj. Ky supozim i pabazë u ndërtua nga shoqëritë komuniste dhe u mor gati nga disa prej shoqërive demokratike, për t'u ambientuar nëpër filozofitë e tyre të politikës dhe jetës.

Shoqëria perëndimore e ndërtuar mbi këtë bazë, e nxori njeriun kundër Zotit, duke e mbivlerësuar atë. Shkolla, ekonomia, politika, teknologjia, u ndërtuan mbi këtë frymë.

Historia njerëzore njeh paragjykime të shumta midis religjioneve ose feve monoteiste.

Por janë shpeshtuar edhe aleancat e qytetërimeve dhe dialogjet fetare midis religjioneve.

Religjioni ka përcaktimë të ndryshme.

Një prej filozofëve të hershëm është Ksenofani ( 580-480, p.e.s.). Sipas tij, religjioni i ka rrënjet në vetë natyrën e njeriut; njeriu e përfytyron zotin si vetveten: zezaku si një zezak, traksi si një trakas. Sikur edhe kau të kishte duar të vizatonte zotin, ai do ta kishte vizatuar si një ka.

Markus Tullius (106-43, p.e.s.) e derivoi fjalën *religio* nga folja latine *religere* (kam kujdes, kam konsideratë etj.) dhe e përkufizoi si "të pasurit kujdes ndaj të gjithë atyre që kanë të bëjnë me kultin e perëndive".

Epikuri (341-270, p.e.s.) mendonte se religjioni, si besim te zoti dhe te jeta e përtejme, është rezultat i frikës nga vdekja dhe i mosnjohjes së ligjeve të natyrës.<sup>1</sup>

Krishtërimi është një fe që është zhvilluar në rrethin ku ka jetuar Jezusi nga Nazareti, përafërsisht 2000 vjet më parë. Lindja e lëvizjes në fjalë, mbështetet në shpresën dhe besimin e mesianizmit hebraik. Misionin e tij, Jezusi e ka filluar me përgatitjen e Bijve Izraelitë për mbretërinë e Zotit, që do t'u dhurohej në të ardhmen. Misioni dhe ekzistencë e tij me komentimet karizmatike të Palit, i cili ka hyrë në komunitet pas vdekjes së tij (Jezusit), kanë fituar një dimension të ri

dhe përbëjnë themelët e krishtërimit të sotëm.<sup>2</sup>

Hebraizmi është njëra prej feve më të vjetra, që jeton ende. Nuk është e qartë, a është fe apo komb. Në historinë e feve zë vend të posaçëm. Këtu janë të përziera feja dhe nacioni dhe është shumë vështirë që këto të ndahen njëra prej tjetërs. Shprehja *Balam* në Dhjatën e vjetër, ndriçon pozitën e hebraizmit. Nëse kjo situatë speciale do të shprehej me një thënie moderne, atëherë mund të thuhet se hebraizmi është një bashkim i besimit dhe nacionit, që kanë të njëjtën gjenezë biologjike dhe të njëjtën shoqëri fetare.<sup>3</sup>

Ndërsa, përcaktimin e islamit, më së bukuria na e dha engjelli Xhibril (a.s.), përmes hadithit të famshëm të Pejgamberit (s.a.v.s.), për Imanin, Islamin dhe Ihsanin.

Na ka treguar Museddedi, këtij i kishte treguar Ismail b.Ibrahim, këtij Ebu Hajjan et-Tejmu, ky nga Ebu Zur'a, e ky nga Ebu Hurejrje, i cili ka thënë: Një ditë Pejgamberi (s.a.v.s.), doli në mesin e njerëzve. Një njeri iu afrua atij dhe e pyeti:

-Ç'është besimi?

-Besim është të besosh Allahun, Melaket e tij, takimin me Të, të besosh Pejgamberët e tij dhe ringjalljen,- u përgjigj Pejgamberi (s.a.v.s.).

-Po ç'është Islami?- pyeti ai.

-Islami është ta adhurosh Allahun, të mos i përshkruash shok Atij, të falësh namazin, të japësh zekatin dhe të agjërosh Ramazanin,- u përgjigj Pejgamberi (s.a.v.s.).

-Ç'është mirësia(ihsani)?- pyeti ai.

-Ta adhurosh Allahun sikur e sheh Atë. Nëse ti nuk e sheh Atë, Ai, pa dyshim të sheh ty,- u përgjigj.

-Kur do të jetë Dita e Kijametit,- pyeti njeriu.

Lidhur me këtë pyetje, Pejgamberi (s.a.v.s.), tha:

-I pyeturi nuk është në dijeni më të madhe për këtë çështje se pyetësi. Vetëm po të tregoj ty për shenjat e tij: kur robëresha të lindë pronarin e saj, kur barinjtë e deveve zeshkane do të shtyhen me mburje në ndërtimin e pallatit. Ajo, Dita e Kijametit, është një nga pesë fshehtësitë që nuk i di askush,

2. Historia e feve, prej fillimit deri sot, Ekrem Sarıkıoglu, Shkup , 2007, f.444.

3. Po aty, f.381-382.

1. Religjioni në marrëdhëni ndërkombëtare ( Roli dhe ndikimi i tij), Muhammed J. Kajolli, Prishtinë, 2010, f.33.

përveç Allahut (xh.sh.)"<sup>4</sup>

Islami, krishtërimi dhe hebraizmi, si fe monoteiste kanë faljen kryesore në epokën e ardhmërisë. Ato duhet të gjejnë nyjet e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit midis popujve në botë.

Epoka e globalizmit rrit komunikimin midis njerëzve, dhe fetë duhet të reflektojnë tek to konceptet e dashurisë, dhembshurisë e mirëqenies.

Më në fund, qëllimi i tërë artit, i filozofisë, i religionit është që njeriut t'ia përkujtojnë enigmat, fshehtësitë, pyetjet; ky është zgjimi i vetëdijes sonë, mbas jo gjithmonë në drejtim të diturisë e të njohjes, porse kah shndërrimi i paditurisë sonë, për të cilën s'jemi të vetëdijshëm, për të cilën në padituri jemi të vetëdijshëm.<sup>5</sup>

Porosia e Eqrem bez Vlorës është shumë e qartë: 'Unë mësova se bekimin e pritur hyjnor nuk e sjellin formulat dhe frazat stereotipe të feve, as fanatizmi i verbër dhe kokëfortë, por kuptimi i thelli dhe zbatimi i drejtë i mendimeve të tyre të larta etike dhe parimeve morale'.

Mbi këtë bazë, do të ndërtohen edhe konceptet e këtij punimi.

## EPOKA JONË DHE FEJA NË TË

Gjendja e fesë në botën moderne dallon shumë prej asaj që dihet me kohë; lidhjet e fesë me jetën shoqërore dhe individuale kanë ndryshuar. Çdo ekzaminim i ndryshimit feta duhet të bazohet në të kuptuarit e ndryshimeve kryesore në strukturën e shoqërisë dhe të botës.<sup>7</sup>

Bota moderne ka ndryshime në krahasim me botën tjetër. Koncepte të tilla, si liria e fjalës, liria e lëvizjes, liria e organizimit publik, kanë fituar trajta të tjera në krahasim me të kaluarën. Sot lirinë e shprehjes nuk mund ta kuptojmë si dikur. Demokracia liberale jep hapësirë edhe për keqpërdorim të këtyre koncepteve, të cilat në veteve duken si kundërshtuese me vetë esencën e feve.

Barazia gjinore nuk ka më kuptimin e luftimit për të drejtat dhe liritë e femrave, por ka kuptimin e keqpërdorimit të këtij termi dhe mbulimit të padrejtësisë shoqërore pas këtij sloganit.

Liria, pra, është kusht për vepra të mira. Por, të lejohet shfaqja e egos përfundimtare që ka aftësi të zgjedhë, është realisht rrezik i madh, sepse liria e zgjedhjes së veprës së mirë, imponon edhe lirinë e zgjedhjes së asaj që është e kundërt me veprën e mirë.<sup>8</sup>

Baza e veprimtarisë shoqërore është liria. Shumëkush, mendoi se feja nuk ka të bëjë aspak me elementet përbërëse të kësaj bote dhe se ajo është një doktrinë në formë dogme për botën tjetër. Prandaj edhe rapporti i fesë me shoqërinë duhet të jetë në sferën private dhe në sferën publike, që gjithmonë të dalin në pah konceptet e shekullarizimit dhe

4. Sahihu-l-Buhari në gjuhën shqipe-1, Prishtinë 1994, Përktheu: M - hdi Polisi, f.97-98.

5. Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, Alja Izetbegoviq, Shkup, 2000, f.58.

6. Ortodoksizmi te shqiptarët (historia e religjioneve), Tetovë, 2005, f.17.

7. Religjioni Kontekstishoqëror, Meredith B. McGuire, Shkup, 2007, f.431.

8. Ripërtirja e mendimit feta në islam, Muhammed Ikbali, Shkup, 2006, f.115.

laicizmit. Si rezultat i kësaj, liria e besimit të çdo individi dhe shumë shoqërive, u kufizua dhe shpeshherë edhe merret padrejtësisht prej ligjeve dhe neneve të ndryshme, të cilat inicojnë minimizimin e fesë ngajeta publike.

Eksplisionin e fesë nuk mund ta mohojë askush. Sidomos në epokën e teknologjisë dhe globalizmit, por njëkohësisht edhe eksplisionin e sulmit ndaj fesë nuk mund ta largojë prej mendjes askush.

Shpeshherë përgatiten ligje të ndryshme kundër përdorimit të simboleve fetare nëpër shkolla, por edhe vende publike. Sulme të këtilla gjemjë në djepin e demokracisë liberale në Evropë, në Francë, ku në periudha të ndryshme historike është bërë ndalimi i bartjes së shamilë, si rezultat i ligjeve dhe presioneve të ndryshme juridike nga shteti.

Më 15 mars të vitit 2004, qeveria franceze miratoi një ligj që ndalonte mbajtjen e "simboleve të dukshme" fetare në shkollat publike. Në nenin 1 të këtij ligji, thuhet:

"Në shkollat filllore, nëntëvjeçare dhe të mesme, ndalohet mbajtja e simboleve apo e veshjeve që shfaqin haptas përkatësinë fetare të studentëve. Procedurat disiplinore për zbatimin e këtij rregulli do të paraprihen nga diskutimi i çështjes në fjalë me studentin përkatës."

Në këtë ligj jepet edhe një shpjegim mbi domethënien e veshjeve dhe simboleve që tregojnë përkatësi fetare: "Veshjet dhe simbolet fetare të ndaluara janë shenja të dukshme, të tillë si kryqi me përmasa të mëdha, shamia apo kësula. Nuk konsiderohen simbole që tregojnë përkatësi fetare objekte modeste, si medaljonet, kryqet e vegjël, yjet e Davidit, duart e Fatimes apo kuranët e vegjël."<sup>9</sup>

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë si dhe Forumi Mysliman i Shqipërisë bën padi penale ndaj gazetarit Kastriot Myftaraj për nxitje të urrejtjes ndërfetare në vend. Kastriot Myftaraj, në një seri shkrimesh të botuara në gazeten Sot, kërkonte zhdukjen e islamit nga trojet shqiptare. Në disa shkrime të mëhershme, i njëti autor shkruan kundër politikës së padrejtë amerikane dhe izraelite në Shqipëri, duke marrë krah të kundërt me to. Herën tjetër shkruante kundër Kishës Ortodokse të Shqipërisë dhe Janutalloxit, duke marrë krah të nacionalistik, ndërsa herët e tjera shkruante kundër Kishës Katolike. Dhe qëllimi i tij final ishte nxitja e një lufte ndërfetare në mesin e shqiptarëve të Ballkanit.

Modelin e Francës kundër simboleve fetare, si duket e kanë marrë edhe shumë shtete të tjera. Kjo gjë nxit dhunë dhe sulme të padëshirueshme psikologjike ndërmjet pjesëtarëve të feve të ndryshme. Edhe pse të tri fetë kryesore ngrihen mbi parime të dashurisë dhe tolerancës, dora e hekurt e shekullarizimit zhvlerëson rolin e tyre.

Epoka e pas 11 shtatorit, njeh diferençime të mëdha në dy pole. Polin islam dhe atë të krishterë. Etiketa që i jepet Islamit si terrorizëm, dhe Perëndimit si paqeruajtës dhe sjellës i lirisë e i demokracisë në botë, sot po justifikon politikën imperialiste të botës perëndimore ndaj botës islamë.

Gati secili njeri në këtë botë, di për 11 shtatorin edhe pas 10 viteve të kaluara. 10 vite propagandë e egër për tu shpëlarë truri i njerëzve se myslimanët janë rrezik për botën, ata janë terroristë dhe duan ta prishin rendin e ri

9. Politika e ferekses, Joan Wallach Scott, Tiranë, 2010, f.1-2.

botëror. Kjo gjë pasoi me sulmet juridike që u bënë ndaj myslimanëve sistematikisht nëpër vite dhe në vende të ndryshme botërore.

Pushtimi i Irakut, Afganistanit, sulmi ndaj Somalisë, ndaj Pakistanit, është një shembull më i realtë i kësaj pasqyre.

Pranvera arabe, dhe zgjimi turk ua prishi planet projektyeve të politikës së 11 shtatorit dhe zbuti pak propagandën e egër perëndimore në kartën e krijimit të paragjykimeve për botën islamë.

Shumë njerëz me vite të tëra jetojnë ndoshta bashkarisht me myslimanë, por nuk dinë asgjë për islamin si religjion, përvèç asaj që kanë dëgjuar në media, se myslimanët janë terroristë dhe se islamë është një fe që ndërtohet mbi parime të terrorizmit dhe anarkisë.

Epoka jonë duhet të ketë parasysh mesazhin që jepet nga fetë e ndryshme. Nëse duam që të bashkëjetojmë në paqe dhe të mos dashurohem me luftën, duhet që të kthehem i në mësimet e islamit, krishtërimit e hebraizmit. Të gjithë së bashku ose në vetvete, të nxjerrim mësime nga fetë tona dhe, në bazë të tyre, të reflekojmë edhe në shoqërinë njerëzore.

Sejid Muhamed Husejn Fadlallah ka thënë: "Ta mohosh tjetrin është e pakuptimtë, sepse kjo gjë nuk e mohon faktin se ai ekziston dhe nuk i jep fund ekzistencës së tij. Ndonëse një mohim i tillë mund të ketë ndikim në pengimin e përhapjes së një gjëje në një vend të caktuar, prapëserapë nuk mund ta pengojë përhapjen e saj në një vend tjeter. Çështja e përashtimit nga feja, është edhe një çështje kulturore, e cila mbështetet në studimin e asaj se si mendimet e një personi bien ndesh me parimet e islamit në një mënyrë të pakundërshtueshme. Kjo do të thotë se duhet të studiohet prapavija dhe natyra e mendimit të tij, e cila nuk është gjithmonë aq lehtë të arrihet.

Ta akuzosh dikë se ka dalë nga feja, vetëm ngase dallon me të në disa çështje teorike, përfundimisht me një bindje të plotë se pozita jote është e vërteta absolute, është vetëm një shprehje e mendjemadhësisë kulturore. Mendimi i një mendimtarit është gjithnjë produkt i shkollës që ndjek, i librave që ka lexuar dhe i përvojave të tij personale."<sup>10</sup>

## MESAZHI I DASHURISË DHE TOLERANCËS

Në vijim do të përpinqem përmes disa citateve, të pasqyroj mesazhin e dashurisë dhe tolerancës që ekziston midis feve të ndryshme në botë. Islami, krishtërimi dhe hebraizmi mund të bashkëkistojnë në një vend, po që se mediat ndalen me propagandat e krijimit të paragjykimeve përnjera-tjetren.

1."Nuk do të vë para syve të mi asgjë të keqe; unë e urrej sjelljen e atyre që dënojnë; nuk do lejoj të bëhem si ata." (Psalmet 101 : 3.)

Pjesa e parë e këtij mesazhi biblik sqaron luftën kundër së keqes dhe nevojën e paqes dhe tolerancës midis njerëzve. Nuk duhen urryer njerëzit, por duhen urryer sjelljet e këqijave të njerëzve dhe njeriu nuk duhet bërë si ato.

Ky mesazh deri diku është i ngjashëm me shumë mesazhe

10. Principet e bashkëkistencës, <http://dielli.net/lexo.php?id=94>.

islame dhe hebraike. Në vend që të marrim nektarin e tyre, ne hedhim vrer dhe zgjojmë paragjykime për njëri-tjetrin.

2..." sepse zemërimi im mban vetëm një çast, por mirësia e tij mban një jetë të tërë. Të qarat mund të vazhdojnë një natë, por në mëngjes shpërthen një britmë gëzimi." (Psalmet 30 : 5.)

Baza e zemërimit është smira dheurrejtja. Njeriu, nëse e largon zemërimin nga vetvetja, qetësohet dhe arrin që, në mënyrë bindëse, të vazhdojë bashkekistencën me të tjerët. Zemërimi është bazë e ndarjes dhe jo e bashkimit. Një porosi të tillë e gjëjmë të shprehur shpeshherë edhe në shumë ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.).

3. "Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi." (Efesianëve 4 : 31.)

Hidhërimi, zemërimi, inati, trazira, shpifa dhe ligësia, janë vëllezozer. Ata jetojnë në një trup dhe në një shpirt. Njeriu duhet të jetë i kujdeshëm në luftimin e tyre dhe, nëse i kushton rëndësi luftimit të tyre, më lehtë edhe mund të bashkëjetojë me të tjerët. Rol i kësaj porosie në të ardhmen, është drejt zbutjes dhe civilizimit të mendjes së njerëzve të religjioneve të ndryshme. Porosi kundër këtyre veseve dhe të këqijave, gjen edhe në shumë vende në Kur'an dhe Traditën Profetike.

4. "Shumë i dashur, unë dëshiroj të kesh mbarësi në çdo gjë dhe të gjëzosh shëndet të mirë, ashtu si ka mbarësi shpirti yt." (3 Gjonit 1 : 2.)

Kjo porosi është një lutje drejtuar njeriut. Lutja është orientuar përfundimisht për trupin dhe shpirtin, si pjesë të pandashme të njeriut. Trupi ndahet nga shpirti vetëm në momentin e transferimit të njeriut nga kjo botë, në botën tjeter. Njeriu ka nevojë përfundimisht të shëndoshë dhe mbarësi shpirti. Porosi të ngjashme gjëjmë edhe në fenë islamë.

5..." ndero atin tënd dhe nënën tênde dhe duaje të afërmintë tênd si veten tênde". ( Mateu 19 : 19.)<sup>11</sup>

Edhe ky mesazh gjendet në Biblën. Edhe pse Bibla gjatë historisë ka pësuar ndryshime rrënjosore, përsëri në të mund të gjëjmë thesare dhe nektare që i ndihmojnë njerëzimit përfundimisht. Tortura të padurueshme nga vetë të afërmintë përfundimisht. Bibla i sugeron të krishterit ta dojë të afërmintë e tij si veten, të jetë i lidhur me njeriun dhe të mos e përashtojë prej vetvetes. Sot njohim fenomenin e pranimit të islamit nga ana e shumë të krishterëve, të cilët përfundimisht përfundimisht përfundimisht. Edhe pse mesazhi i Biblës është i këtillë, ata njerëz, nuk respektojnë bindjet individuale të tij afërmive të tyre dhe kryejnë sulme të ndryshme, deri në dhunë tek ata njerëz.

Në vijim do të përmend edhe pesë porosi që japosin mesazhe të vlefshme përfundimisht nga spektri islam.

1." Lexo me emrin e Zotit tênd, i cili krijoi (çdo gjë)." (El Alek, 1)<sup>12</sup>

Shpallja hyjnore nis me fjalën lexo. Fillimi dhe përfundimi i jetës është lexo. Njeriu asnjëherë nuk duhet të largohet nga leximi, studimi, hulumtimi, kërkimi i diturisë. Përmes diturisë, ai e sulmon injorancës dhe përmes sulmimit të injorancës,

11. Citatet biblike janë të marra nga <http://shkrimet.com>.

12. Kuran, El Alak:1.

tendenca e paragjykimeve ulet. Nuk mund të ekzistojnë paragjykime tek njerëzit e ditur dhe me diapazon të gjërë të diturisë. Dituria është mesazh i dashurisë dhe tolerancës. A mund të duash verbërisht dikë prej fillimit e deri në fund? Një ditë mund të zhgënjejesh, po qe se paraprakisht nuk je i interesuar për të se si është dhe si ka qenë.

2. " Po qe se ndodh kiameti ( momenti i katastrofës së madhe), e në duart e ndonjërit prej jush ndodhet një farë e pemës dhe ai mundet që, para se të ndodhë ( momenti i kiamitet), ta mbjellë, le ta mbjellë, se ai me këtë do të shpërblehet."( Muhamedi, s.a.v.s.)<sup>13</sup>

Ky është roli i punës në islam. Në asnjë moment të jetës së tij, njeriu nuk guxon të ngelet i papunë. I papuni është i mbushur me paragjykime, pasi ka kohë të merret me thashetheme. Ai nuk mund të dallojë fjalën e vërtetë nga e pavërteta dhe me vetëdije ose pa vetëdije bën bartjen e tyre. Islami e urren të papunin, pasi ai krijon imazh negativ për shoqërinë. Edhe të tjerët vuajnë nga të papunët. Shoqëria islame njeh periudha të arta, kur në mesin e saj nuk kishte të papunë as nga radhët e jomyslimanëve e të mos flasim për radhët e myslimanëve.

Islami e urren varférinë. Sipas një hadithi të Pejgamberit (s.a.v.s.), varfëria e çon njeriu në kufër. Njeriu punëtor nuk mendon asnjëherë që të dëmtojë të tjerët, por shikon vetëm t'i ndihmojë ata. Përmes mekanizmave të ndryshëm ekonomikë, islami parashev pastrimin e pasurisë së punëtorit dhe punëdhënësit. Ti nuk guxon të jetosh i izoluar prej shoqërisë.

3. "Myslimani që shoqërohet me njerëz dhe i duron ofendimet e tyre, është më i mirë se ai që nuk përzihet me njerëz ose ai që nuk i duron ofendimet e njerëzve". (Muhamedi, s.a.v.s.)<sup>14</sup>

Porosia e Pejgamberit (a.s.), është durimi i ofendimeve të njerëzve. Po qe se i përbahemi kësaj porosie fisnike, nuk do të kishte mundësi të shkohej deri te konflikti, dhuna dhe lufta me të tjerët e as ndërmjet veti. Rol i kësaj porosie në të ardhmen, është i dobishëm për të tjerët shoqërinë njerëzore, jo vetëm për myslimanët. Nga kjo porosi do të kishin dobi, të krishterët, hebrenjtë, budistët dhe të gjitha grupet e tjera më të mëdha e më të vogla njerëzore.

4. Na ka treguar Adem b. Ebu Ijasë, ky nga Shu`be, ky nga Abdullah B Ebu Seferi dhe Ismaili, këta nga Sha`biu, ky nga Abdullah b.Amri r.a., e ky nga Pejgamberi (a.s.), i cili ka thënë: "Myslimani i vërtetë është ai që nga gjuha dhe dora e tij janë të qetë myslimanët e tjerë, kurse shpërngulës i vërtetë është ai, i cili e largon atë që Allahu (xh.sh.), e ka ndaluar."<sup>15</sup>

Me hadithin e sipërpërmendor, kërkohet sjellja dhe veprimi i mirë me njerëzit, duke përdorur metoda të duarduarshme për t'u afruar me njëri-tjetrin. Myslimani i mirë nuk bën veprat të këqija, as me fjalë, as me punë, por brenda mundësive të veta përpiqet për largimin e veprave të këqija.<sup>16</sup>

5. Transmetohet nga Ebu Dherri (r.a.), se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), ka thënë: "Për çdo nyje të njeriut, çdo ditë kur

lind dielli, duhet dhënë sadaka." Të pranishmit thanë: "O i Dërguari i Allahut! Po nga ta kemi sadakanë për ta dhënë për të?" Ai tha: "Vërtet, dyert e të mirave janë të shumta: Çdo tesbih-lavdërim, çdo tahmin-falënderim, çdo tekbir-madhërim; urdhëresa për të mirë, ndalesa kundër së keqes, largimi nga rruga e asaj që i pengon kalimtarët; të bësh të shurdhërin të dëgjojë, të udhëzosh të verbërin, të udhëzosh atë që kërkon prej teje sqarim për nevojën e tij, të hidhesh me vrap për të ndihmuar të shqetësuarin, i cili kërkon ndihmë dhe të hidhesh me dy duart e tua për të bartur barrën e atij që është i dobët. E tërë kjo llogaritet sadaka, e cila rrjedh prej teje dhe konsiderohet për shpirtin tënd." -transmeton Ibën Hibani në Sahihun e tij dhe Bejhiku në Muhtesar.

Në një transmetim tjetër, thuhet: "Edhe të buzëqeshurit në fytyrën e vëllait tënd, është sadaka. Mënjamimi i një guri, një ferre apo kocke, nga rruga e njerëzve është sadaka. Po edhe orientimi i një njeriu, i cili është i gjendur në një vend të panjohur, për ty është sadaka."<sup>17</sup>

Nuk ka dyshim se porosi të tilla janë melheme për shpirtin e njeriut. Secila orvatje për të sqaruar këtë hadith të Pejgamberit (s.a.v.s.), është një gjë e tepërt.

## QASJE PËRFUNDIMTARE

Dr. Jusuf el Kardavi, në librin e tij *Besimi dhe jeta*, thotë: "Besimi është forca e moralit dhe morali i forcës, shpirti i jetës dhe jeta e shpirtit, sekreti i botës dhe bota e sekreteve, bukuria e ekzistencës dhe ekzistencë e bukurisë, drita e rrugës dhe rruga e drithës. Besimi është oazi i udhëtarit dhe ylli polar i detarit, orientuesi i të humburit dhe arma e luftëtarit, miku i të huajit dhe shoku i të frikësuarit, freri i të fortit dhe fuqia e të dobëtit. Besimi është vendi ku lindin trimëritë dhe vërtetohen mrekullitë, çelësi i portave të kyçura, fanari ndriçues dhe udhëzues i rrugës. Thënë me një fjalë të vetme, besimi është domosdoshmëria e jetës së njeriut, domosdoshmëri për personin që të gjejë prehjen, lumturinë dhe përparimin, domosdoshmëri për shoqërinë që të gjejë qëndrueshmërinë, unititin dhe vazhdimësinë"<sup>18</sup>

Roli i fesës në të ardhmen ndërtohet mbi ndërtimin e besimit. Njerëzit nuk mund të jetojnë pa fenë dhe ndërhyrjen e saj në jetën publike dhe private. Shumë dukuri të shëmtuara shoqërore e gjajnë zgjidhjen e vetme tek religionet e tyre. Islami, krishterimi dhe hebraizmi duhet që të luajnë rolin vendimtar në ndryshimin e botës dhe ndërtimin e rendit të ri botëror.

Mevlana Xhelaludin Rumi, në poezinë e tij epokale thottë:

*"Eja, prapë eja, përsëri eja,  
Si do që të jesh,  
Pabesintar qofsh, zjarr adhurues qofsh,  
Njëqind herë në ke bërë pendim,  
Njëqind herë në e ke prishur pendimin,  
Kjo nuk është derë e pashpresës,  
Si do që të jesh, ashtu eja..."*<sup>19</sup>

13. Shkëndija pejgamberike, Muhammed Kutub, Shkup, 2002, f.17.

14. Myslimani ideal, Dr.Muhammed Ali el Hashimi, Prishtinë, 2008, fq.309.

15. Sahihu-l Buhari në gjuhën shqipe-1, Prishtinë, 1994, Përktheu: M - hdi Polisi, fq.54.

16. Po aty fq. 54.

17. Shkëndija pejgamberike, Muhammed Kutub, Shkup, 2002, fq.129.

18. Besimi dhe jeta, Dr.Jusuf el Kardavi, Shkup, 2010, kopertinë...

19. Bisedë e urtë me Mevlana, Tetovë,2008, f.5.



# SHKODRA DHE RRETHINAT E SAJ

EKONOMIA, TREGTIA (PAZARI I VJETËR), ZEJTARIA, PESHKIMI (LIQENI I SHKODRËS)  
NE FOKUSIN E TRE UDHËTARËVE ANGLO-SAKSONË TË GJYSMËS SË DYTË TË SHEKULLIT XIX

Dalila Karakaçi

**L**nteresi për temën shqiptare lindi që me veprat e Barletit "Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut" dhe "Rrethimi i Shkodrës", të cilat ishin një ndër burimet më të rëndësishme, njohëse për atë periudhë të historisë që lidhet me epokën e Skënderbeut dhe shekullin e XV. Figura e Skënderbeut u bë tërheqëse për shumë autorë që e rimorën atë dhe e përpunuan. Historia e tij lidhet me historinë e popullit që ai udhëhoqi. Udhëtarët që vizituan Shqipërinë e njihnin historinë e Skënderbeut edhe nëpërmjet Barletit.. Këtë e pohon bashkudhëtari i romantikut Bajron, J.C. Hobhausi. Por tema shqiptare u bë më e prekshme dhe e përgjithshme nëpërmjet poemës liriko-epike të Bajronit "Shtegtimet e Çajld Haroldit". Si romantik, ky udhëtim shërbeu për frymëzimin e Bajronit dhe tek Çajld Haroldi. Aty ai shprehu vlerat më të bukura kulturore, historike, bukurinë shpirtërore dhe atë natyrore të Shqipërisë.

Shumë biografë të Bajronit kanë venë theksin tek ndikimi direkt që ai pati me trajimin e temës shqiptare. Shpesh vargjet e tij janë shoqëruar me kostumet kombëtare shqiptare. Mendimi i tij se veshja shqiptare ishte më e bukura në botë frymëzoi shumë piktorë mbi temën shqiptare. Udvili thonte se "pëershkrimi i Bajronit sjell të gjallë në mendjen e atij që nuk ka udhëtaruar kurrë në Shqipëri, kostumet mahnitëse kombëtare shqiptare".<sup>1</sup> Me veprën e tij Bajroni i tregoi një copëze të Shqipërisë gjithë botës. Shumë piktorë citojnë vargjet e Bajronit rrëth Shqipërisë apo citojnë emrin e tij mbi pë-

shkrimet që ai realizoi mbi Shqipërinë dhe shqiptarët.

1- Bajronit i referohen edhe shumë autorë të tjera, të cilët trajtuan këtë temë si E. Lear (Lear), E. Durham, E. Najt (Knight) etj. Disa vepra arti të piktorëve të famshëm u krijuan për të ilustruar "Shtegtimet e Çajld Haroldit". Alexandre Colin hapi një ekspositë litografike, që trajtonte subjekte nga poemat e Bajronit dhe veshjet kombëtare shqiptare.<sup>2</sup>

Shqipëria e shekullit të 19-të u bë qendër hulumtimesh dhe eksplorimesh të shumë udhëtarëve, sidomos ato anglo-saksonë. Ato lanë gjurmë në letërsi në formën e përshtypjeve mbi udhëtimet, shënimet etnografike, antropologjike dhe social-historike. Udhëtarët e parë europianë udhëtuan nga Greqia në drejtim të tokave ku sundonte Ali Pashë Tepelena. Ndërsa mund të përmendim Eduard Doduelli (Edward Dodwell), Th. S. Hjuzin (T.S. Hughes), William Martin Likun (William Martin Leak), Xh. Best (J.J. Best), D. Urkhartin (D. Urquhart), Eduard Lirin (Edward Lear). Që me 1322 udhëtarët anglezë filluan të eksploroni Shqipërinë me Simeon Simeones.<sup>3</sup> Por Shqipëria dhe shqiptarët nuk ishin krejt të panjohur. Në shekullin e 19-të orientalizmi ishte shumë i përhapur dhe në morinë e librave mbi perandorinë turke dhe Lindjen në përgjithësi jepeshin informacione edhe mbi Shqipërinë. Klasikët, si: Plutarku, Ksenofoni, Herodoti, Ptolemene e pastaj Straboni e Livi e përmendin shkarazi

2. Colin, Alexandre. Historical Illustrations of Lord Byron's Works in a Series of Etchings by Reviel from Original Paintings. London, 1883, fq. 30.

3. Karagozi, Afrim. Bajroni: Anglisht dhe shqip( përbledhëse letr - re). Botimet enciklopedike, Tiranë, 1997, fq. 4.

1. Athol, Mayhew. In Albania with the Ghegs. Stribner's Monthly, vol XXI, New York, 1881, fq.42.

ose jo llirinë dhe viset e saja.

Për të po dëgjohej gjithnjë e më shumë sepse ishte bërë arenë evenimentesh të ndryshme. Një popull që nuk e pati reshtur kurrë luftën e tij kryengritëse dhe një vend që në këtë shekull përmendej për disa figura, si: Muhamed Aliu në Misir, Mustafa Bajraktari, Veziri i madh në Stamboll, Karamahmud Pashë Bushatlliu, por mbi të gjithë Ali Pashë Tepelena, personaliteti mistik i të cilit kishte tërhequr vë mendjen. Vilajeti i tij u bë qendër vizitash e hulumtimesh të udhëtarëve të huaj e sidomos të atyre anglo-saksone.

2 - Ndër vizitorët e shumtë të Shqipërisë gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 19 -të janë Braun (Brown H. A. *A Winter in Albania*, 1888), Tozer (Tozer, Henry Fashowe. *Researches in the Highlands of Turkey*, 1969), Henry dhe Najt (Knight. E. F. *A Narrative of Recent Travel*, 1880). Ato mund të quhen "Bajron's children" ("Fëmijët e Bajronit") meqenëse ndikimi i tij vërehet në çdo çast. Në ndryshim nga udhëtarët e mëparshëm, ata eksplorojnë Shqipërinë e Veriut, apo më saktë atë pjesë të Shqipërisë, e cila shtrihet në pjesën veriore të Shkumbinit. Të tre e vizitojnë si pjesë të udhëtimeve në Malin e Zi, Dalmaci e Greqi. Gjatë kontakteve me njerëzit e thjeshtë dalin në pah traditat, zakonet, krijimtaria gojore, nivel ekonomiko-shoqëror dhe politik i kësaj pjesë të Shqipërisë jo shumë e eksploruar më përpara.

Në përgjithësi në të gjithë qytetet shqiptare të shekullit të XIX mbizo-téronte prodhimi i vogël i mallrave. Kjo sepse pjesën më të madhe të popullsisë e përbënët zjatarët dhe tregtarët e vegjël, të cilët i shisnin vetë prodhimet e tyre. Secili kishte punishten e vet të vogël.<sup>4</sup>

Gjatë kësaj periudhe vazhdojnë të zhvillohen ato degë prodhimi, që lulëzuan veçanërisht në shekullin XVIII. Në qendrat kryesore të vendit, zjatarët merreshin me prodhimin e stolive prej ari dhe argjendi, me zbukurimin e artikujve të veshjes, me prodhimin e artikujve ushqimore dhe përpunimin e lëndës drusore. Më pas, rreth viteve 40-të, këto punishte marrin formën e njësive ekonomike të pavarura nga disiplina e esnafëve. Kjo i hapte rrugë një zhvillimi më të madh dhe të ri ekonomik që lejonte veprimin e ligjeve të ekonomisë së tregut.<sup>5</sup>

Një pjesë e mirë e qyteteve shqiptare në shek. XVII u kthyen në qendra të rëndësishme ekonomiko-shoqërore, kulturore dhe administrative. Territori i tyre filloj të shtrihet në zonat e banuara, në lagje të ndara sipas religjioneve dhe të vendosura rrëzë apo larg kalave të qyteteve.<sup>6</sup>

3 - Në këtë periudhë **Shkodra**, ashtu si edhe qytetet e

4. Shkodra, Zija. Qytetet shqiptare te Rilindjes. 8 Nentori, Tirane, 1990, fq. 44.

5. Ibid., fq. 46-47.

6. Ibid., fq. 136.

tjera, ishte vetëm një qendër administrative dhe urbane. Fuqizimi ekonomik me kalimin e viteve është në rritje. Kjo vërehet tek ndarja e ndryshme shtresore e shoqërisë: peshkatarë, ushtarë, tregtarë, zjatarë, fetarë dhe bujq.<sup>7</sup> Kjo dëshmon shndërrimin e saj në qendër ekonomike të prodhimit dhe shkëmbimit të mallrave. Dokumentat arkivore të shekullit XVIII, flasin për të si qyteti kryesor i Shqipërisë, i cili arriti të luajë rolin më të rëndësishëm ekonomik dhe politik në këtë periudhë.<sup>8</sup>

Zjataria e Shkodrës ka qenë e lidhur me pazarin e saj. Ai bënte të mundur lidhjen e tregtisë së Shkodrës me vendet ngjitur apo edhe larg saj përmes Bunës dhe porteve të tjera, si Oboti, Shirqi, Shëngjini dhe Ulqini. Tregtia bëhej me Serbinë, Kosovën, Malin e Zi, Bullgarinë si dhe pellgun e Mesdheut.<sup>9</sup>

Të tre udhëtarët, Najt, Braun dhe Tozer i kushtojnë vë mendje të veçantë përshkrimit të saj. Por në kohën e udhëtimit të tyre në qytetin e Shkodrës, ajo nuk ishte më në

lulëzim, përkundrazi dalloheshin shenjat e një rënieje të rëndësishë ekonomike, të cilat do t'i analizoj më poshtë. Nepërmjet kontrastit të së shkuarës me të tashmen, udhë-përshkrueshit theksojnë lulëzimin dhe njëkohësisht rënien e saj. Brauni e përshkruan atë si një "masë grumbujsh çatishë me tjequlla, që me shumë sforço qëndron në këmbë. Në të djathë të saj ujërat e fryrë të ligenit të Shkodrës kanë si grykëderdhje lumin e Bunës, i cili dredhohet drejt kalasë, nga njëra anë, dhe malit të Taraboshit, nga ana tjetër. Një urë e gjatë dhe e kuqe e kapërcen lumin e gjérë, pas tij kështjella e zezë vështron skenën e shndritshme pa

u ngrysur."<sup>10</sup> Ai thekson barkat e panumërt që ngarkohen dhe shkarkohen me mallra të shumtë në doganën që ndodhet në skaj te ligenit. Por kjo, gjithësesi, tregon se Shkodra akoma vazhdonte të ishte një qendër e rëndësishme import-eksporti si më parë.

4 - Impresioni i parë që marrin kur shikojnë pazarin, është ta shkëmbejnë atë me vetë qytetin. Ne fakt, qyteti shtrihet milje më tutje dhe Brauni e përshkruan "si një grumbullim monstruz arkitekturor."<sup>11</sup> "Lagja vendase përbëhet nga rrugica shumë të gjata me mure të larta guri, disa rrugë të ndërtuara me dyqane dhe kopshte, shumë rrugica pa krye, labirinth."<sup>12</sup> Së bashku me Najtin ai vë në dukje rëndësinë e saj si metropol i vendeve përreth. "Qyteti i sundimtarëve të rëndësishëm, me banjot prej mermeri dhe ndërtesar e kush-

7. Stavri, N. Naçi. Pashallëku i Shkodres nën sundimin e Bushatllive (1757-1796). Mihal Duri, Tiranë, 1964, fq. 38-39.

8. Muzeu Historik i Shkodrës. Kumtari. Shkodër, 1992, fq.54.

9. Ibid., fq. 55.

10. Brown, H.A. *A Winter in Albania*. Griffit, Farrow, Okeden & Welsh, London, 1888, fq.29.

11. Ibid., fq. 30.

12. Ibid., fq. 31.



*tueshme brenda kështjellës ( siç e quajnë kalanë Rozafa) bën që të njihej për pasurinë dhe mrekullinë që të ofronte. Familjet fisnikë kishin shtëpitë për të dimëruar në Shkodër, ndërsa në verë shkonin në Bushat.<sup>13</sup> Gjatë këtyre ditëve, Shkodra ishte qendër e tregtisë.*

Brauni thotë se "...aso kohe, Shkodra ishte qendra e tregtisë së madhe. Pazari ishte plot me popull nga të gjitha anët e Turqisë Europiane. Aty ndodheshin shqiptarë nga Toskëria, serbët e përtej maleve që vinin e shikonin kuriozitetet e këtij qyteti të madh. Boshnjakët dhe malazezët kryelartë silleshin nëpër pazar në mes të njerëzve. Burrat paqedashës të Republikës së vogël të Raguzës përfaqësonin Europën e qytetëruar.... në atë vend të Shqipërisë."<sup>14</sup> Por, cic thotë edhe Nait, "këto ditë kanë ikur për të mos u kthyer më kurrë."<sup>15</sup> Megjithëse turma që e populonështë akoma aty, më pak heterogjene, sipas tij, lavdia e saj eshtë shuar. Qyteti i shkatërruar së bashku me luksin që kishte dikur eshtë shoqëruar edhe me rënien e familjeve sunduese.

Familja sunduese që Knight i referohet eshtë ajo e Bushatillinxve, e cila qeverisi që në vitin 1756 e deri në vitin 1831. Dy sunduesit më të rendësishëm qeverisës së kësaj familjeje dhe që kontribuan në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të Shkodrës, janë Mehmet Pashë Plaku dhe Kara-Mahmut Pasha.<sup>16</sup> Mehmet Pashë Plaku e shpëtoi Shkodrën nga gjendja e anarkisë shoqërore, forcoi marrëdhëni tregtare shqiptar-venedikase, jo vetëm me Shkodrën, por edhe me rajonet malore veriore, të cilat qenë të bazuara tek eksport-importi i mallrave.

5 - Ai formoi një treg të madh ndërkrahinor, që lidhët krahina të ndryshme. Kara-Mahmut Pasha pati po të njëtin sukses si i ati në qeverisjen e qytetit. Nën udhëheqjen e tyre tregtarët shkodranë patën nën kontroll gjithë bregdetin shqiptar, nga Ulqini deri në Vlorë, drejt Rumelisë, Selanikut, Bosnjës, Serbisë, Moldavisë dhe Vllahisë.

Sipas Naitit, në Shkodër "*mbizotëron një gjumë i thelli, energjia dhe sipërmarrjet kanë shterrau.*"<sup>17</sup> Ai krahason Malin e Zi, që po ndërtonte rrugë për të lehtësuar lëvizjen, me Shkodrën, që nuk ndërtonte asgjë të re. Në të njëjtën kohë Podgorica po ndërtonte një qytet të ri, ndërsa ai i vjetri, për të, ishte tepër i madh. Kjo dëshmon ndaljen e rritjes ekonomike dhe të zhvillimit tregtar-zejtari, për shkak të problemeve të brendshme politike me administratën turke, mungesën e përdorimit të teknikave të reja prodhuese, rënien e prestigjit financiar të qendrave tregtare mesjetare,

si Venediku dhe Raguza. Me këto qendra Shkodra kishte lidhje të rendësishme e të përhershme ekonomike.<sup>18</sup>

Mund të them se jeta ekonomike e qytetit eshtë e lidhur ngushtë me lulëzimin e **pazarit** të saj, madje e reflekton atë. Ai përbledh gjithë jetën tregtare të qytetit dhe të krahinës, me 2500 dyqane. Sistemi i ndërtimit të pazareve shqiptare eshtë i njëjtë me ato të rajoneve të Ballkanit. Çdo pazar përbëhet nga tre përbërsë të rendësishëm strukturor si: a) pjesa qandorre ka larmi të madhe dyqanesh, b) tregjet e mbyllura, c) pazaret javore për të shkëmbyer mallra mes fshatit dhe qytetit.<sup>19</sup>

Dita e mërkurë eshtë ditë pazarit. Sipas Tozerit dhe Naitit njerëzit vijnë nga zona të largëta për të qenë prezent në të. Rruga për në pazar ishte e populluar, sepse njerëzit gjegjnë çdo pretekst për të shkuar atje. Pazari patullohej nga roje, të cilat ishin të udhëzuara të qëllonin çdo prishës të qetësisë. Disa vite më parë, përpëra se të vihej ky rregull, ishte kthyer në arenë vrashjesh. Dyqanet janë të njëjta me ato që kanë ekzistuar që në qytetet lindore, si kutia të vogla të vjetra, apo si vrima në mure, ku zotéruesit qëndronin në qendër të tij.

6 - Çdo degë e **tregtisë** ishte e përqendruar në një rrugë të veçantë me një sërë dyqanesh. Të gjithë rivalizuesit në tregti qëndronin ngjitur me njëri-tjetrin. Naiti thekson se "*kompeticioni nuk eshtë ndjenjë sunduese tek këta shitës të lumtur.*"<sup>20</sup> Në këtë "vend primitiv" shitjet me detyrim ndaj klientëve nuk ekzistojnë. Në një zonë më të largët të pazarit, tregtarët më të rendësishëm kanë zyrat e tyre." Këto tregtarë të moshuan ulen gjithë ditën duke prioritur miq apo pirë kafe e duhan.<sup>21</sup>

Më pas ato u organizuan në korporata lokale të fuqishme dhe me kapitalet e tyre vepronin me sukses jo vetëm në tregun e Shkodrës e të krahinave veriore, por shtriheshin deri në Shkup e Manastir.<sup>22</sup> Gjithashtu u ngritën gjykata tregtare dhe drejtoria e postave për shërbime të huaja. Ishten të hapura agjensitë konsullore të disa vendeve të huaja. Si port përdorej Oboti, por sidomos Ulqini dhe, më vonë, Shëngjini.<sup>23</sup>

Për t'u vënë në pah tek këta tregtarë eshtë shpirti i tyre. Naiti thekson një anë të veçantë të tyre, "*përshtatshmërinë e shkodranëve për t'u marrë me tregti për shkak të fisnikërisë*

18. Ibid., fq. 293.

19. Shkodra, Zija.Qytetet shqiptare të Rilindjes. 8 Nëntori, Shkodër, 1990, fq.102.

20. Knight, E.F.Albania: A Narrative of Recent Travel. Sampson Low, Marsten, Searle& Rivington, London, 1880, fq.44

21. Ibid.,fq.135.

22. Bushati, Hamdi.Shkodra dhe motet. Shkodër,1998, fq. 292.

23. Akademie e Shkencave e RPSSH.Fjalori enciklopedik shqiptar.T-rane, 1985, fq. 1020.

së karakterit.<sup>24</sup> Mbi të gjitha, dyqani është një vend për të qëndruar dhe pritur shoqërinë e njerëzve.

Gjate shirave, pazari përmbytej i terti e bëhej e pamundur puna në të. Megjithatë tregtarët shikonin përbmbytjen dhe ndalesën e punës si një shaka ndoshta të fatit. I pakonceptueshëm ishte ky element për këta udhëtarë europianë. Tregtarët mblidheshin tek një vend i përshtatshëm rrëth një zjarri duke pirë duhan e diskutuar gjatë gjithë ditës, në paqe me veten dhe të tjerët. Sipas fjalës turke *kismet*<sup>25</sup> çdo gjë është fat.

7 - Tregtarët e Shkodrës kishin të drejtat e tyre të mbrojtura nga një organizëm si Çeta e Tregtarëve të Shkodrës. Ky ishte një organizëm primitiv i asaj që më pas do të njihet si Oda e Tregtisë, në shekullin XIX, apo Dhoma e Tregtisë në ditët tona.<sup>26</sup> Ajo rregullonte marrëdhëniet ndërmjet tregtarëve shkodranë dhe ato të vendeve të tjera.

Sipas dokumentave arkivore të hulumtuara nga Hamdi Bushati, nga shekujt XVI, XVII, XVIII, tregtia shkodrane përqendrohej tek religjioni mysliman, e më pak tek ai katolik. Me shekullin XVIII raporti ndryshon dhe religjioni katolik bëhet mbizotëruesh, duke u marrë me importin e mallrave, për shkak të lidhjeve me botën e jashtme. Edhe Njati vë në dukje se e gjithë tregtia në Shkodër si dhe një masë e madhe e dyqaneve në Pazar është në duart e religjionit katolik. Kjo përfaktin se një pjesë e mirë e këtyre tregtarëve të besimit katolik kanë udhëtuar në të gjithë botën, ndërsa ata të religjionit janë më të varfër.

Në pazar ndodhen dyqane ku tregtohen prodhimet e **zejtarëve** të ndryshëm. Kjo shtresë zejtarësh dhe mjeshtresh merreshin me përpunimin e lëndëve xeherore, bujqësore dhe blektorale. Ato përbushnin kërkosat e shoqërisë për ushqim, për të veshurit dhe objekte të tjera të rëndësishme në mbarëvajtjen normale të jetesës. Gjatë periudhës nga shekulli XVIII dhe XIX këto zeje arritën përfekcionin e tyre nga ana teknike dhe artistike. Kjo ka lidhje me zhvillimin financiar të shoqërisë dhe reflektimin e saj në çdo aspekt të saj. Element i rëndësishëm ishin edhe mjeshtëritë shtëpiake e zejtaria fshatare. Niveli realizues dhe efikasiteti i tyre ndaluan ndërhyrjen e zejtarëve të vendeve të tjera në vendin tonë, duke patur kështu një kontroll jo vetëm lokal, por edhe rajonal.

Në pëershkrimin që u bën disa prej dyqaneve të pazarit Njati theksion cilësitet e këtyre zejtarëve e mjeshtërive të tyre. Në mënyrë të veçantë ai befasohet nga "...mjeshtëria e përpunuesve të armëve."<sup>27</sup>

24. Knight, E.F.Albania: A Narrative of Recent Travel. Sampson Low, Marsten, Searle& Rivington, London, 1880, fq. 135.

25. Ibid. fq.51.

26. Bushati, Hamdi. Shkodra dhe motet.Shkodër, 1998, fq.295.

27. Knight, E.F.Albania: A Narrative of Recent Travel. Sampson Low,

8 - Vëmendjen ia tërheq një armë shqiptare "...me çark stralli e qytë çeliku, të dekoruar shumë bukur, tytë me origjinë damasku të gjatë, me mbushje argjendi e rrathë të pruar me ar tek rrypi."<sup>28</sup> Mjeshtëria e përpunimit të këtyre armëve është transmetuar nga prindërit tek fëmijët për breza me radhë.

Njati vë në dukje se "... shalat më të bukura, prodhimet e filigranit, punimi i dorezave të arta të shpatave dhe zbulimet e jataganëve e të pistoletave, punoheshin nga ky popull i vyer."<sup>29</sup> Aty mund të gjendeshin edhe përbërës të ndryshëm të armëve si rrip fishekësh, fishek prej tunxhi me ornamente etj.

Mjeshtërit e përpunimit të lëkurës krijojnë shala kali me ornamente të shumta, rripa për femra të zbuluruara me koka gjilpérash, kuleta, rripa për meshkujt për të mbajtur armët. Ai vëren një zejtar duke qëndisur një copë të zëzë me endje ari dhe argjendi si pjesë e një veshjeje femërore të shtresës së lartë.

Këta zejtarë e konsiderojnë tepër degraduese perpunimin e hekurit, përvèç rastit të manifakturimit të armëve. Shqiptarët e Shkodrës, të Gjakovës dhe të Prizrenit janë mjeshtërë të famshëm në përpunimin e armëve dhe të objekteve të tjera prej metali, përvèç hekurit. Ky metal u lihet për punim ciganëve, të cilët kanë një lagje të veçantë në pazar.

Profesioni i rrobaqepësit nderohet tek shkodranët. Sipas Njxit shprehja që ekziston në Shkodër është se "... nëntë rrobaqepësa bëjnë një burrë të vërtetë..."<sup>30</sup> Madje, familjet më të mira janë rrobaqepëse.

Meqenëse gati gjithë banorët vi-

sheshin me rroba kombëtare, nevojiteshin shumë mjeshtëria të tillë për t'i bërë ballë kërkosat së tregut. Krahas tyre ishin dhe përpunuesit e mëndafshit. Mëndafshi ishte një burim i mirë të ardhurash për financat e vendit dhe artizanatin shqiptar në përgjithësi. Por importimi i mëndafshit nga Japonia dhe Italia e konkuroi atë të Shkodrës. Që në këtë kohë nisi degradimi i artizanatit shkodran, në përgjithësi, e atij të mëndafshit në veçanti.

9 - Element i rëndësishëm në përpunimin e metaleve është edhe ajo e argjendit. Përpunimi i argjendit njohu zhvillim në shekullin XVIII dhe XIX ,si pasojë e rritjes ekonomike të vendit dhe e kërkosat për objekte të luksit. Teknika mbizotëruese e argjendit u bë filigrami. Praktikuesit e kësaj teknike ishin argjendarët e Shkodrës, të Rrafshit të Dukagjinit, të Gjakovës, të Pejës, të Prizrenit dhe Beratit për përsosmëri realizimi dhe cilësi artistike. Këta udhëtarë anglezë vënë në

Marsten, Searle& Rivington, London, 1880, fq.152.

28. Ibid., fq. 152.

29. Ibid., fq. 153.

30. Ibid., fq. 46.

dukje aftësinë e filigratistëve shkodranë për të përpunuuar argjendin me zbukurime të shumëllojshme.

Zadrimorët janë kultivuesit e tokës dhe zejtariet e fshatit. Meqenëse toka e kësaj zone është shumë pjellore, ajo arrin të furnizojë me ushqime pjesën më të madhe të Shkodrës. Çdo të mërkurë, pazari është plot me gratë e Zadrimës, që përpiken të shesin ushqimet e tyre.

Ne veriperëndim të qytetit të Shkodrës ndodhet **lijeni i Shkodrës**. Ky lijeni zë pjesën më të madhe të Mbishkodrës. Një pjesë e tij shtrihet në territorin shqiptar, ndërsa pjesa tjeter në Malin e Zi. Vija e bregut në territorin në drejtimin jugor ndodhet rrëzë malit Tarabosh dhe është shkëmbore. Pjesa veriore dhe verilindore është fushore. Lijkeni derdhet në Bunë, përvèç humbjeve gjatë rrugës. Gjurmët e zgjerimit të tij ndeshen që në shekullin XIII, kur Vranina nga gadishull u kthye në ishull. Kjo dukuri u shpejtua nga mesi i shekullit XIX, kur një degë e Drinit u derdh në Bunë.

2000 vjet më parë, në shkrimet romake, përmendet lijeni me emrin e fisit të njobur ilir të Labeatëve. Tit Livi ( 59 para Kr.-17 pas Kr.) shkruan se" ..*Pastaj pretori romak arriti në Skodra, e cila ishte pika më me rëndësi e luftës, sepse Genti e kish zgjedhur këtë si fortesë të gjithë mbretërisë, duke qenë vendi më i fortë i labeave, dhe i vështirë përt'u afuar. Ky qytet rrëthohet prej dy lumejsh: prej Klausit (Kiri), që rrjedh nga ana lindore, pranë qytetit, dhe në perëndim prej Barbaniës, lum qe buron nga lijeni Labeat.*"<sup>31</sup>

10 - Them se rëndësia e liqenit është në të qenit një burim shumë i rëndësishëm ekonomik dhe zhvillues, jo vetëm për tregtuesit e burimit të tij kryesor, peshkut, por edhe për shkëmbimet tregtare të qytetit. Faktori gjeografik bëri të mundur zhvillimin e lundrimit, i cili zuri një vend të rëndësishëm në jetën e qytetit. Me ndërtimin e portave realizohet transportimi i mallrave dhe ndërtimi i mjeteve të ndryshme të lundrimit. Me kalimin e viteve ajo ishte pjesë e një tregtie intensive me brigjet e Gadishullit Apennin. Gjallërimi i marrëdhënieve tregtare me botën e jashtme u bë kur sundimi turk shpalli skelat e Adriatikut si "porte të hapura". Për shkak të lidhjeve të ngushta në mes të tregtarëve shqiptarë dhe të flotës ulqinake si dhe të sunduesve feudalë Bushatlinj... u arrit... të shtinin në dorë jo vetëm tregtinë tranzite të skelës së Durrësit, por thaujse të gjithë tregtinë e bregdetit shqiptar, që nga Ulqini e deri në Vlorë.<sup>32</sup>

Në këtë periudhë mjetet e lundrimit kanë qenë të shumë-illojshme. Të tre udhëtarët anglezë i kanë përdorur dendur ato gjatë udhëtimeve nga Shkodra për në vendet fqinje e

anasjelltas. Si Najti, Brauni dhe Tozeri përdorin sulen (një tip lundre) si mjet transporti. Kur udhëtonin nga lijeni për në anën tjeter të tij ishin të ngarkuar me mallra, ndërsa në anë të kundërt, ato ngarkoheshin me fruta e prodhime të tjera. Këto vinin për të tregtuar mallrat në pazarin e të mëkurës nga Tuzi, Hoti, Viri i Kastratit etj.

Sipas Najtit, sulja ishte e ngjashme "... me gondolën veneziane.. Madhësia e tyre varionte nga ato me një lopatë tek me dy mbëdhjetë lopata."<sup>33</sup> Çfarë i shqetëson këta udhëtarë është rrezikshmëria e pasiguria e lundrimit me to, veçanërisht në kohë të trazuar. Ajo nuk është mjet lundrimi që vihet nën kontroll lehtë siç thotë edhe Brauni, sepse çdo minutë "mund të shkaktohet përplasje me ndonjë trung peme."<sup>34</sup>

11 - Siç e përmenda edhe më lart, lijeni është i lidhur edhe me **peshkimin**. Gjatë sundimit osman ai shitej në ankand të paralajmëruar nga financa e shtetit. Prodhimi i peshkut ishte jo vetëm fitimprurës, por edhe ushqim tepër i lirë për popullsinë e varfér. Lijkeni i Shkodrës dhe lumenjtë Buna dhe Drini mbajnë lloje të ndryshme peshku, ndër të cilët mund të permendim: qefulli, krapulli, njila, krapulliqi, mlyshi, levreku, bercaku, barbunja dhe lloska.

Siç e pamë më lart lijeni ka qenë përgjatë shekujve një burim i fuqishëm të ardhurash jo vetëm për peshkatarët, por edhe për arkën e qytetit apo të shtetit. Dajlanët e vendet kryesore të peshkimit ishin pronë e komunës (Bashkisë) së qytetit të Shkodrës. Kjo mësohet edhe nga një dokument i vitit 1634: "...Lijkeni, me një rrëth prej 80 miljesh, kur gjendej nën zotërimin e shumë të kthjelltes Republikës të Venedikut, jepej me qera për 80 mijë patakone apo reale, kurse tanë për 8 mijë."<sup>35</sup>

Nje autor shkodran, më 1930 shkruan se: "lijeni i Shkodrës ka tanë ato cilësina që i lypen për me pasun peshk gjithfarësh; sepse ne njen' anë Mali i Taraboshit, i Krajës, i Rumis, që kan per bri uj të kthellët e ku peshku ka ato rahatina të veta, në tjetren anë ka fushat e Zetës, të Kastratit, të Koplikut deri në Shkodre, ku peshku ka kulloë të nevojishme për ushqimin ma te mirë; posë ktyne ka edhe lidhjen nepër Bregun e Bunës e Dri, me Breg t'Adriatikut e prej ktij detit hine n'ujna t'amlat Liqenit t'onë ate lloje peshkut që merren me ket gjueti janë ma të përmenduna: Shiroka, Zogajt."<sup>36</sup>

31. Tafilica, Zamir. "Brigjeve të lijenit të Shkodrës" (artikull). Shkodër, 2009, fq. 2.

32. Shkodra, Zija. Esnafet Shqiptare. 8 Nëntori, Tiranë, 1990, fq. 11.

33. Knight, E.F.Albania: A Narrative of Recent Travel. Sampson Low, Marsten, Searle& Rivington, London, 1880, fq.142.

34. Ibid., fq.132

35. Tafilica, Zamir. Brigjeve të Liqenit të Shkodrës. Guidë. Shkodër, 2008, fq.9

36. Ibid., fq. 7.

# Ndërtimi i Qabes

M. Sami Ramazanoglu

**K**ujoje kur Ne vendosëm për Ibrahimin vendin e Faltores (duke e urdhëruar): "Mos më shoqëro asgjë (në adhurim) dhe pastroje Shtëpinë Time (nga idhujtaria), për ata që vijnë rrrotull saj (në shenjë adhurimi) dhe për ata që rrinë në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde, duke u falur." (el-Haxh, 26.)

Sipas Ebu's-Suudit, ndërtimi i Qabes në kohën e Ibrahimit (a.s.), ishte ndërtimi i dytë. Për herë të parë, Qabeja u ndërtua nga Ademi (a.s.), por u prish gjatë tufanit në kohën e Nuhut (a.s.). Pastaj u rindërtua për herë të dytë nga Ibrahimi (a.s.).

Për herë të tretë është rindërtuar nga ana e fisit të Kurejshëve në kohën e injorancës, para ardhjes së Islamit. Kjo ka ndodhur para se Profeti ynë (a.s.), të nderohej me Shpalljen Hyjnore. Herën e katërt është rindërtuar nga Abdullahibën Zubejri. Herën e pestë është rindërtuar nga Haxhaxhi (pasi e rrënoi, e rindërtoi).

Sipas një hadithi që transmetohet në librin Zubdet'ul-Buhari, Qabeja e nderuar është ndërtesa e parë mbi faqen e tokës. Ky vend adhurimi është ndërtuar dhe restauruar njëmbëdhjetë herë:

1- Më parë është ndërtuar në formë drite nga melekët. 2- Ademi (a.s.). 3- Shiti (a.s.). 4- Ibrahimi (a.s.). 5- Amalikët. 6- Fisi Xhurhum. 7- Fisi Kusaj. 8- Fisi Kurejsh. 9- Abdullahbin Zubejr. 10- Haxhaxhi. 11- Sultani Murati IV.

Sipas Fahr-i Raziut dhe Nimetullah Efendisë, për shkak se ndërtesa e parë e Qabes u shkatërrua nga tufani, Allahu Teala, me anë të Shpalljes i tregoi vendin Ibrahimit (a.s.).

Ibën Abbas (r.a.), transmeton:

Ibrahimi (a.s.), u martua me Haxherin dhe, pasi lindi Ismaili (a.s.), për t'u ruajtur nga përplasjet me Sarën (gruan e parë), ikën nga Shami dhe shkuat në Mekë. Haxherin dhe Ismailin, Ibrahimi (a.s.), i la në vendin ku sot ndodhet Qabeja, pranë një peme të madhe, pak më sipër pusit të Zemzemit. Në atë kohë, ai vend ishte i pabanuar. Madje nuk kishte as ujë për të pirë. Ibrahimi (a.s.), u la një trastë lëkure të mbushur me hurma dhe një borsëtë me ujë. Më pas u kthyte për në Sham. Nëna e Ismailit, Haxheri, e ndoqi dhe i tha:

- O Ibrahim! Përse na le në këtë lugine dhe po ikën? Këtu nuk ka asnjë shenjë jete.

Megjithëse Haxheri iu lut shumë, Ibrahimi nuk u kthyte. Pastaj Haxheri e pyeti:

- Allahu të urdhëroi të na lësh në këtë vend?

Ibrahimi tha:

- Po, Allahu më ka urdhëruar.

Pas kësaj, Haxheri tha:

- Atëherë Allahu do të na ndihmojë. Ai do të në ruajë, nuk na lë vetëm dhe të humbur.

Pas kësaj, u kthyte në vendin e Qabes. Ndërsa Ibrahimi (a.s.), u largua deri sa arriti në një vend të lartë të Mekës, ku ndaloi dhe, duke u kthyer me fytyrë nga Qabeja, ngriti duart dhe u lut:

**"O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pashardhësit e mi në një lugine që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndjejnë dashmirësi përtat dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë."** (el-Ibrahim, 37.)

# Hiri i Perëndisë te "Hapja" (Fatiha) e Kuranit Fisnik

## Mendime mbi një interpretim të ri të vargjeve të shenjta

Dritan Kiçi

Kur isha rrith 15 vjeç, më ra në dorë libri i Çarl Dikensit "David Koperfild". E lexova brenda një nate. Rrëfimi i përsosur i personazheve dhe ambientit të tyre më bëri të dashuroj librat dhe Dikensin në veçanti. Mund të them se është libri im i preferuar. Në vitin 1993, në Itali, në bibliotekën e një kisha më ra përsëri në dorë i njëjtë libër, por në italisht. Kur e mbarova së lexuari, dashuria për veprën e Dikensit mu shtua dhe më shumë, sepse gjuha ishte e përsosur, shumë më e pasur dhe më shprehëse se në variantin shqip.

Në Londër, në vitin 1997, e bleva përsëri, por këtë herë në versionin anglisht. U mrekullova! I njëjtë libër, me të njëjtët personazhe, por një tjetër ndjesi.

Megjithatë, mesazhin e librit e kisha marrë që në versionin shqip, sepse kuptimi ishte aty, por me një gjuhë ndoshta më të varfër.

Nëse do t'i rendisja versionet do të ishin: anglisht, italisht dhe shqip. Ndaj sa herë më bie në dorë një libër i përkthyer që më pëlqen, përpinqem të gjej dhe një version në një tjetër gjuhë, për t'u siguruar se kam marrë më të mirën e mundshme nga fjalët e autorit.

Një ditë, nga kroskoti i një kamioni autobot që na kish sjellë ujë (sepse ujësjelli na kish lënë pa ujë nga 10 ditë), mora me kuriozitet Kuranin, që shoferi e mbante ndoshta si një hajmali të vyer.

Parathëni e librave zakonisht i lexoj në fund, ndaj kalova menjëherë në faqen e parë: Fatiha!

Kjo është ajo që lexova:

### 1. Fatiha

**1.1. Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërit!**

**1.2. Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!**

**1.3. Mëshiruesit, Mëshirëbërit!**

**1.4. Sunduesit të Ditës së Gjykimit (përgjegjësisë-shpërblimit)!**

**1.5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ty kërkojmë ndihmë!**

**1.6. Udhëhiqna në Rrugën e Drejtë!**

**1.7. Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as**

### në të atyre që e humbën veten!

Më erdhi në mendje Dikensi dhe në darkë u ula në kompjuter për të gjetur në internet versione të tjera të Kuranit. Gjeta disa, në anglisht, italisht, shqip, spanjisht dhe frëngjisht. Megjithëse u këshillova me të gjitha versionet, ato në anglisht dhe italisht më ndihmuani më shumë në nxjerrjen e kuptimit më të afërt të vargjeve të Hapjes (Fatiha).

Në fund të punës më doli ky version.

### 1. Hapja (Fatiha)

**1.1. Në emër të Allahut, më të Hirshmit, më të Mëshirshmit!**

**1.2. Gjithë lavdet dhe falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të universit (njërzve, shpirtrave dhe gjithçkaje që ekziston)!**

**1.3. Më të Hirshmit, më të Mëshirshmit!**

**1.4. Zotëruesit të Ditës së Shpërblimit (përgjegjësisë-gjykimit)!**

**1.5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ty kërkojmë ndihmë!**

**1.6. Udhëhiqna në Rrugën e Drejtë!**

**1.7. Në rrugën e atyre, që i dhurove (i dhe) Hirin Tënd, jo në të atyre që merituan Zemërimin Tënd (ata që e ditën të vërtetën por nuk shkuan pas saj) e as në të atyre që u humbën (ata që nuk e ndoqën të vërtetën nga padija apo gabimi)!**

Një miku im, Elmaz Fida, me të drejtë më bëri një vërejtje, duke më thënë se Rahmân dhe Rahîm kanë një kuptim më të gjerë sesa ai që kisha përshkruar. Dhe ka të drejtë deri diku. Kultura jonë gjuhësore-etike-fetare thuajse është zhdukur si pasojë e më shumë se një gjysmëshekulli ateizëm. Kjo ka bërë që shumë fjalë t'i jenë larguar kuptimit të tyre të vërtetë, ndaj le të shohim fjalët më të rëndësishme të vargut të parë:

**1.1. Në emër të Allahut, më të Hirshmit, më të Mëshirshmit! (Bismillâhi r-rahmâni r-rahîm)**

Sipas Ibn Qayyumin (1350 er), Rahmân përshkruan Hirin e të Gjithëpushtetshmit, si një cilësi e përhershme dhe e pandashme prej tij.

Ndryshe nga kuptimi i rëndomtë i përdorur sot, ku "i

hirshëm” kufizohet me bukurinë fizike, Hiri i Perëndisë përbledh brenda vetes disa tipare të rëndësishme, që janë:

1. Rezatimi i dritës hyjnore. 2. Dashuria në formën e saj më të pastër. 3. Bukuria, përsosmëria dhe mungesa e çdo gjëje të keqe e të rëndomtë.

Këto janë cilësi të Perëndisë dhe derdhen mbi njerëzit të pakushtëzuara nga veprimet apo sjelljet e këtyre të fundit.

Po sipas Ibn Qayyum (1350 er), rahîm shpreh Mëshirën Hyjnore, manifestimin e vazhdueshëm të Hirit të Perëndisë në jetët e njerëzve dhe efektet e tij si pasojë e veprimeve dhe sjelljeve të tyre.

Pra, një nga gjërat që bie në sy menjëherë është se në versionin tradicional shqip të Kur'anit Fisnik, te Hapja (Fatiha) është shmangur plotësisht nocioni i Hirit të Perëndisë dhe Zoti del si një personazh që merret vetëm me mëshirim, duke kufizuar e shtremberuar kështu përshkrimin e virtyteve hyjnore.

Në vargun 2, po në versionin e tradicional, gjejmë “falënderimin”, por jo “lavded”, që janë një nocion besimi universal, i mbartur te myslimanizmi nga fetë e mëparshme. Lavdet janë një detyrim i besimtarit, edhe kur zoti nuk ia ka plotësuar dëshirat e lutjet.

Në vargut 4 gjejmë “Sunduesit të Ditës së Gjykimit (përgjegjësisë-shpërblimit)”, por në të gjitha versionet e konsultuara vargu shfaqej kështu: “Zotërueshit të Ditës së Shpërblimit (përgjegjësisë-gjykimit)”!

Duket sikur mes “Sunduesit” dhe “Zotërueshit” nuk ka ndonjë ndryshim të madh, por në të vërtetë nuk është kështu. Sunduesi qeveris diçka që mund të jetë a të mos jetë drejtësisht e tija. Ndërsa, Dita e Shpërblimit është “Zotërim” i patjetërueshëm i Perëndisë.

Në vargun 7: “Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti têrhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!”, kuptimi ka humbur plotësisht, sepse përcaktohet “begatia” dhe “e mira materiale”: “të cilët i begatove me të mira”. Por nuk është ky kuptimi i vërtetë, sepse besimi në zot është i gjithhershëm si në begati, ashtu edhe në mjerim. Njeriu mund të preket nga Hiri i Zotit kurdo dhe nuk ka rëndësi begatia, shëndeti, fati i mirë etj. Është lënë jashtë edhe fakti i vargut të fundit, ku “Të Humburit” duhet të përcaktohen: nga padija ose gabimet dhe që nuk konsiderohen mëkatarë njësoj si ata që i shmanget me ndërgjegje Rrugës së Drejtë.

Në përgjithësi, versioni tradicional i “Hapjes (Fatiha)” shfaqet i zymtë, i frikshëm, me një Zot gjykues e ndëshkues, por, sipas mendimit tim, ripërcaktimi i terminologjisë e sjell më afér të vërtetës (shpresoj) kuptimin e vargjeve.

Kështu, tani, Allahu shfaqet jo vetëm një Hy që mezi pret të ndëshkojë mëkatarët, por një Perëndi, që mbi të gjitha rrezaton dritë e dashuri edhe për ata që kanë “humbur” rrugën; një Zot që është gjithnjë gati të ndihmojë e t’ia lehtësojë rrugëtimin atyre që pranojnë Dritën e Hirin e tij, që derdhen pa kufizim mbi gjithë universin.



# Meka dhe Qabeja

## Burim dhe qendër shpirtërore e botës

Ma. Muhibdin Ahmeti

### MEKA

Në krahinën e Hixhazit, në pjesën perëndimore të Arabisë, jo larg detit të Zi, qëndron qyteti i Mekës. Në qendër të këtij qyteti gjendet një ndërtesë e vogël në formë katrori. Meka dhe ndërtesa e saj prej guri njihen nga udhëtarët dhe udhë-përshtkuesit botërorë, që nga lashtësia. Ajo ndërtesë është Bejtullahu – Shtëpia e Allahut. Lashtësia dhe shenjtëria e saj, tejkalojnë edhe vetë historinë e njerëzimit.

Tradita thotë që Allahu (xh.sh.), kishte dhënë urdhër që në qzell të ndërtohej një tempull me emrin Bejtul-Ma'mur.

*El-bejt el-ma'mur – shtëpia në qellin e shtatë, e cila gjendet saktësisht përmbi Qabe*

Në studimet më të reja është argumentuar shkencërisht që Meka është qendra e botës. Në një rast Pejgamberi i pyeti sahabët: "A e dini çështë El-Bejt el-Ma'mur (tempulli qeillor dendësisht i banuar)?" Sahabët u përgjigjën: "Këtë e dinë më mirë Allahu dhe Pejgamberi i Tij". Pejgamberi (a.s.), u tha: "Ajo është shtëpia në qellin e shtatë (nën Arsh), e cila gjendet saktësisht përmbi Qabe. Çdo ditë në të hyjnë 70 mijë melaqe dhe nuk kthehen më." Ajo për të cilën secili haxhi duhet të jetë i vetëdijshëm gjatë tërë kohës së qëndrimit në Mekë, është se gjendet në vendin më të nderuar të rrugullit tokësor. Në hadithin tjetër, Pejgamberi (a.s.), thotë: "O banorë të Mekës, o pjesëtarë të Kurejshit, vërtet, ju gjendeni nën vetë qendrën e qiejve".

Aty është zemra e botës islame e madje edhe e kozmosit islam, ngase në qendrën e tij është Qabeja, pika ku boshti botëror i universit islam që lidh Qiellin dhe Tokën, e prek botën tonë njerëzore. Ky është qyteti, në truallin e të cilit kanë ecur Ibrahimit dhe Ismaili, qytet në të cilin lindi krijesa

më e përkryer njerëzore, Muhamedi, i biri i Abdullahut, Zoti e bekoftë dhe i dhëntë paqen, vend ku Zoti zbriti shpalljen e parë në Kur'an. Aty lindi bashkësia e parë islamë. Aty Pejgamberi përfjetoi sprovat dhe triumfet e tij më të mëdha. Rrugëve të saj kanë ecur sahabët e mëdhenj, si Ebu Bekri, Omeri, Osmani dhe Aliu. A ka ndonjë qytet tjetër që ka dhënë gjithë atë numër personalitetesh, të cilët ndërruan historinë botërore? Aty janë të gjithë ata dijetarë islamë, teologë, filozofë dhe sufi, të cilët me shekuj e kanë vizituar Mekën. Fryma e tyre, si dhe fryma e të gjithë atyre njerëzve të mëdhenj prej aksioni, të cilët kanë ardhur te dyert e saj si haxhinj të devotshëm, sikur rri pezull mbi qytet.

Meka është qyteti i Zotit, që pasqyron anën absolute e Tij. Të jesh aty, do të thotë të jesh në qendër. Të qëndrosh para Qabes, do të thotë të kuptosh fundin e udhëtimit. Nuk ka nevojë të shkohet në ndonjë vend tjetër në tokë, sepse aty është qëllimi i të gjitha udhëtimeve tokësore. Prej njërit skaj të dynjasë në tjetrin, myslimanët kultivojnë në zemrat e tyre dashurinë ndaj Mekës, Nënës së qyteteve dhe gjakojnë të vijnë në gjirin e saj mikpritës, të qëndrojnë para Shtëpisë së Zotit, në qytetin që pati nderin të jetë vendi i lindjes dhe veprimtarisë së të dashurit të Zotit, Habibullahut, Pejgamberit, triumfi kulmor i të cilit ishte që para udhëtimit të tij tokësor të fundit, të kthehej si ngadhnjimtar në Mekë dhe që në tokën, e cila qysh herët kishte qenë dëshmitare e thirrjes në Zotin e Vetëm nga ana e Ibrahimit, babait të monoteizmit, përsëri të vendoste besimin e Njëshit, *tevhid*. Meka nuk do ta harrojë kurrë më besimin e njësisë së Zotit dhe, deri në fund të kohës, do të mbetet qendër shpirtërore e fesë islamë, për të cilën është vetë ajo *rasion d'ëtre* e dëshmimit të Njëshit, i cili është i vetmi Realitet, sepse "çdo

gjë që éshtë në të (në tokë), éshtë kalimtare. E do të mbetet vetëm Zoti yt që éshtë i madhëruar e i nderuar!"

## QABEJA

Njëri nga nocionet e patjetërsueshme, që lidhen me fenomenin e besimit në përgjithësi, éshtë nocioni i tempullit. Besimi në thelbin e tij, paraqet raportin midis Zotit dhe besimtarëve që e adhurojnë Atë. Ai raport gjithnjë lidhet në një mënyrë të caktuar me vendin në të cilin bëhet adhurimi, përkatësisht ibadeti. Ai vend ka gjithmonë karakter të veçantisë, por edhe të shenjtërisë, për arsy se vazhdimesh kuptohet dhe emërohet si "Tempulli i Zotit" apo "shtëpia e Zotit". Pra, shtëpia apo vendi ku Zoti, në njëfarë mënyre, éshtë i pranishëm dhe ku éshtë lëshuar mëshira e Tij. Në këtë kuptim, besimtarët në mënyrë të veçantë i shënojnë dhe i zbuluojnë tempujt dhe i vizitojnë duke bërë ibadet dhe sakrifica.

Vendi dhe roli i tempullit në islam, në fenë natyrore të njeriut, éshtë shumëkuptimor dhe, në këtë kuptim, tempulli emërohet si "mesxhid" (vend ku bëhet sexhdeja), përkatësisht si "Bejtullah" (Shtëpia e Allahut, vend i bekuar ku Allahu lëshon rahmetin dhe bereqetin e Tij). Këta dy emra aludojnë në dy role themelore, të cilat i ka tempulli në islam: rolin e vendit të sexhdes, përkatësisht ibadetit dhe rolin e vendit të shenjtë (të bekuar), vend ku pastrohet dhe rilindet shpirti i njeriut. Nëse i shtojmë kësaj edhe rolin e shenjës treguese të Allahut, rrumbullakojmë tre rolet themelore që ka tempulli në islam.

Në këtë rast ne do të flasim për tempullin islam në kuptimin e "Shtëpisë së Allahut" (Bejtullah).

Qabeja éshtë shtëpia e parë e Allahut, përkatësisht falitorja e parë e ndërtuar në Tokë, në të cilën éshtë lavdëruar, madhëruar dhe adhuruar Zoti i vetëm dhe i vërtetë, Krijuesi i çdo gjëje ekzistuese:

"Shtëpia (xhamia) e parë, e ndërtuar për njerëz, éshtë ajo në Bekë (Mekë), e dobishme, udhërrëfyese për mbarë njerëzimin." ( 3:96.)

Shtëpia e Allahut – Qabeja, ka dimensione të ndryshme, prej asaj Qabeje, të cilën e ndërttoi Ibrahimi (a. s.), deri te Bejtul- Ma'muri në qiej. Ekziston Qabeja kozmike dhe ajo që éshtë e vendosur në zemrën e njeriut, të cilat korrespondojnë me njohjen shpirtërore të njerëzve.

Të kuptuarit njerëzor të domethënies së Qabes, si vend i

orientimit, si kible, éshtë të kuptuarit e fshehtësive të gjendjes shpirtërore të zemrës së njeriut.

Gazaliu, por edhe shumë dijetarë të tjerë, në secilin rit të Haxhit shohin fshehtësinë, e cila mund t'ia hapë derën shpirtit njerëzor që ta kalojë atë pragun, pas të cilit éshtë hapësira e shenjtë. Ai prag éshtë vija ndarëse e Porosisë së përfjetshme të Zotit dhe kalueshmërisë së kësaj bote.

Që të kalohet ai prag, që të hapen dyert e shpëtimit për shpirrat tanë, njeriu duhet të marrë udhëtimin drejt Zotit, e ai éshtë Haxhi. Në atë udhëtim duhet të jetë i pastër nijeti, paraja, por edhe vetë synimi, pasioni për këtë udhëtim. Ky éshtë thelbi i pelegrinazhit në islam.

Qabeja e nderuar gjendet në qytetin e Mekës, në qendër të Mesxhidul-Haramit. Është 13 metra e lartë, 12 metra e gjatë dhe 11 metra e gjerë. Ajo éshtë një ndërtesë me katër qoshe, e ndërtuar nga guri.

Allahu (xh.sh.), e ka bërë Qaben dhe Mesxidu'l-Haramin, që njerëzit në çështje fetare të kësaj dhe botës së ardhme, të qëndrojnë në këmbë. Në ajet thuhet:

"Allahu e bëri Qaben, shtëpi-në e shenjtë, vend jetësimi (për çështje të fesë e të jetës) për njerëz". (Maide, 97.)

Njerëzit, të cilët bëjnë haxhi-llëkun dhe umrën, qëndrojnë fuqishëm në këmbë dhe në fe edhe në dynja. Ai që ka frikë, atje kërkon mbrojtje. Ai që éshtë i dobët, atje gjen fuqi. Ata që falin namaz, kthehen në atë drejtim.

Qabeja éshtë qendër dhe që-llim. Është caku që i bashkon të gjithë myslimanët e botës. Të gjithë në namaz drejtohen nga Qabeja. Ajo éshtë simbol i solidaritetit dhe i bashkimit gjithëislam. Ajo luan një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në forcimin e vëllazërimit, harmonisë, marrëdhënieve reciproke, afrimit dhe njohjes së popujve, vendeve dhe bashkësive të ndryshme myslimanë.

Qabeja mundëson jo vetëm bashkimin fetar, shpirtëror, moral dhe ideor, por edhe atë hapësinor. Prandaj Qabeja, në kahasim me të gjitha xhamitë dhe mesxhidet e botës, éshtë ai centrali shpirtëror, moral, fetar e hapësinor, në drejtim të të cilët janë të kthyera dhe për të cilin janë të lidhura të gjitha xhamitë, mihrabët dhe shtëpitë e besimtarëve të botës. Kudo që janë, në ujë, në anije, në tokë apo në ajër, myslimanët kur falen në namaz kthehen në drejtim të Kibles. Besimi në Një Zot (iman), të nënshtuarit



vetëm ndaj Tij (islam), të robëruarit vetëm Atij (ibadet) dhe të kthyerit nga Kibla në namaz, bëjnë atë unitetin islam dhe bashkësinë myslimanë botërore të pandashme dhe unike deri në ditën Gjykit. Prandaj, një nga gjashtë kushtet themelore për të qenë namazi i vlefshëm, është kthimi nga Kibla. Përveç Kibla është ai centrali i dukshëm dhe i pacenueshëm në tokë, për të cilën janë të lidhura mihrabët dhe antenat minarore të të gjitha xhamive, në të gjitha vendet dhe pjesët e botës.

Qabeja, dhe vendet hurumate, janë një lloj centrali qendror, epiqendër universaliteti. Ato janë qendër e vendlindjes dhe ripërtëritjes shpirtëror të njerëzimit. Ato janë të pajisura me të gjitha mjetet e duhura për prodhim enerjish shpirtërore. Aty lirohen energji të mëdha shpirtërore e morale. Qabeja është qendër graviteti shpirtëror që centripeton të gjitha forcat e haxhinjeve në një pikë gravituese, i transformon ato në fuqi morale dhe pastaj bën shpërndarjen centrifugale të asaj energjive nëpër të gjithë botën.

Prandaj, sikurse mihrabet e xhamive, ashtu edhe kraharorët tanë, zemrat, shpirrat, mendimet, ndjenjat, vullneti dhe dëshira, duhet të jenë të kthyera nga Kibla.

Tërë jetën e vet, çdo besimtar, me mendime dhe me ndjenja, është i lidhur për ato vende. Gjatë namazit është i kthyer në drejtësim të tyre dhe i shoqëruar me të gjithë ata që synojnë për në ato vende. Madje, edhe kur falet vetëm, ai është në shoqëri me ta. "O Zot, vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Na udhëzo në rrugë të mbarë..."

Kthimi drejt Kiblës është një simbolikë, që do të thotë orientim drejt qëllimeve dhe idealeve të njëjtë të jetës. Parësor është orientimi i shpirtit kah një pikë në botë. Ky orientim i shpirtit paraqet domethënien e Kibles dhe ky është farz i pakushtëzuar, për derisa haxhi - pelegrinazhi islam, është farz i kushtëzuar.

Gjatë historisë, Qabeja ka luajtur rolin e krijimit të paqes dhe ibadetit. Ajo ka qenë e tillë, madje edhe në ato momente, kur përreth saj janë zhvilluar luftëra e vrasje. Kurani e tregon këtë fakt, duke thënë:

"A nuk e kanë vërejtur ata se Ne e kemi bërë vendin e shenjtë (Mekën) të sigurt, e njerëzit përreth tyre rrëmbehen (plaçkiten e vriten). Po a i besojnë ata së kotës, e të mirat e Allahut i përbuzin?" (El-Ankebut, 76.)

Nga sa u tha më lart, kuptojmë se Qabeja është tempull i bekuar, i përcaktuar njësoj për çdo mysliman e myslimanë. Ajo është bekim dhe udhërrëfim (Kible) për njerëzit. Ajo

është një shtëpi, të cilën e cakton dhe për të cilën garanton Allahu (xh.sh.), se do të jetë shtëpi përparimi, shtëpi e dashurisë së vërtetë, drejtësisë dhe solidaritetit.

Qaben e ndërtoi Ibrahimi (a. s.), me Ismailin (a. s.). Ata qenë dy njerëz plotësisht të lirë dhe, njëkohësisht edhe të dorëzuarit e të nënshtuarit e Allahut (xh.sh.).

Dhe deri sa Ibrahimi dhe Ismaili (a. s.), i vendosën themellet e tempullit, ata u lutën:

*"Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di! Zoti ynë, na bëj ne të dyve besimtarë të singertë ndaj Teje dhe pasardhësit tanë njerëz të bindur ndaj Teje; na i mëso rregullat e ibadetit tonë dhe na fal neve! Vërtet, Ti je që fal shumë, je Mëshirues!"*

*Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre, të dërguar që t'ua lexojë atyre ajetet e Tua, t'ua mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t'i pastrojë ata (prej idhujtarisë). S'ka dyshim se Ti je nga dhënjesi, i dijshmi." (El-Bekare, 127- 129.)*

Shtëpia e Zotit dhe tempulli i lashtë i dedikuar të Vetmit,

objekti i haxhit dhe pika drejt së cilës janë të drejtuara lutjet e përditshme, kibla e të gjithë myslimanëve, qëndron në zemër të Mekkës si dëshmi mbi natyrën e islamit, si monoteizëm i pastër që e ripërtëriu monoteizmin e Ibrahimit (a. s.) dhe porosinë zanafillore të njësisë, të shpallur Ademit (a. s.), babait të njerëzimit dhe pejgamberit të parë. Qabeja është simbol konkret i burimësisë së islamit në sytë e myslimanëve dhe të gjitha religjioneve. Të shkosh në Qabe, do të thotë të kthehesë në burimin

tënd. Ajo është edhe qendra më e lartë e islamit, drejt së cilës kthehen të gjithë myslimanët në namazet e obliguara. Si me të gjitha civilizimet e vërteta tradicionale edhe me islamin dominojnë dy realitetë të burimit dhe të qendrës dhe që të dyja këto dimensione themelore të islamit janë të pranishme në Qabe. Gjatë jetës së tij, edhe nëse jeton në majat vullkanike të Javës apo në shkretëtirën e Mauritanisë, myslimani është i vetëdijshëm për Qaben si një pikë në tokë, e cila e lidh me burimin e tij, burimin e fesë së tij - islamin dhe të vetë njerëzimit. Myslimani, gjithashtu, është i vetëdijshëm që të gjitha pikat në tokë, me linja të padukshme, janë të lidhura me qendrën unike, Qaben, në drejtësim të së cilës, pesë herë në ditë në namaz e kthen fytyrën e vet. Prandaj, myslimani ka lidhje me Qaben, e cila njëkohësisht është edhe statike edhe dinamike. Statike, sepse ekziston lidhje e vazhdueshme mes çdo pike në kozmosin islam dhe Qabes; dinamike, sepse në drejtësim të Qabes bëhen udhëtime për të kryer haxhin. Namazi paraqet lidhjen statike

e haxhi lidhjen dinamike. Bashkimi (unifikimi) i këtyre dy lidhjeve, vërteton praninë madhështore të Qabes edhe si Burim edhe si Qendër e universit fetar islam, jo për shkak të realitetit tokësor të Qabes, por për faktin që karakterizohet si Shtëpia e Zotit, sepse në të vërtetë, i vetmi Zoti, është Burim dhe Qendër e jetës së myslimanit...

Natyra arkake e Qabes tregon për karakterin e saj zanafillor. Meqë gati ka formën e kubit (*Ka'ba*, që në gjuhën arabe do të thotë kub), ka dimensione, të cilat, sipas të të kuptuarit pitagorian të harmonisë, janë reciprokisht në lidhje harmonike. Si kub, Qabeja gjithashtu simbolizon stabilitetin dhe pandryshueshmërinë që e karakterizojnë vetë islamin, religjionin e themeluar në harmoni, stabilitet dhe pandryshueshmëri, në esencën e tij më themelore, së këtejmi edhe e vërteta që islami mund të ripërtërihet, por jo edhe të reformohet. Ajo (Qabeja) është si një organizëm i gjallë, prandaj e mbështjellin me një mbulesë të zezë (kisëe), me ajitet kuranore të qepura

me penj prej ari. Kjo veshje e Shtëpisë së Shenjtë të Zotit, si një traditë e vjetër semitike, të cilën nuk mund ta gjejmë në botën greko-romake, përsëritet çdo vit, e kiswa e vjetër prehet në copa dhe ndahet. Në periudhën e lashtë të historisë islamë, kiswa është bërë në Egjipt dhe me kujdes të madh është sjellë në Mekë, por sot ajo bëhet në afërsi të vetë qytetit.

Qabeja është një strukturë me domethënësie dhe rëndësi kozmike e, madje edhe metakozmike. Ajo qëndron në boshtin, i cili bashkon Qiellin dhe Tokën në kozmosin islam... Ajo mban harmoninë kozmike. Katër qoshet e saj, tregojnë për katër drejtimet kryesore, të cilat paraqesin katër shtyllat e kozmosit tradicional. Guri i zi në këndin e saj (el-haxheru-l-esved), është meteorit, me origjinë jashtëtokësore. Thuhet se Ibrahimi dhe Ismaili (a. s.), e sollën nga mali Ebu Kubejs, në afërsi të Mekës, ku është ruajtur deri në ardhjen në Tokë. Sipas fjalëve të Pejgamberit, guri ka ardhur nga Qielli, më i bardhë se qumështi, por është nxirë për shkak të gjynave të bijve të Ademit, ndonëse ka mbetur diçka nga bardhësia e tij. Guri gjithashtu, simbolizon marrëveshjen e parë, e cila, sipas Kur'anit, është bërë midis Zotit dhe Ademit dhe gjithë pasardhësve të tij, me të cilën të gjithë pjesëtarët e gjinisë njerëzore në atë "çastin e parapërjetshëm" (Ezel), kur është bërë marrëveshja, kanë pranuar Hyjninë e Zotit.

Namazi i përbashkët rrëth Qabes është shenja më e qartë e nënshtimit të përsosur ndaj vullnetit të Zotit, siç tregon

rrotullimi rrëth saj pikërisht kthimin e njeriut në perfekcionin burimor parajsor. Duke i flakur idhujt nga Qabeja, Pejgamberi (a.s.), jo vetëm që ia ktheu Tempullit të Lash-të shenjtërinë si Shtëpi e Zotit, por edhe i mësoi të gjithë myslimanët që, nëse duan të jenë myslimanë të vërtetë, u duhet patjetër zemrën e vet, që është vërsnike mikrokozmike e Qabes, ta zbrzin nga të gjithë idhujt, nga të gjithë, përvèç Zotit, në mënyrë që ajo të jetë e denjë për prezencën e Tij.

Qabeja është formë, por megjithatë është simbol i Atij që s'ka formë. Ajo është proto-arkitekturë, por megjithatë, burim i tërë arkitekturës islamë. Mbështjellësi i saj i zi, kiswa, është simbol i zisë, e cila nuk është asgjë tjetër, veçse intensitet i dritës, ngjyrë pas të gjitha ngjyrave, që përmban të gjitha ngjyrat dhe të gjitha format.

Dhe së fundi, Qabeja është qendër e Tevhidit, besimit në një Zot të vetëm dhe bazë orientuese e jetëve të myslimanëve. Për Qaben është e lidhur historia e profetësisë; Pejgamberët më të njojur (Ademi, Ibrahimi, Muhammedi (a.s.), por edhe shumë të tjerë të njojur e të panjohur-alejhimu-s-selam), misionin e tyre e lidhën për Qaben. Themelimi i saj, ishte ngritja dhe triumfi i tevhidit e, braktisia e saj, ishte vërvshimi i shirkut! Por tevhidi gjithmonë ka ngadhënjyer, sepse ai është i pandalshëm, ai vazhdon përgjithmonë dhe është i pasgjësueshëm, sado të mëdha dhe çfarëdo qofshin fuqitë e shirkut. Tevhidi është qëllimi i haxhit dhe i jetës sonë. Pejgamberi i Allahut ka thënë:

*"Me të vërtetë kjo shtëpi (Qabeja) është një shtyllë e islamit dhe kushdo që e viziton atë dhe e bën umren, ai është ndihmëtar i Allahut! Nëse vdes, do të futet në xhenet e, nëse kthehet ne shtëpinë e vet, kthehet i shpërblyer dhe me pasuri".* (Taberani.)

#### LITERATURA:

1. [www.geistigenahrung.org/ftopic1028.html](http://www.geistigenahrung.org/ftopic1028.html)
2. [www.pensis.net/documente/22schriftlichearbeiten\\_Rel/Pilgern%20im%20Islam-Wieser.pdf](http://www.pensis.net/documente/22schriftlichearbeiten_Rel/Pilgern%20im%20Islam-Wieser.pdf)
3. [www.znaci.com](http://www.znaci.com)
4. [www.islamskazajednica.org / index.php?option=com\\_content&task=view&id=860](http://www.islamskazajednica.org/index.php?option=com_content&task=view&id=860)
5. [www.ikculm.de/peti\\_islamski\\_sart.htm](http://www.ikculm.de/peti_islamski_sart.htm)
6. [www.mullasadra.com/knjige/SHNASRMEKAIMEDINA.html](http://www.mullasadra.com/knjige/SHNASRMEKAIMEDINA.html)
7. [www.eslam.de/begriffe/k/kaaba.htm](http://www.eslam.de/begriffe/k/kaaba.htm)
8. [www.preporod.com](http://www.preporod.com)
9. Spahic, Mustafa, "Koraci u islamu", prirucnik za srednje skole, Sarajevo, 1997.



# Edukata fetare në shkollat publike do të bëhet realitet *apo do të mbetet iluzion*

Vahidin Beluli

itet e fundit, çështja e futjes së edukatës fetare në shkollat shtetërore ka qenë temë diskutimi nëpër debate të ndryshme. Tematizimi i kësaj çështjeje ka ardhur si rezultat i kërkesës së Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës për futjen e lëndës fetare në shkollat shtetërore. Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës futjen e lëndës fetare në shkollat shtetërore e sheh si nevojë imediate për ruajtjen e shoqërisë nga përhapja dhe rreziqet e dukurive negative, si të drejtë të garantuar me konventat ndërkombëtare dhe njëherit edhe si kërkesë të popullit. Kjo kërkesë ka hasur në pengesa të njëpasnjëshme dhe deri më sot është çështje e pa zgjidhur. Pengesa parë ka qenë mos përcaktimi i pozitës juridike të bashkësive fetare me rastin e nxjerrjes së ligjit përliturë fetare, mos përcaktimit të pozitës së bashkësive fetare në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mos shqyrtimi i kësaj kërkesë në Parlamentin e Kosovës si dhe mospërkraha e kësaj kërkesë nga bashkësia fetare e krishtere dhe protestante. Komisioni Parlamentar më 12 qershor 2006 hoqi nga rendi i ditës projektligjin për pozitën e bashkësive fetare me arsyetimin se nuk janë të pajtimit të gjitha bashkësitë fetare, dhe se kjo çështje do të shqyrtohet në një seancë tjeter. Një gjë e tillë nuk ndodhi deri më sot gjë e cila të bën të dyshosh në sinqeritetin e arsyetimit të Komisionit Parlamentar. Edhe gjatë diskutimit publik të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk ishin marrë parasysh rekomandimet e Bashkësisë Islame rreth nenit 8 ku Kosova do të ishte shtet neutral në çështjet fetare si dhe rekomandimi që pas paragrafit 3 të nenit 38 të shtohet edhe një paragraf që: Shteti siguron mbajtjen e mësimit (kulturës ose edukatës) fetare

tradicionale në shkollat publike. Edhe kjo është një mollë sherri për t'i thënë jo futjes së lëndës fetare në shkollat publike. Edhe Partia e Drejtësisë që nga themelimi i saj ka promovuar kërkesën përfutjen e edukatës fetare në shkollat publike gjë të cilën Komisioni Parlamentar nuk e kishte parë të udhës ta fusë në rend të ditës. Në zgjedhjet e 2010-tës Partia e Drejtësisë bëri koalicion me Aleancën Kosova e Re dhe kusht përkëtë aleancë ishte çështja e edukatës fetare në shkollat publike. Përfatë mbajtur fjalën e dhënë para elektoratit Partia e Drejtësisë ka kërkuar amendamentimin e ligjit përfutjen e edukatës fetare në shkollat publike. Mirëpo diskutimi i ligjit në Parlamentin e Republikës së Kosovës të mbajtur më 29.08.2011 (natën e Bajramit) ngjall shumë reagime, polemika dhe provokime.

Ligji u hodh në votim dhe nuk u amendua. Forma e diskutimit të ligjit dhe mos amendimi i tij preku thellë ndjenjat e besimtarëve myslimanë, gjë e cila shtyu edhe Myftiu e Kosovës në ligjërati e Bajramit të jetë i revoltuar me parlamentarët. Njëherit edhe imami i xhamisë së madhe, Dr. Shefqet Krasniqi në fjalimin e tij në protestën e të premtes ishte i revoltuar me formën e diskutimit të parlamentarëve. Pas gjithë këtyre ndodhive të javës së fundit u zhvilluan edhe shumë debate në mediat e shkruara dhe ato elektronike. Përfundimisht të gjitha diskutimet ishin më shumë të

*Parlamentarët dhe intelektualët e tjera kanë haruar se jetojnë në një shtet demokratik ku liria e të shprehurit është e garantuar ku ka të drejt të flasë edhe hoxha edhe prifti, sepse edhe ata janë qytetarë në rend të parë dhe në të njëjtën kohë kanë përgjegjësi shpirtërore dhe morale përbësime të besimtarët që ata udhëheqin.*

drejtuara rreth fjalimeve të Myftit dhe Imamit se sa në pasojat që do të përfjetojnë shqiptarët nga mos amendimi i ligjit përfutjen e edukatës fetare. Parlamentarët dhe intelektualët e tjera kanë haruar se jetojnë në një shtet demokratik ku liria e të shprehurit është e garantuar ku ka të drejt të flasë edhe hoxha edhe prifti, sepse edhe ata janë qytetarë në rend të parë dhe në të njëjtën kohë kanë përgjegjësi

shpirtéro-  
re dhe morale  
për besimtarët që ata  
udhëheqin.

Në vijim do të mundohemi t'u bëjmë një analizë shkaqeve të mos amendimit të ligjit për edukatën fetare në shkollat publike.

## **1. PARAGJYKIMET E POLITIKANËVE NDAJ FESË ISLAME**

Është e vërtetë e pamohueshme se politikanët dhe intellektualët kosovarë kanë paragjykime ndaj fesë islame dhe se këtë e kanë "dhuratë" nga e kaluara jonë d.m.th. nga sistemi komunist dhe historia e redaktuar nga push-teti serb.

## **2. MUNGESA E PRAKTIKËS FETARE**

Nëse i numëron politikanët dhe intelektualët kosovarë që kryejnë praktikat fetare do t'i gjëjnë ata me gishta dhe ky është turpi më i madh. Sot në asnjë vend të botës nuk gjennjerëz intelektualë dhe politikanë e që nuk janë fetarë.

### **3. INJORANCA RRETH ÇËSHTJEVE FETARE**

Mungesa e praktikës fetare njëheritështë rruga e injorancës fetare. Politikanët dhe intelektualët kosovarë nuk kanë mësuar në bankat e shkollës për fenë e tyre e as fenë e të tjerëve, nuk kanë marrë dhe vazhdojnë të mos marrin pjesë në ritualet fetare, nga paragjykimet që kanë për fe, nuk lexojnë as literaturë fetare, prandaj nga do të dinin ata për fe, nga qelli nuk ju vejnë ngase koha e profetëve ka përfunduar. Se sa të cekët e të kufizuar janë ata, e vërtetoi edhe debati në *Jeta në Kosovë*, ku intelektualët u shprehën se edukata fetare në shkolla do të thotë legeni e gjyqymisë për abdest në shkollë. (Turp i madh).

## **4. MOSINFORMIMI ME PRAKTIKAT E SHTETEVE EVROPIANE PËR RREGULLIMIN E POZITËS SË BASHKËSIVE FETARE**

Shumë politikanë dhe intelektualë kosovarë e kanë gojën plot se ne jemi në Evropë e jo në Azi, por ata harrojnë se në Evropë çështjet e fesë janë të rregulluara shumë mirë dhe atje nuk përjashtohen nga shkolla vajzat me shami, përkundrazi ato inkurajohen nëse janë të sjellshme dhe të afta në shkollë dhe në profesionin e tyre. Prandaj, mosinformimi për praktikat e Bashkimit Evropian i ka bërë ata të mos merren seriozisht me këto problematika dhe kërkesat e Bashkësive Fetare i kanë neglizhuar, derisa emocionet e besimtarëve janë ngritur dhe durimi

u ka humbur. Si argument për këtë mund t'u sjell faktin që në verën e kaluar gjatë përpjekjeve të mijave e intervistoj partitë politike për pozitën e bashkësive së arre në Kosovë, temë të cilën e kam pasur si punim diplomatik. Në Universitetin e Vjenës ata nuk kanë pranuar t'ua gjigjen pyetjeve të mia me arsyetimin se në partinë e PDK-së nuk janë marrë asnjëherë me këto problematika dhen. Po partitë ishin: AAK, LDK, PDK dhe Lëvizja Vetëvendosja. Nëse nga partitë që kanë pranuar të prononcohen dhen, nuk mendim pozitiv ishin PD dhe PSD. LDD kishte qënues qëndër neutral dhe pro praktikave evropiane.

## **5. MOSMARRËVESHTJA MES BASHKËSIVE FETARE**

Mendojmë se mëkatin më të madh në këtë çështje do ta bart Kisha Katolike dhe ajo Protestane, të cilët si pa-kica fetare në Kosovë nën parullën "Për inat të resë le të më vdesë djali" nuk janë të qartë ose edhe kundër futjes së edukatës fetare në shkollat publike, gjë që të bën të çuditesh, sepse askund në botë nuk mund të gjesh udhë-heqës fetarë që do të deklarohen kundër edukatës fetare në shkollat publike. Kështu që arsyetimet e tyre për mos-futjen e edukatës fetare në shkolla janë kozmetike dhe të maskuara, gjë e cila u ka dhënë shkas parlamentarëve të arsyetohen.

## **6. INTERPRETIMI I KUSHTETUTËS**

Interpretimi i Kushtetutës nuk është shkak, por është shkas për mos futjen e edukatës fetare dhe e vëtmja shkumë ku mund të mbahen parlamentarët. Ngase vetëm parlamentarët e interpretojnë atë si shtet laik, sepse kështu ua ka ëndë në të kundërtën versionin e Kushtetutës në gjuhën angleze dhe serbe shënon që Kosova është shtet sekular.

Në fund, mund të konkludojmë se parlamentarët me plot papërgjegjësi nuk amenduan ligjin për futjen e edukatës fetare në shkolla publike dhe ndoshta nuk do ta bëjnë këtë edhe në të ardhmen duke marrë parasysh nivelin e tyre fetar, derisa nuk do ta marrin edhe "shpërblimin" nga votuesit në zgjedhjet e ardhshme. Papërgjegjësi në këtë çështje ka treguar edhe Këshilli i Arsimtarëve të shkollës së mesme Sami Frashëri në Prishtinë, të cilët kanë dalë jashtë kompetencave të tyre, sepse futja e edukatës fetare është kërkosë e prindërve e jo e Bashkësisë Islame dhe se prindërit kanë kompetenca për të vendosur nëse fëmijët e tyre do të marrin pjesë në lëndën e edukatës fetare apo jo. Prandaj nuk duhet të harrojnë pseudoevro-pianët se kërkosat e prindërve në Evropë janë të realizuara e veçanërisht ato që janë të garantuara me konventat ndërkombëtare. Derisa me futjen e edukatës fetare nuk nënkuqtohet pjesëmarrja e domosdoshme edhe e atyre që nuk dëshirojnë të marrin pjesë në lëndën e edukatës fetare, është obligim i cdo besimtari, qoftë ai mysliman, i krishterë apo protestant që të ngrejë zërin për futjen e edukatës fetare në shkollat publike, në të kundërtën do të kenë përgjegjësi para Zotit në ditën e gjykimit.

# Kurbani

Filiz Konxha



Jala kurban vjen nga rrënja kurb dhe do të thotë afrim. Kafsha që pritet duke shpresuar kënaqësinë e Allahut Teala dhe për të fituar afri-min e tij, quhet kurban.

Pejgamberi ynë i nderuar, në vitin e dytë të hixhretit, ditën e nesërme pasi u kthye nga Lufta e Thevikut në Medine, (ditën e dhjetë të Dhulhixhes) doli në namazgja bashkë me myslimanët. Pasi fali dy rekate namaz pa ezan dhe pa ikamet, mbajti hytben. Në këtë hytbe i urdhëroi myslimanët që të thernin kurban. Edhe ai vetë theri dy kurbanë.

Xhabiri, radijallahu anh, thotë: "Pejgamberi ynë i nderuar, ditën e therjes së kurbanit theri dy deshë më brirë, të majmë dhe të tredhur. Para se t'i therte, tha:

"Unë e kam kthyer fytyrën time drejt krijuesit të qiejve e të tokës. Nuk jam prej atyre që i bëjnë shirk Allahut. Namazi, adhurimi,jeta dhe vdekja ime, janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka rival dhe unë jam prej myslimanëve. O Zot! Ky kurban është nga Ti dhe është për Ty. Në emër të Muhamedit dhe të umetit të tij "Bismillah, Allahu ekber" dhe pastaj i theri kurbanët." (et-Taxh. 207.)

Zajd Ibnu Erkam, radijallahu anh, tregon: "Sahabët e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, thanë:

-O i Dërguari i Allahut! Çfarë është ky kurban që theret ditën e bajramit?

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u përgjigj:

-Ky është suneti i babait tuaj, Ibrahim.

Sahabët thanë:

-O i Dërguari i Allahut! Çfarë sevapi ka në therjen e kurbanit?

Pejgamberi ynë i nderuar u përgjigj:

-Për çdo qime të kurbanit ka një sevap.

Sahabët pyetën përsëri:

-Nëse kurbani që presim është me lesh si qengj deleje (çfarë sevapi ka), o i Dërguari i Allahut? Alejhissalatu vesselam, u përgjigj:

-Për çdo qime të leshit ka një sevap.

Në një hadith tjeter, ka thënë: "Kush ka mundësi që të presë kurban dhe e neglizon atë, të mos i afrohet namazgjasë sonë."

Ndërsa në një hadith tjeter, thotë: "Zgjidhni për kurban një kafshë të mirë e të majme, sepse ajo do t'ju mbartë në urën e siratit."

Hz. Ali (r.a.), gjithmonë therte dy deshë. Njërin për vete dhe tjetrin për Pejgamberin tonë të nderuar. Kur e pyetën për arsyen e kësaj, ai u përgjigj:

"I Dërguari i Allahut më ka lënë porosi që të ther kurban për të, deri sa të jem gjallë. Këtë nuk e lë kurrë."

Fakti që Pejgamberi ynë i Nderuar i ka lënë porosi Hz. Aliut që të therë kurban për të, tregon se ai e dëshironë një gjë të tillë.

Sipas transmetimit të Hazretit Xhabir b. Abdullah, Pejgamberi ynë i nderuar solli në haxhin e lamtumirës 100 deve për t'i bërë kurban. Për shkak se ishte 63 vjeç, theri nga një deve për çdo vit, ndërsa të tjerat urdhëroi Hz. Ali që t'i therte.

Pastaj nga çdo deve mori një copë mish. E zien së bashku, hëngrën mishin dhe pinë prej lëngut të tij."

Pejgamberi ynë i Nderuar, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë: "Therni kurban, sepse ky është suneti i babait tuaj, Ibrahim." (Ahmed Davudoğlu, Buluğu'l-Meram Şerhi-Selâmet yolları, IV, 196.)

Nëna jonë Hazreti Aishe, radijallahu anha, ka thënë: "Pejgamberi ynë i nderuar, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

-Ditën e Kurbanit, njeriu nuk ka bërë vepër më të mirë te Allahu se derdhja e gjakut. Ai kurban ditën e kiametit do të vijë me briët, qimet dhe thundrat e tij. Sepse para se gjaku të bjerë në tokë, bie në vendin e pranimit të Allahut. Tashmë, le të jetë zemra juaj e kënaqur me kurbanët.

Allahu Teala e ka njoftuar Pejgamberin tonë të nderuar, sallallahu alejhi ve sellem, se në disa net, lutjet nuk refuzohen. Katër netët e bekuara në të cilat hapen dyert e mëshirës, janë:

- 1- Nata e Fitër Bajramit,
- 2- Nata e Kurban Bajramit,

3- Nata e Tervijes (nata e tetë e muajit Dhulhixhe),

4- Nata e Arafatit.

Muaji në të cilin ndodhet Kurban Bajrami, quhet Dhulhixhe. Adhurimet që bëhen në dhjetë ditët e para të muajit Dhulhixhe, janë shumë të vlefshme.

Dita e Arafatit është vetëm dita e nëntë e Dhulhixhes. Asnjë ditë tjetër nuk quhet ditë e Arafatit. Nga namazi i mëngjesit të ditës së Arafatit e deri në namazin e iqindisë së ditës së katërt të Kurban Bajramit, të gjithë, burrë e grua, sapo të japid selam në 23 namazet farz, qofshin me xhemat apo qofshin vetëm dhe para se të thotë "Allahumme entesselam...", një herë duhet të thonë tekbirin e teshrikut, i cili është vaxhib. Domethënë duhet të thonë: "Allahu ekber, Allahu ekber, La ilah illallahu vallahu ekber, Allahu ekber ve lillahil hamd."

Pasi të dalin nga xhamia apo pasi të flasin, tashmë nuk ka nevojë për ta thënë tekbirin e teshrikut. (Halebi)


*"Zgjidhni për kurban  
një kafshë të mirë e të majme,  
sepse ajo do t'ju mbartë  
në urën e siratit."*





# FOTOJA E MUJAIT

KALAJA E SHKODRËS, 1926





# Të drejtohesh nga Allahu fizikisht dhe shpirtërisht

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

**E**dukshmja dhe e padukshmja, shpirti dhe trupi janë dy veçori të rëndësishme që mbështesin njëra-tjetrën, që njeriu të drejtohet nga Qabja. Njeriu që qëndron pranë Zotit, i Cili është i pavarur nga hapësira, ashtu sikurse një kompas, qëndron aty shpirtërisht dhe me trup drejtohet nga Kibla. Ndaj dhe janë dy lloj kiblash, njëra shpirtërore dhe tjetra trupore.

Kibla trupore është drejtimi që bën njëriu drejt Qabes, ndërkokë që fal namaz. Drejtimi që marrim gjatë faljes së namazit është Kibla.

Ndërsa kibla shpirtërore është edhe drejtimi nga Ai, duke thënë *ajetin e drejtimit*, ndërkokë që fal namazin, gjithashtu është edhe drejtimi nga Ai jashtë namazit, duke mënjanuar gjithçka tjetër.

Në ajetin që njihet si *ajeti i drejtimit*, thuhet se Hz. Ibrahim ka bërë dua në këtë manyrë: “**Unë e kthej fytyrën time nga Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë dhe nuk jam nga idhujtarët”!**” (En'am, 79)

Nëse njeriu e thotë këtë ajet si një dua dhe drejtohet nga Kibla, atëherë edhe zemrën e drejton nga Allahu. I rëndësishëm është drejtimi i zemrës nga Allahu. Të

drejtuarit nga Kibla në këtë mënyrë, bën që të përqendrohemë më shumë në ibadete.

Të drejtuarit nga Kibla nuk do të thotë thjesht orientim drejt Zotit, pasi njeriu në namaz është në praninë e Zotit, në praninë e Atij që është i pavarur nga hapësira. Por njeriu ka nevojë për orientimin nga Kibla, për të gjetur qetësinë e munguar, që të zëvendësojë zhurmën e brendshme të tij dhe, për efekt, të përbushjes së *xhematit*. Ajo çfarë pritet nga njeriu, është sexhdeja dhe robëria ndaj Zotit. Andaj dhe kur i urdhërua engjëve për t'i bërë sexhde Hz. Ademit, pasi u krijua ai, Ademi ishte nga Kibla. Pasi sexhdeja i bëhet vetëm Allahut.

Allahu i Madhëruar, pasi krijoi mëkëmbësit e Tij, njerëzit, kërkoi prej tyre që duatë t'ia drejtonin Atij dhe i urdhëroi ata që të adhuronin vetëm Atë. Gjithashtu, u premtoi se do t'ua pranonte lutjet e tyre. Duke u bazuar në këtë *ferman hyjnor*, sahabët pyetën Pejgamberin (a.s.), se ku duhet të luteshin. Allahu i Madhëruar, pa u përcaktuar ndonjë drejtim, tha kështu:

**“Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni është Fytyra (ana) e Allahut. Vërtet,**

## Allahu éshtë Gjithëpërfshirës dhe i Gjithëdijshëm.”

(Bekare, 115)

Kuptimi i këtij ajeti éshtë se, jo vetëm xhamitë, por çdo vend i rruzullit tokësor, që nuk pengon bërjen e duasë dhe të ibadetit, éshtë vend i përshtatshëm për t'iu drejtuar Allahut. Pasi kontakti me Të éshtë i mundshëm pérherë. Në këtë ajet kuptojmë gjithashstu se bëhet fjalë edhe për një drejtim shpirtëror nga Allahu dhe për një Qabe shpirtëror.

Drejtimi nga Qabja éshtë një akt fizik. Kurse drejtimi shpirtëror éshtë të drejtarit nga *dhati* dhe *riza-ja* e Allahut. *Dhati* i Tij, i manifestuar me cilësitë *Xhemal* dhe *Xhelal* éshtë i pranishëm gjithnjë.

Lutja që bën Hz. Junusi në barkun e peshkut, “*S'ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!*” (Enbjia, 87.), dëshmon po ashtu se çdo vend éshtë i përshtatshëm për t'iu drejtuar Atij.

Allahu i Madhëruar éshtë Qabja shpirtërore e atij që nuk ia drejton botën e brendshme kujt tjetër përveç Tij dhe që shpirtërisht ndihet gjithnjë me Zotin. Kështu, jashtë namazit, ngado që të drejtohet, ky njeri éshtë në kontakt me Allahun. Madje, këta njerëz, ashtu sikurse u bë Hz. Ademi kible për engjëjt edhe këta bëhen kible.

Sikurse dheu u bë i shenjtë përmes *fryrjes hyjnore*, me takimin që bën zemra me Allahun, atëherë bëhet si një pjesë e Qabes. Të gjitha këto janë shprehja e manifestimit hyjnor të cilësisë *Xhemal*, në pasqyrën e Gjithësisë. Përpjekja për të gjetur *Fytyrën* dhe *Xhemalin* e Tij në çdo grimcë të pasqyrës së Gjithësisë, e bën njeriun të takohet me Atë. Të drejtarit drejt Qabes së *Dhatit* të Zotit, të arrish të shohësh Atë përmes cilësisë *Xhemal*, kjo gjë ndodh vetëm kur të bëhet rrisk të

përfitosh nga eliksiri i tevhidit shpirtëror.

Ekziston një raport mes zgjedhjes sonë shpirtërore dhe zgjedhjes së kibles. Kibleja e atyre që janë bërë pre e epshit dhe e stomakut, éshtë gostia e ofruar. Kibleja e atyre që janë gjithnjë me Zotin éshtë *sidre-i muntaha*. Kibleja e *arifë*-ve éshtë nuri i përpjekjes për të arritur tek Ai, kurse kibleja e mendjes së filozofuar éshtë bota imaginare. Kibleja e *zahidëve* éshtë Allahu, i Cili ka *ihsan-in* dhe *kerem-in*.

Kibleja e tamahqarëve éshtë qesja me flori. Kibleja e atyre që zotërojnë dijen e vërtetë éshtë *sabri*. Ndërsa kibleja e atyre politeistëve, idolatristëve éshtë statuja, fotografia apo pikatura. Kibleja e atyre që zotërojnë botën e brendshme éshtë Allahu. Kurse për ata që nuk arrijnë të hyjnë në botën e brendshme, ata që kanë ngelur tek sipërfaqja, kibla éshtë bukuria e lëkurës dhe e formës së femrës.



*Unë e kthej fytyrën time nga Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë dhe nuk jam nga idhujtarët!”*

(En'am, 79)

*“Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni éshtë Fytyra (ana) e Allahut. Vërtet, Allahu éshtë Gjithëpërfshirës dhe i Gjithëdijshëm.”*

(Bekare, 115)

Andaj dhe njeriu duhet ta largoje syrin dhe zemrën prej dynjasë, të shpëtojë nga trupi që éshtë krijuar nga dheu. Duhet kthyer në brendësi dhe në bosht të tij. Duhet të shikojë vetëm një kible. Ai që ka humbur syrin e tevhidit, ngatërron kiblen së cilës i duhet drejtar ose sheh dy kible. Ai që ngatërron tevhidin, humbet.



**“Me të vërtetë,  
Faltorja e parë,  
e ngritur për njerëzit,  
është ajo në Bekkë  
(Mekë), e bekuar  
dhe udhërrëfyese  
për popujt.”**

(Ali Imran, 96)

Ka  
njerëz  
që shkojnë  
në këmbë në Qabe. Ka  
edhe prej atyre që lodhen për të  
shkuar në xhami e, pa mbërritur, ndryshojnë mendim  
dhe kthehen. Dikush tjetër edhe shpirtin e jep për  
idealet e tij. Ashtu sikurse qëllimi i atyre që shkojnë  
në haxh është të bëjnë tavaf Qaben edhe puna e atij  
që është i etur, është të vërdalloset rrëth lumenjve, të  
dëgjojë zërin e ujit dhe të pijnë nga ai ujë.

Zemrat ashike shkojnë e vijnë gjithnjë në Qabe. Distanca e rrugës është sipas trupit. Në perspektivën hyjnore nuk ka gjatësi apo shkurtësi. Nëse Allahu dëshiron, trupi ndryshon, distanca zvogëlohet. Pasi, nuk është larg Bagdati për ashikun, thotë një thënie e vjetër.

Kibla fizike sipas aspektit sufist, pra mes Qabes dhe kibles shpirtërore, ekziston një marrëdhënie. Qabja, si kible fizike e myslimanëve, mban një vlerë të veçantë. Ajo çfarë e bën të veçantë, është ndërtimi i saj nga sinqeriteti i një pejgamberi ulu'l-adham.

**“Me të vërtetë, Faltorja e parë, e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.”** (Ali Imran, 96.)

Për ndryshe, vlera e asaj faltoreje nuk vjen nga gujt e saj apo nga dheu, por ai që e ndërtoi atë, Hz. Ibrahim, nuk kishte smirë, nuk kishte ndonjë konflikt. Këto cilësi i dhanë madhështinë asaj. Zemra e njeriut,

sapo kujton gjendjen e saj, dridhet e tëra, emocionohet. Andaj dhe ky tempull madhështor është bërë kible për ne.

Guri që ka ndërtuar Ibrahim, i biri i Azerit, është një ndërtesë, ndërsa zemra është vendshikimi hyjnor. Megjithëse Qabja fizike dihet si shtëpia e Allahut, Ai nuk ka hyrë asnjëherë brenda saj, që kur është ndërtuar.

Pra, aty nuk është vendi i Allahut. Por në vatrën e zemrës së njerëzve të veçantë të Zotit, nuk ka bujtur tjetërkush përvëç Tij. Meqë Allahu është i pavarur nga hapësira, Ai nuk mund të jetë brenda një hapësire të caktuar. Por një zemër e dëlirë e zë Atë. Junus Emreja bën një lidhje të tillë mes Qabes, kibles dhe zemrës:

*Nëse e kërkon Allahun, kërkoste në zemër,  
Nuk është as në Kudus, as në Mekë e as në haxh.*

Edhe një një gazel të Mevlanës thuhet: “O ju që jeni nisur për haxh! Ku po shkoni? I Dashuri është këtu, këtu ejani!”. Me këtë, Mevlana do të tregojë shenjtërinë e zemrës dhe që Qabja e vërtetë është zemra. Sepse qëllimi i atyre që shkojnë për haxh, mund të mbesë tek Qabja. Por për atë haxhi që ndjen mall për Zotin, qëllimi i tij është i zoti i Qabes.

Njerëzit e thjeshtë shkojnë në haxh për një nevojë të dynjasë dhe të ahiretit. Ndërsa, njerëzit e kemalit, gjenden shpirtërisht përherë aty. Dera e Qabes është gjithnjë e hapur për ta. Pasi zemra e njerëzve të tillë është bërë vetë Qabe.

Kandidatët për haxhi, që janë nisur për Qabe, gjithmonë thonë: “Lebbejk/urdhëro o Zot!”. Kjo thirrje e tyre, në fakt është një përgjigje që i japid Allahut. Thirrjes hyjnore që u bën Zot, ata i përgjigjen nga thellësia e shpirtit “Lebbejk!”.

Kibla fizike e besimtarëve, Qabja është një shtëpi modeste dhe e lashtë. Por madhështinë e saj, e shohin vetëm ata që kanë të hapur syrin e zemrës. Ata që e kryejnë obligimin e haxhit dhe që i regjistrojnë në shpirt këto zëra, me shijen e të qenit mysafirë të Zotit, ndërtojnë Qaben shpirtërore. Të ndërtosh një zemër me thëniet “lebbejk”, me tavafin rrëth Qabes dhe me drejtimin nga Kibla, dotë thotë të jesh i kthyer gjithnjë nga Zoti.

# Të gjithë për një vend Një vend për të gjithë

Mr. sci. Zymer Ramadani

**"Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo e, kush nuk e beson, (ai nuk e viziton); Allahu nuk ka nevojë për (ibadetin që bëjnë) njerëzit.** (Ali Imran, 97)

Sic ka rregullat dhe obligimet e veta çdo ibadet – adhurim, ashtu edhe kryerja e haxhit ka disa trajta që i japid një kuptim të mirëfilltë për të qenë i vlefshëm. Pra, meqë ibadetet kanë një aspekt shpirtëror, moral e material edhe haxhi i përmban këto aspekte, duke dalë në pah më shumë aspekti material, ngaqë haxhi, si obligim, nuk lejohet të kryhet në ndonjë vend tjetër, veç në Mekke Mukerreme, në një kohë të caktuar e jo jashtë saj. Haxhi, si obligim i pashmangshëm, është vërtetuar sipas Kuranit, sunetit dhe me argumente nga marrëveshja e dijetarëve. Pas një polemizimi, dhe, në fund, me realizimin e marrëveshjes së Hudejbijes në mes myslimanëve dhe mushrikve, Allahu (xh.sh.), urdhëron haxhin dhe tregon normën e tij në mënyrë të detajuar:

**"Ekryeni haxhin dhe umrën për hir të Allahut, po në qoftë se pengoheni, atëherë (therni për kurban) çka t'ju vijë më lehtë prej kurbanëve e mos i rruani kokat tuaja, derisa kurbani të arrijë vendin e caktuar. Po kush është prej jush**

*i sëmurë ose ka mundim koke (e rruhet para kohe), kompensimi është: agjërim, sadaka ose kurban. E kur jeni të sigurt, ai që bën umrën para haxhit (duhet therë) një kurban që i vjen më lehtë. Nëse nuk ka, le të agjerojë tri ditë gjatë haxhit e shtatë ditë kur të kthehet, pra dhjetë ditë të plota. Ky është rregull për ata që nuk e kanë shtëpinë pranë xhamisë së shenjtë. Kini frikë Allahun dhe dijeni se Ai është ndëshkues i rreptë".* (Bekare, 196)

Haxhi është një ibadet i veçantë që ia rrit dhe ia shton edhe më tepër myslimanit bindjen tek Allahu, e afrom atë edhe më shumë tek Ai dhe e formon, duke i dhënë energji dhe besim të thellë. Ai është një mjet që ia lehtëson myslimanit udhëtimin e tij drejt ahiretit. Që nga momenti kur personi ka bërë nijet, haxhi e edukon dhe e kalit myslimanin, duke i dhënë një trajtë tjetër jetës së tij shpirtërore. Me këtë vizitë, Myslimani bën një hap të ri në jetën e tij, hap një kalendar të ri në hapat e tij të jetës dhe e bën atë më bujar nga çishte më parë. Kur të arrijë para Madhërisë së Krijuesit, robi shpreh gabimet e tij, duke kërkuar faljen dhe mëshirën e Allahut (xh.sh.), duke u penduar me një pendim të sinqertë të papërsëritur më pas. Haxhi i bën njerëzit të një shkalle, duke i obliguar ata që të zhvishen nga veshja e dynjasë dhe të kenë një veshje të njëjtë. Kjo veshje quhet iħram, pra të gjithë në një nivel, pa dallim kom-





bësie, ngjyre apo karriere. Ai ecën mbi një vend të shenjtë dhe historik, duke kujtuar momentet e İbrahimit (a.s.) dhe familjes së tij e, më pas, duke kujtuar, po ashtu edhe kohën e Muhamedit (a.s.) dhe kryerjen e këtij obligimi nga ana e tij. Përveçse është në favor të vetë haxhiut, në të njëjtën kohë haxhi i mbledh myslimanët në një vend, që ata të njihen me njëri-tjetrin dhe të krijojnë një afërsi vëllazërore.

### HAPAT E PARA DREJT KËSAJ RRUGE

Personi që ka vendosur të kryejë këtë obligim madhështor me një vlerë të madhe shpërblimi dhe me një kosto të madhe ekonomike duhet që:

**1. Nijeti** - Të ketë një qëllim të pastër. Qysh nga dalja prej shtëpisë, të dijë se këtë është duke e bërë vetëm për hir të Allahut. Nga ana tjetër, duhet që ky nijet të mos i njolloset me ndonjë qëllim tjetër të kësaj bote, me qëllim që ta meritojë të quhet haxhi.

**2. Pagimi i borxheve** - Një nga çështjet që e zbehin këtë ibadet të pastër, është edhe ajo që lidhet me pasjen e borxheve të larta nga ndokush që ka vendosur të shkojë në Qabe. Personi në fjalë duhet të mos ketë borxhe të rënda, ngaqë nuk dihet a mund të jetë gjallë që t'i paguajë ato.

**3. Braktisja e dukurive negative** - Që haxhi të llogaritet si ibadet i pranuar, personi që ka vendosur ta kryejë atë, të mos merret me vepra që nuk janë të pëlqyera, si para haxhit, ashtu edhe pas tij. Pra të bëjë një përgatitje shpirtërore, duke e zbatuar këtë edhe me vepra.

**4. Udhëtimi drejt Shtëpisë së Shenjtë** - Njeriu shpeshherë bën vizita dhe udhëtime nga më të ndryshmet, por ato janë ditore dhe nuk kanë ndonjë vlerë të lartë fetare. Mirëpo, ky udhëtim drejt Qabesë, nuk është si të tjerët. Ky është një udhëtim i shenjtë dhe ka peshën e vet të shpërblimit.

### VIZITA NGA GJITHË RRUZULLI TOKËSOR

Të gjithë myslimanët, të një zëri, me qëllim të njëjtë, me rroba dhe obligime të njëjta, nga anët dhe viset e ndryshme të botës, të bardhë apo të zinj qofshin, marrin rrugën për ta vizituar Bejtullahin, duke lënë anash çdo gjë tjetër dhe duke synuar vetëm shpërblimin dhe kë-naqësinë e Allahut. Në fillim, kur haxhi u bë obligim, Muhamedi (a.s.), i paralajmëroi myslimanët për një obligim të tillë dhe vizitat filluan. Menjëherë, shokët e Pejgamberit (a.s.), filluan përgatitjet e tyre për të kryer këtë obligim. Më pas, kur lajmi u përhap më gjërë jashtë Medinës, të gjithë njerëzit filluan ta zbatonin dhe të krijonin mundësitë për haxh. Filluan nga të gjitha anët të shkonin në haxh, turma të mëdha. Këtë angazhim të madh të besimtarëve, Allahu (xh. sh.), e përshkruan në këtë mënyrë në Kur'anin Fisnik: "**Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë dhe kalorës me deve të rraskapitura prej rrugëve të largëta**"<sup>1</sup>

Ata që iu bashkangjiten Pejgamberit (a.s.), atë vit ishin të shumtë

1. Haxhxh, 22/27

në numër. Thuhet se ka pasur rreth 114000 apo edhe më tepër. Atë vit janë therur njëqind deve për kurban. Ndërsa Pejgamberi (a.s.), me shokët e tij ishin në rrugë drejt Qabes, ai u foli atyre për haxhin, rregullat dhe obligimet e tij. Kur arritën në zonën e quajtur Dhu'l-Hulejfe, gjegjësisht në Akik, iu drejtua të pranishmëve duke u thënë: "Më erdhi mbrëmë Xhibrili dhe më tha: "Të falësh namaz në këtë luginë të bekuar dhe të thuash: Bëra nijet për haxh dhe për umre."<sup>2</sup> Më pas, kur ata arritën në Qabe, përsëri meleku i Shpalljes Xhibrili (a.s.), iu drejtua Muhamedit (a.s.), duke i thënë:<sup>3</sup> **"Ja Muhamed! Urdhëroji shokët e tu që ta ngrenë zërin në "telbije", kur të thonë "Lebbejk Allahumme Lebbejk, Lebbejk lâ sherike leke Lebbejk. Înne'l-Hamde ve'n-Ni'mete leke ve'l-Mulk lâ sherike leke" Në Urdhrin tënd, o Allah, Ti që nuk ke shok (të dytë) Lavdërimi, begatitë, pushteti dhe pasuria janë Tuajat. Ti nuk ke shok", sepse kjo është nga shenjat e haxhit."**<sup>4</sup>

Çdo mysliman të mundohet ta kryejë një haxh të tillë, në mënyrë që ta bëjë sa më lehtë dhe të fitojë sa më shumë shpërblime. Siç u vërejt edhe nga ajeti, sot, nga të gjitha vendet e botës, myslimanët shkojnë për ta kryer këtë obligim, që shpërblimin e ka të madh. Pra, shpërblimi i haxhit është xheneti. Për ta plotësuar haxhin e tij dhe për ta kurorëzuar atë, pos kushteve tjera, Haxhiu duhet që patjetër të përbushë këto farze, pa të cilat nuk do të plotësohej haxhi si ibadet: a) Veshja e ihramit, b) Tavafi – rrotullimi shtatë herë pranë Qabes, duke filluar nga Haxheru'l-Esvedi (Guri i zi), c) Të qëndruarit një pjesë të ditës në fushën e Arafatit, ngaqë në lidhje me këtë Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Haxhi është (qëndrimi në) Arafat. Kush vjen në Arafat natën e Muzdelifës, para mëngjesit, ai e ka arritur haxhin...". E më pas, të kryejë edhe vaxhibet dhe sunetet e tjera, për të fituar shpërblime edhe më tepër.

### SHPËRBLIMI PËR HAXHIN

Ky adhurim kaq i rëndësishëm dhe kaq madhështor, sigurisht që ka edhe shpërblimin. E ku ka shpërblim më të mirë se atë që garanton Allahu (xh.sh.): shpërblimi i të qenit i përhershëm e jo për një kohë të shkurtër. Në lidhje me shpërblimin që ka haxhi, na tregon më së miri Muhamedi (a.s.), në hadithet që vijojnë: "Personi që kryen haxhin për kënaqësinë e Allahut (xh.sh.) dhe u shmanget të gjitha gjërat e këqija dhe mëkateve, do të kthehet pas haxhit i çliruar nga të gjitha mëkatet, ashtu siç ka qenë në ditën që ka lindur."<sup>5</sup> Hadithi tjetër rreth këtij përgëzimi, është: "Të gjitha mëkatet e kryera midis një umre dhe një tjetre, shlyhen dhe fshihen, ndërsa shpërblimi për haxhin mebrûr – të pranuar, pa dyshim që është vetëm xheneti."<sup>6</sup>

Të gjithë atyre që kanë vendosur ta kryejnë këtë obligim, ua pranoftë Allahu (xh.sh.), dhe ua shpërblefëtë këtë mund me shpërblimet që ka siguruar Ai për haxhiun! Amin.




2. Transmeton Buhariu, "Haxhxh, 16".

3. Doc. Dr. Omer Çelik, etj. "Personaliteti Shembullor..." f. 170 – 173. Progresi, Shkodër 2010.

4. Ibni Mâxhe, "Menâsik, 16".

5. Hadithin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

6. Muttefekun alejh.



# Një Ajet


*Me emrin e Allahut,  
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

**“Thirri njerëzit për haxh dhe ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta.”** (Haxh, 27)

Faltorja e shenjtë në Mekë është tempulli i parë i themeluar dhe dedikuar plotësisht adhurimit të Allahut. Ndërtuesit e saj janë dy profetë të mëdhenj, babë e bir. Njëri u hodh në zjarr, si dënim për injorimin që i bëri adhurimit të idhujtarisë, kurse tjetri, si bindje ndaj urdhrit të babait, e dorëzoi veten për t'u sakrifikuar. Kjo është shtëpi e zgjedhur për myslimanët si kibble (pikë orientimi gjatë adhurimit).

Drejtimi nga qabja, është themelor në kryerjen e namazit, por edhe për ibadete të tjera, sepse ajo është shtëpia e parë e shenjtë, e ndërtuar për ibadet në sipërfaqen e tokës, duke qenë edhe shenjë udhëzimi për gjithë besimtarët. Kjo është kibla, që bën të mundur, që të gjithë besimtarët, kudo që janë, në të katër anët e botës, ta ndjejnë veten si një organizëm i vetëm. Ky bashkim vjen si pasojë e adhurimit të një Zoti të vetëm, besimit të një pejgamberi dhe drejtimit drejt një orientimi. Ajo është një shtëpi, ku çdokush e ndjen veten të sigurt dhe kështu ka qenë gjatë gjithë historisë, para dhe pas islamit.

Pastaj Allahu urdhëroi Ibrahimin të ftojë njerëzit për të vizituar këtë shtëpi, simbol të monoteizmit, dhe e garantoj se do t'i përgjigjeshin ftesës së tij dhe do të dyndeshin nga të gjitha anët për të vizituar Qaben, vendin e shenjtë, në këmbë apo me mjete të tjera udhëtimi. Për hir të lidhjeve historike dhe shpirtërore, Allahu e bëri obligim, për bashkësinë myslimane, kryerjen e pelegrinazhit në faltoren e shenjtë. Rititet jetëdhënëse të kësaj vizite të shenjtë, gjallërojnë ndjenjat e besimimit dhe bindjes, dhe i forcojnë dhe më shumë ndjenjat e përkushtimit ndaj Zotit. Fjalët e thëna janë plot me domethënie fisnike. Haxhi, që është edhe shtylla e pestë themelore e islamit, së pari është rit fetar, por në mënyrën islame, është edhe tubim politik dhe panair tregtar. Ky është vendi i njohjes, është vendi ku takohet kjo botë me botën tjetër. Besimtarët mblidhen këtu nën një flamur të vetëm, flamurin e besimit. Nën këtë flamur, ku humbet çdo dallim racor. Kjo shtëpi është e mbrojtur nga Allahu dhe, që nga koha e Ibrahimit deri më, sot vazhdon të qëndrojë në funksionin e saj dhe do të vazhdojë deri në fund. Miliona besimtarë vazhdojnë të vijnë edhe sot e kësaj dite si përgjigje e thirrjes së Ibrahimit (a.s.). Kjo do të jetë kibla e myslimanëve deri në Ditën e Kijamitetit. Të gjithë besimtarët myslimanë do të kthehen nga Qabja, pa dallim kombi, race, gjuhe e ngjyre.



# Një Hadith

*Ebu Katađe, (r.a.) transmeton  
se Resulullahi (s.a.v.s.) është pyetur rrëth  
agjérimit të ditës së Arafatit dhe është përgjigjur:*

“Agjërimi i saj shlyen mëkatet e vtitit të kaluar dhe vtitit pasardhës.”

Dita e Arafatit është dita e nëntë e muajit dhilhixhe, një ditë para ditës së Bajramit. Dita e Arafatit është e veçantë, pasi qëndrimi në Arafat është prej kushteve të haxhit. Muhamed i (a.s.), ka thënë: “Haxhi është arafat”.

Prej agjérimeve vullnetare është edhe agjërimi në Ditën e Arafatit. Meqenëse dita e Arafatit është dita kryesore e haxhit, pra dita kur pelegrinët plotësojnë haxhin, nuk është e këshillueshme që të agjérohet nga peligrinët. Për ta, kjo ditë është si një ditë festë. Kurse për besimtarët që nuk kanë shkuan përmët kryer haxhin, agjërimi në këtë ditë, është i pëlqyeshëm. Siç na informon Pejgamberi (a.s.), agjërimi në këtë ditë shlyen mëkatet e vtitit të kaluar dhe vtitit pasardhës. Thënien “shlyen mëkatet”, dijetarët e kanë komentuar si shlyerje e mëkateve të vogla, sepse përmëkatet e mëdha është kusht pendimi i sinqertë. Kurse falja e mëkateve përvitin e ardhshëm, është komentuar nga dijetarët si mbrojtje nga rënia në mëkate. Pra, përhir të agjérimit të kësaj dite, Allahu i mbron besimtarët nga mëkatet në të ardhmen. Kurse një grup tjetër e ka komentuar si shlyerjen e mëkateve të ardhshme. Vlen të theksohet se nuk është shumë e rëndësishme mënyra se si falen mëkatet, por lajmi i mirë përmëshkimi i shlyerjen e mëkateve përdyjet, si pasojë e agjérimit përhir të Allahut në këtë ditë të bekuar.

## Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Mirësitet dhe mëshira e Allahut është e bollshme.
2. Agjërimi në Ditën e Arafatit është ekuivalent me faljen e mëkateve përvjet.



# BAJRAMI dhe KURBANI

Kjo botë është vendi i kurbetit mes eternales dhe të amshuarës për shpirtin. Bajramet janë ditët e vëllazërisë, gjëzimit dhe haresë, që Zoti u ka dhuruar robërve të Tij brenda kohës që rrjedh e shkon mes shfaqjeve të lumturisë dhe pikëllimit. Njeriu që është i qëndrueshëm në gjendjen e robërisë ndaj Zotit, mbledh frytin e sakrificës në rrugën e Allahut.

Megjithatë bajramet nuk janë kurrë ditët e lumturisë dhe gjëzimit vetjak, që përjetohen në rastet e pushimeve dhe festave. Bajramet janë ditët e haresë së përgjithshme.

Njeriu nuk mund të festojë, kur është fillikat i vëtëm. Pra, ashtu si nuk mund të mendohet një namaz bajrami vetëm me një njeri që e fal atë apo festimi i bajramit, kur nuk kemi të paktën një njeri me të cilin ta festojmë, po ashtu nuk mund të mendohet bajrami i kufizuar vetëm me rehatinë personale dhe të familjes, së cilës i takon. Përkundrazi, bajramet janë fushatat e fitimit mbi zemrat.

Bajramet janë ditë të bekuara që bëhen shkak që përgjegjësitë tonë, siç janë ruajtja e marrëdhënieve familjare, përjetimi i fesë islame në plan shoqëror, paqësimi i të hidhëruarve, gjëzimi i të ngratëve, të sëmurëve, të pikëlluarve dhe të dobtëve të realizohen në mënyrën më të plotë.

Festimet e bajrameve janë raste të rralla, që në shoqëri të forcohet shpirti i vëllazërisë. Brezat e shkuar të myslimanëve, nga tabaka-ja më e ulët deri tek ajo

më e larta e shoqërisë, i kanë kushtuar një rëndësi shumë të madhe festimit të bajrameve. Në shtetin osman, në sarajet e sulltanëve, ekzistonte një sallon i veçantë, ku festohej bajrami si shenjë e kujdesit të kreut të shtetit osman ndaj këtyre festave. Madje, në traditën e vjetër, urimet e para të bajramit fillonin nën hijen e selvive të pikëlluara tek varrezat me të parët tanë, që kanë aq shumë nevojë për lutjet e njerëzve të kësaj bote.

Kjo traditë duhet të vazhdojë. Së pari, të gjallët duhet të kujtojnë në këtë ditë festë të parët e tyre që kanë vdekur, duke shlyer detyrimin tonë të besnikërisë ndaj tyre, duke dhuruar sevapet e sadakave dhe punëve të hairit për shpirtrat e tyre dhe duke kënduar Fatiha për shpirtrat e tyre, në mënyrë që shpirtrat e të parëve tanë të lumturohen në këto ditë bajrami me këto dhurata të përshpirtshme që u dërgojmë.

Më pas duhet të urojmë dhe të festojmë bajramin së bashku me shpirtrat e pikëlluar, zemrat e hidhëruara, të ngrata, pa njeri dhe të vetmuar, që e kanë harruar se çfarë është gjëzimi dhe hareja. Teksa i gjegojmë me dhurata fëmijët tanë, duhet të kujtojmë jetimët e mbetur vetëm që nuk kanë një nënë apo baba që do t'u bënte qejfin në ditët e bajramit.

Besimtari nuk duhet të ngushëllojë veten me pretekstin se "kë të ndihmojë më parë", por duhet të përpinqet që të shpërndajë gjëzimin e bajramit në të gjitha zemrat e njerëzve tek të gjithë njerëzit që

mund tē zgjatet dora jonë e dhembshurisë.

**Ebu Said Hudri** tregon:

"Ditët e bajrameve të Ramazanit dhe të Kurbanit i dërguari i Allahut i fillonte duke dalë në namazgja dhe duke falur namazin. Pasi falte namazin, ngrivej në këmbë dhe kthehej nga xhemati. Xhemati nuk largohej, po qëndronte aty ku ishte falur. Në qoftë se ekzistonte nevoja që të dërgohej ndonjë grup ushtarësh në ndonjë vend, fliste rreth kësaj pune ose rreth ndonjë pune tjetër që duhej bërë. Gjatë hutbesë urdhëronte: "Jepni sadaka, jepni sadaka, jepni sadaka." Gratë dhuronin sadaka më shumë se burrat. Pastaj profeti largohej nga namazgjaja." (Muslim, Idejn, 9)

## EDUKIMI I SAKRIFICËS

Sakrifica është treguesi i dashurisë së vërtetë. Të duash Allahun, nënkupton të marrësh parasysh çdo lloj sakifice për hir tē Tij. Adhurimi i ibadetit është edukimi i sakrificës për Allahun, një kujtim i rrallë që na vjen prej proftit Ibrahim.

Ndër mend tē vjen pyetja se si arriti Ibrahimi tē fitonte titullin Halilullah? Si arriti ai t'ia falte zemrën vetëm Allahut? Ai ia ofroi shpirtin e tē birit Allahut, por gjeti shpirt tjetër. Ai e dhuroi pasurinë e tij bu-

jarisht, fitoi një begati tē paparë. Arriti deri aty sa tē sakrifikoonte birin e tij, që ishte pasardhësi i gjakut tē tij, por Zoti e përgëzoit se e kishte fituar sprovën. Kjo situatë tregohet kështu në ajetin kuranor:

*"Baba dhe bir u dorëzuan para urdhrit hyjnor dhe kur, Ibrahimi e shtriu Ismailin në tokë, dëgjoi një zë t'i thuhej: «O Ibrahim! Ëndrra jote u bë realitet.*

*Kështu i shpërblejmë ne bamirësit. Kjo qe me tē vërtetë një sprovë e vështirë për ty. Ne i dhamë atij një kurban, në vend tē birit. Bëmë që nami i tij i mirë tē vazhdojë tek ata që do tē vinin pas tij. Kështu i shpërblejmë ne bamirësit, sepse ata janë robërit tanë besimtarë."*

(Safat, 103-111)



*"Baba dhe bir u dorëzuan para urdhrit hyjnor dhe kur, Ibrahimi e shtriu Ismailin në tokë, dëgjoi një zë t'i thuhej: «O Ibrahim! Ëndrra jote u bë realitet. Kështu i shpërblejmë ne bamirësit. Kjo qe me tē vërtetë një sprovë e vështirë për ty. Ne i dhamë atij një kurban, në vend tē birit. Bëmë që nami i tij i mirë tē vazhdojë tek ata që do tē vinin pas tij. Kështu i shpërblejmë ne bamirësit, sepse ata janë robërit tanë besimtarë."*

(Safat, 103-111)

Kjo ndodhi na mëson se sakrifica në rrugën e Allahut nuk bëhet vetëm me pasuri, por me çdo gjë që na takon. Sahabët ishin në këtë konsistencë shpirtërore, prandaj ata i drejtosheshin me fjalët "Prindërit, pasuria dhe shpirti im t'u bëfshin kurban, o i dërguar i Allahut!" edhe për kërkësen më tē thjeshtë që shprehët i dërguari i Allahut.

Ata bënin garë me njëri-tjetrin se kush do ta mbërrinte i pari nderin që tē sakrifikojë ose sakrifikohej për hir tē Allahut dhe tē Profetit tē Tij. Mos vetëm sahabët? Madje gjithësia vetë sillej rrotull dritës së Tij si rrotullohen fluturat rreth dritës, edhe pse u digjen flatrat...

## MËSIME PËR T'U MARRË NGA GJITHËSIA...

**Abdullah bin Kurt** rrëfen:

Të dërguarit të Allahut i sollën pesë apo gjashtë deve për t'i bërë kurban. Devetë filluan të shkonin drejt Profetit sikur të prisnin se me cilën ka për të filluar për të bërë kurban.

Kur i thernin devetë dhe ato binin përdhe, Profeti se ç'thoshte me zë të ulët, por unë nuk e kuptoja. E pyeta atë që kisha para se çfarë thoshte Profeti dhe ai m'u përgjigji: "Thotë se kush dëshiron, mund të presë hise nga ky kurban dhe ta marrë me vete." (Ebu Davud, Menasik, 19/1765; Hakim, IV, 246/7522)

Nuk ka dyshim se fakti që devetë bënин garë me njëra-tjetrën se cila do të ishte e para që do të bëhej kurban prej duarve të bekuara të Profetit, nuk është gjë tjetër vetëm se një nga muxhizet e Profetit.

Kjo situatë është si rasti i trungut të drurit, që nuk e duroi faktin që Profeti u nda prej tij dhe filloj të qante për këtë arsy. Për më tepër, sipas një thënieje profetike: "Të gjitha kriesat e njihnin dhe e pranonin Profetin, me përashtim të njerëzve dhe xhinëve mëkatarë." (Ahmed bin Hanbel, *Musned*, III, 310.)

Sa mësimdhënës është fakti që edhe kafshët që Allahu i ka vënë në shërbimin e njeriut, ushqenin dashuri për Profetin, aq sa bënin garë me njëra-tjetrën se kush do t'ia dhuronte më parë jetën atij.

Ndonëse nuk do të kishin asnjë përfitim, si të kësaj bote ashtu edhe të botës tjetër, devetë hynin në garë me njëra-tjetrën se cila t'i bindej dhe i dorëzohej më shumë Profetit.

Po njeriu, krijesa që lumturinë në këtë botë dhe në botën e tjetër do ta fitojë në varësi të shkallës së bindjes ndaj Profetit, duhet ta peshojë me këtë shembull shkallën e emocionit të sakrificës që duhet të kemi përsa i përket dorëzimit ndaj mësimeve të Profetit.

### NJË KUJTIM

Ja dhe një tablo tjetër mësimdhënëse që ka ngjarë

në kohën e shekullit të lumturisë. Shumë vite më parë, në një vend të Rusisë një dem që do të bëhej kurban, i qetë dhe butë e butë pati shkuar vetë tek vendi ku do të bëhej kurban, a thua se e shpinte aty një dorë e padukshme, dhe pati shtrirë vetë kokën tek pusi ku do ta prisnin, ndërkohë që njerëzit e shihnin të shastisur këtë gjë. Zoti, mbështetur në sa e sa urtësi, ndonjëherë bën të ndodhin shfaqje të tillë rralla që ua ekspozon robërve të Tij.

Këto pamje që ekspozon Zoti, duke bërë përjashtime nga rregullat e përditshme, në fakt e gjithë gjithësia dhe dukuritë e saja janë një epope urtësish dhe enigmash, mbushur plot me mrekulli hyjnore.

E rëndësishme është të zoterojmë një shikim të thellë që do të mund të lexojë faqet e enigmave plot urtësi të librit të gjithësisë. Që zemra të mund të lexojë duke kërkuar të marrë mësim në përputhje

me fermanin hyjnор: "*Lexo me emrin e Zotit që krijon nga hiçgjëja.*" (Alak, 1)

### RESPEKTIMI I RREGULLAVE TË KURBANIT

Zoti i ka pajisur edhe kafshët e kurbanit me ndjeshmëri dhe i ka përzgjedhur ato për kryerjen e këtij adhurimi. Prandaj edhe dhembshuria, mëshira dhe kujdesi që tregohet për kafshët e kurbanit, në fakt është një shprehje e madhërimit të Zotit.

Për këtë arsy, Profeti i Mëshirës nuk pati lejuar që ky adhurim të kryhej pa ndjeshmëri dhe shkel e shko.

Në qoftë se kafsha që do të bëhet kurban është e etur, asaj i duhet dhënë ujë për të pirë, i duhen lidhur sytë dhe duhet shpënë tek vendi ku do të bëhet kurban me të butë.

Për më tepër, profeti pati ndërhyrë menjëherë kur e pati parë një person që e shpinte delen për ta bërë kurban, duke e tërhequr prej veshësh dhe e pati urdhëruar: "Mos e kap kafshën prej veshësh, por mbaje për qafe." (Ibn Maxhe, Dhebajh, 3) Veçanërisht u pati tërhequr vëmendjen myslimanëve që t'i mprehnnin mirë thikat, në mënyrë që kafshët të mos hiqnin keq kur të jepnin shpirt dhe pati urdhëruar:



*"Kur njëri prej jush do të presë kurban, ta kryejë sa më shpejt atë punë!"* (Ibn Maxhe, Dhebaih, 3.)

Një ditë Profeti pa njërin që po përgatitej të priste një dele. Ai e kishte shtrirë kafshën përdhe dhe ndër-kohë përpiqej të mprehte thikën. Para kësaj sjelljeje të ftohtë dhe të pamenduar mirë, Profeti i tha: "Mos dëshiron ta mbysësh kafshën më shumë se një herë? A nuk mund ta mprehje thikën para se ta shtrije përtokë kafshën?" (Hakim, IV, 257, 260/7570).

Kjo do të thotë se nuk duhet harruar fakti që prerja e kurbanit është një iradet, prandaj edhe duhet të ruhemë me kujdes nga sjelljet kaba që mund të prishin përshpirtshmërinë e këtij adhurimi.

Sic ka thënë edhe Enes b. Maliku: "Edukata gjatë veprimit, tregon se ajo vepër pranohet prej Zotit." Miqtë e Zotit kanë thënë: "Adhurimi e shpie njeriun në xhenet, ndërsa madhërimi dhe edukata gjatë kryerjes së adhurimit, e afrojn njeriun me Allahun."

Miku i Allahut Sami efendiu dhe im atë Musa efendiu, silleshin me kujdes, teksa prisnin kurban.

Ata nuk prisnin më shumë se një kurban tek një gropë. Ia lidhnin sytë kafshës dhe nuk e tërhoqin zvarrë me zor për tek vendi ku do ta thernin. Në qoftë se kafsha ishte e imët, dëshironin që ta merrnin në krah dhe ta shpinin me të butë aty. Tregonin kujdes që thika të ishte e mprehur mirë. Dëshironin që kafsha të therej lehtë dhe shpejt, duke mos dhënë shpirt me të keq dhe që gjaku të derdhej prej fytit.

Ata nuk uleshin ndenjur teksa kafsha bëhej kurban, por prisnin në këmbë derisa të rridhte gjithë gjaku që shpërhente nga fyt. Me rastin e kurbanit duhet të meditojmë dhe të falënderojmë Zotin, sepse ne mund të ishim në vendin e tij, po të mos kishim ardhur në këtë botë si njerëz. Prandaj edhe duhet ta shtojmë falënderimin (shukr), duke sjellë ndërmend begatinë e të qenit rob i Zotit.

Duke medituar për kafshët e kurbanit që japid shpirt, ne duhet të meditojmë rreth frysës së fundit që kemi për të thithur në këtë jetë. E thënë me pak fjalë, nëse është e mundur, duhet të qëndrojmë aty

ku prehet kurbani dhe të mendojmë këtë të vërtetë të jetës, duke e ndjerë thellë në shpirt momentin e ndarjes nga kjo botë.

Gjithashtu, në këto ditë të bekuara, nuk duhet të merremi me punë të parëndësishme, por t'i stolisim këto kohë të vyera me dhikrin e Zotit, me sadaka dhe, në mënyrë të veçantë, me tekbiret që janë karakteristike të lexohen në bajrame.

## BAJRAMI I DHURIMIT

Në kohën e shekullit të lumturisë, njerëzit përgatiteshin për bajram, duke dhënë sadaka, lëmoshë dhe duke qerasur të tjerët, në mënyrë që bajrami të pritej me sakrifica që bëheshin për Allahun.

Për më tepër, ata e dinin shumë mirë se të arrish të festosh bajramin si duhet, arrihej në shkallën e gëzimit të bajramit që u falej zemrave të pikëlluara. Kështu në kohën e të dërguarit të Allahut, kur po afronin ditët e Kurban Bajramit, erdhë një grup bedevish nevojtarë, të lodhur dhe të këputur ekonomikisht.

Për këtë arsy, Profeti pati urdhëruar që asnjë njeri që do të priste kurban, të mos e ruante mishin e kurbanit më shumë se tri ditë, por ta

shpërndante të gjithin. Kur mundësitet ekonomike u përmirësuan, Profeti e hoqi këtë kusht, megjithëse nuk mbeti pa i nxitur myslimanët që të ndihmonin njëri-tjetrin dhe të kujdeseshin për të varfërit. (Muslim, Edahi, 28, 34; Ebu Davud, Edahi, 9-10/2812.)

Dhe ne si umet i Muhamedit duhet të mendojmë kështu: Në ditët e sotme në botë kemi sa e sa besimtar mysliman që kanë harruar se çështë shija e një thele mishi, prandaj para së gjithash, ndihmat që do të dërgojmë me rastin e kurbanit, duhet t'u shpiem këtyre vëllezërve, në mënyrë që t'u qeshë fytura me rastin e festës së bajramit dhe gjithmonë duhet të përpinqemi që t'i fitojmë zemrat e tyre. Kjo fushatë e fitimit të zemrave të njerëzve, ndoshta është rruga më e shkurtër e mbërritjes tek pëlqimi dhe afërsia e Zotit.

Një ditë, njëri nga nxënësit që merrej me përkujdesjen ndaj Davud Tai-t, i shpie atij mish për të ngrë-

në. Davud Tai, vetëm se i hedh një sy mishit, por nuk zgjat dorën që të marrë ndonjë copë. Pyet:

-Ke marr vesh gjë për filan jetim, biri im?

Nxënësi përgjigjet:

- Siç e dini vetë!

Ai mik i vërtetë i Zotit, i thotë atëherë:

- Atëherë çoja atij këtë mish që më ke sjellë.

Nxënësi i sinqertë që dëshironte që mësuesi i tij të hante, qoftë edhe një copë mishi, këmbënguli, duke thënë:

- Dhe juve ju bë një kohë e gjatë që nuk vini një copë mish në gojë!

Davud Tai nuk pranoi, por i tha:

- Biri im! Po hëngra unë, ky mish do të përfundojë si çdo ushqim tjetër, por po hëngrën jetimet, ky mish ka për t'u ngritur lart në Arsh!

Sot, në shumë vende të gjeografisë islame, veçanërisht në Afrikë, jetojnë njërež aq të varfér, aq të ngratë, aq të pikëlluar dhe të uritur, saqë mishi i kurbanit që do t'u dhurohet atyre, ndoshta do të jetë dhurata më e bukur e bajramit që do të ngrihet lart në Arsh. Kurbani është mënyra më e hijshme e festimit dhe urimit të bajramit me vëllezërit tanë të fesë në botë.

Falë Zotit, në Turqi shoqata të ndryshme, mes tyre shoqata Hydaji, ka vjet që realizon aktivitete bajrami, si brenda dhe jashtë Turqisë. Ky aktivitet është edhe kryerja e një adhurimi fetar edhe siguron një kontribut sadopak, në mënyrë që vëllezërit tanë të fesë të zgjidhin hallet e tyre, ashtu sikurse formon një valë dashurie që sa e vjen e shtohet në botë ndaj Turqisë dhe popullit mysliman turk.

Gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve ne përballemi me tablo të tillë mësimdhënëse, të cilat na kujtojnë se sa me vend është shërbimi ynë dhe sa shumë duhet të lodhemi në këtë drejtim.

Ja një shembull prej tyre. Në Senegal, gjatë prerjes së kurbanit, një i varfér kishte mbërthyer paça-n e kafshës dhe kishte filluar të vraponë. Kur i kishin

kërkuar që të ndalonte, i ngrati kishte kujtar se nuk donin t'i jepnin dhe kishte thënë: "Jo nuk ndaloj. Do t'i çoj këtë copë nënës që të na bëjë për të ngrënë." Ishte larguar pastaj duke vrapuar.

Një rast tjetër, një i varfér, kur kishte ardhur tek vendi i kurbanit, kishte parë që mishi qe shpërndarë dhe që larguar duke kërkuar prej organizatorëve të kurbanit që të vinin vitin tjetër se kishte kohë që nuk e kishte shijuar një thelë mishi.

Në Etiopi pati ardhur edhe një grua e krishterë dhe, pasi u kishte thënë organizatorëve që ishte e krishterë, u kishte kërkuar që t'i jepnin një copë mishi, nëse ishte e mundur. Ata ia kishin dhënë një copë të mirë mishi me kënaqësinë më të madhe. (Lejohet që mishi i kurbanit t'u dhurohet jomyslimanëve të varfér).

Pasi kishte marrë copën e mishit, gruaja kishte shkuar dhe kishte puthur murin e xhamisë. Pra, ajo ishte prezantuar me mëshirën e fesë islame, me faktin që myslmani i sheh të gjithë krijesat me syrin e Krijuesit dhe kishte dashur të shprehte falënderimin e saj ndaj myslimanëve, duke puthur muret e xhamisë. Nuk duhet harruar se gjithmonë mirësia ngadhënen mbi njeriun.

Po kështu, ata që shkuan në Afrikë na treguan se kiste njerëz që kishin udhëtuar dy orë në këmbë, në mënyrë që të merrnin një copë mish dhe që shumë prej tyre, vetëm këtë mish kurbani hanin brenda vitit. Pa dyshim që edhe njerëzve të shtëpisë duhet t'u japim nga mishi i kurbanit.

Për këtë arsyen, kurbanet që janë vaxhib, nëse është e mundur, duhet t'i presim në vendin tonë, ndërsa paratë e kurbaneve që janë sadaka dhe nafile, bëjmë mirë t'i dërgojmë jashtë Turqisë që të priten, atje në mënyrë që të festojmë dhe t'ua urojmë edhe vëllezërvë tanë myslimanë që gjenden aty, duke ua dhuruar atyre mishin e kurbanit. Veçanërisht, Afrika ka një vend të rëndësishëm për ne.

Disa prej sahabëve të dalluar të Profetit qenë afrikanë. Bilal etiopian, Zejd b. Harithe, Usame, qenë të gjithë afrikanë. Ata qenë vëllezërit e parë myslimanë që i shërbyen fesë islame, duke rrezikuar edhe jetën

e tyre për këtë fe. Prandaj ndihma që mund t'i japim Afrikës, është detyrimi ynë i besnikërisë ndaj këtyre sahabëve.

Profeti ynë e përmbushte në mënyrën më të plotë këtë detyrim. Kështu një herë, përfaqësuesit e mbretit të Etiopisë erdhën tek Profeti. Profeti u interesua për ta, madje edhe u shërbeu me duart e tij. Saha-bët dëshiruan që t'u shërbenin ata përfaqësuesve të mbretit dhe që profeti Muhamed të rrinte rehat, por Profeti u tha kështu: "Këta njerëz u patën krijuar vend sahabëve të mi që emigruan në Etiopi dhe qenë sjellë mirë me ta. Unë dëshiroj që t'u shërbej sot atyre, si shenjë falënderimi për atë që kanë bërë." (Bejhaki, *Shuabu'l-iman*, VI, 518, VII, 436.).

Po kështu, Profeti Muhamed pati falur namaz gjabi, kur pati vdekur Nexhashi, mbreti i Etiopisë, që i kishte ruajtur sahabët e profetit, dhe i kishte urdhëruar sahabët që të luteshin për të. (Muslim, Xhenai, 62-68; Ahmed, III 319, IV 7.)

Sot, ne duhet të bashkohemi me këtë shenjë besnikërie të Profetit tonë dhe duhet t'i bëjmë vëllezërit tanë afrikanë të ndjejnë që vëllezërit e tyre myslimanë në Turqi, mendojnë edhe për ta.

Pa dyshim që Afrika nuk është vendi i vetëm që pret ndihmë. Në të gjitha vendet e botës, myslimanët janë vëllezërit tanë, por, po të marrim parasysh vështirësitë e mëdha dhe varférinë që jetohet, dëshirojmë që të gjithë vëllezërit tanë të marrin pjesë, sipas mundësive që kanë, në këtë udhëtim ndihme me rastin e kurbanit, që të ndihmojmë gjithë vëllezërit tanë nevojarë në Afrikë, Lindjen e Mesme, Pakistan, Rusi, Ballkan dhe ish kufijtë e shtetit osman.

Ata kanë nevojë për ndihmën tonë, ndërsa ne kemi nevojë për duanë e tyre Allahu qoftë i kënaqur me ty! Buzëqeshja që do të shndrisë në fytyrat e tyre, do të jetë dhurata e vërtetë e bajramit për ne. Ashtu siç kanë thënë edhe miqtë e Zotit: "Bajrami i vërtetë nuk është për atë që vesh rroba të reja, por për atë që është i sigurt nga dënim i Zotit."

Përgatitja për bajramin nuk bëhet vetëm duke

blerë rroba të reja, por më shumë me një shpirt të lumtur që i takon bajramit. Miku i Zotit, Mevlana ua tërhiqte kështu vëmendjen atyre që mjaftoheshin vetëm me anën e jashtme, duke mos u treguar rëndësi kushteve shpirtërore të bajramit:

*Trego kujdes se mos përpinqesh të bësh kurban hijen e cipit!*

Për më tepër, mishi i kurbanit është hije, e vërteta e kurbanit është kuptimi që shpreh ai. Zemra e njeriut duhet të jetë e ndërgjegjshme për këtë gjë. Në ajetin fisnik thuhet: "*As mishi, as gjaku i kurbanit nuk do të shkojë tek Allahu, por vetëm devotshmëria juaj do të ngrihet lart tek Ai.*" (Haxh, 37.)

Treguesi më i lartë i besimit është dhembshuria. Mëshirë dhe dhembshuri, do të thotë që atë që kemi ta ndajmë me atë që nuk e ka atë gjë dhe të përpique-mi që ata ta kompensojnë mungesën e shumë gjë-

rave bazë. Nga ky aspekt, kurbani është një adhurim i rrallë që mpreh ndjenjën e mëshirës dhe dhembshurisë nëpër zemra.

Bajrami i vërtetë është për besimtarë fatlumë që, të kapluar nga këto ndjenja mëshire dhe dhembshurie, kanë arritur të marrin diplomën e shpëtimit të përhershëm, sepse ia kanë kushtuar jetën dhe pasurinë e tyre Zotit. Janë besimtarët sakrifiques, bujarë, që përpiken me gjithë shpirt që të marrin prej Zotit një urim bajrami që vjen si rrjedhojë e një duaje të pranuar tek Zoti, nga një zemër e pikëlluar, të cilës i kanë mundësuar të festojnë ditët e bajramit.

**NGADHNJIMI MË SPEKTAKOLAR ËSHTË TRIUMFI MBI ZEMRAT. LUM ATA QË ARRJNË TË SHNDËRROJNË ZEMRAT E TYRE NË DERGJAHUN E MËSHIRËS PËR GJITHË BESIMTARËT DHE KRIJESAT, DUKE U MUNDËSUAR ATYRE TË RILINDIN NË ATË DERGJAH...**

**Zoti na mundësoftë një jetë të begatë, ashtu siç janë ditët e Ramazanit, netët e mëdha, dhjetë ditët e para të Dhilhixhes. Bëftë që fryma jonë e fundit të jetë hapi ynë i parë drejt një bajrami të përhershëm të lumturisë dhe prehjes!**

Amin!..



# DIPOTOZITAT e namazit kaza dhe namazeve sunete

## HYRJE

Institucioni i namazit është më i rëndësishmi në fenë islamë, ngaqë ky është një obligim që kurrsesi nuk lejohet të braktisitet dhe të neglizhohet. Ndaj është më se e domosdoshme që çdo mysliman t'i njohë rregullat dhe parimet që kanë të bëjnë me këtë institucion.

Kryerja e namazit jashtë kohës së caktuar, që njihet si *kaza* dhe respektimi i namazeve fakultative (sunete-nafile), janë më se të domosdoshme për besimtarin. Ai duhet të ketë njohuri rreth këtyre çështjeve, me qëllim që të jetë sa më i kujdeshshëm dhe i përpiktë në kryerjen e namazit.

Duke u nisur nga ky parim, dijetarët kanë përcaktuar normat-dispozita, që kanë të bëjnë me namazin e që në vi-jim do të shpjegohen.

### Namazi kaza:

Zbatimi i namazit me kohë, në shkencën e *fikhut* njihet si (النافع). Namazi që nuk falet me kohë quhet *kaza* (قضاع). *Musaliut*, të cilat i ka kaluar ndonjë namaz *farz apo vaxhib*, i duhet të bëjë *kaza*, por gjithashtu duhet kërkuar falje nga Allahu (xh.sh.), pse është vonuar zbatimi i obligimit me kohë.

### Arsyet të cilat lejojnë **që namazi të falet më vonë**

Rastet kur *musaliu* ka të drejtë të vonojë faljen e ndonjë namazi, me qëllim që të mos konsiderohet mëkatar janë:

1. Arsyet të cilat shkaktohen jo nga vullneti i *musaliut*, si: gjumi, alivanosja, harresa etj.

2. Arsyet që shkaktohen jo nga vullneti, por janë të natyrsme, si: sëmundja e papritur, luftimet në front, operimi i domosdoshëm nga ana e mjekut etj.

### **ARSYET QË NAMAZI TË MOS JETË OBLIGIM, PËR SHKAK TË ÇMENDURISË, ALIVANOSJES DHE DOBËSIMIT FIZIK**

Nëse *musaliu* e ka goditur çmenduria, alivanosja etj. dhe kjo gjendje zgjat aq sa të kalojnë gjashtë kohë të namazit, kur të përmendet, ai nuk duhet të bëjë *kaza* namazet që i kanë mbetur pa falur, gjatë kësaj gjendjeje. E nëse ndodh që gjatë

kësaj gjendjeje *musaliut* t'i kalojnë pesë kohë a më pak, kur të përmendet duhet t'i bëjë kaza ato namaze.

### Shënim:

Nëse ndodh që njeriu ta humbë vetëdijen me gjëra të ndaluara, siç është alkooli, ai obligohet me *kaza*. Po ashtu është obligim falja e namazit *kaza* për atë që nuk është në gjendje të mirë psikike, si pasojë e barërave të lejuara. Gjithashtu, femra nuk obligohet për t'i bërë *kaza* namazet e mbetur, për shkak të menstruacioneve (*hajz*) dhe gjakderdhjes së lehonisë (*nifas*). *Kaza* nuk kërkohet të bëhet namazi edhe nga personi, i cili është bërë renegat (*murted*).

### Namazet, të cilat duhet të bëhen kaza

Namazet që duhet të bëhen *kaza* janë pesë kohët e namazit, namazi i *vitrit* dhe namazet që *musaliu* ia ka bërë obligim vetes, duke bërë besatim (*nedher*).

Ai që ka qenë duke falur namaze *nafile* dhe për një moment e ka prishur, e ka *vaxhib* ta bëjë *kaza*. Namazet *sunete* nuk bëhen *kaza*, përveç *sunetit* të sabahut, i cili ka mundësi të bëhet *kaza*, nëse dëshiron *musaliu*.

Namazi i bajrameve dhe i *xhenazes* nuk bëhet *kaza*.

### **SI DHE KUR BËHEN KAZA NAMAZET?**

Namazi, i cili ka kaluar pa u falur duhet të bëhet *kaza*, kështu, nëse *musaliut* i kalon pa falur ndonjë namaz, duke qenë udhëtar, duhet ta bëjë *kaza* si namaz i udhëtarit, edhe nëse është vendas-*mukim* apo anasjelltas. Namazet *kaza* lejohet të falen në çdo kohë, përveç në kohët kur të falurit është *mekruhi tahrimen*, në të cilat nuk lejohet të bëhet *kaza* asnjë namaz.

### **SAHIBU TERTIBI DHE TË BËRIT KAZA**

*Sahibi tertib* konsiderohet ai person, i cili e ka falur vazhdimisht namazin, qysh prej kohës kur i është bërë obligim. Kur i ndodh që ndonjë namaz t'i ketë kaluar pa falur, kur të bëjë *kaza*, atij i duhet të falë namazin që ka kaluar e pastaj namazin e kohës.

*Sahibi tertibi* e humb *tertibin* në namaz për këto shkaqe:

1. Po qe se namazet, të cilat i kanë kaluar pa i falur janë

gjashtë, njëra pas tjetrës. Si p.sh., i ka mbetur pa falur sabahu, dreka, ikindia, akshami, jacia dhe sabahu.

2. Nëse harron të falë namazin e pa falur, para namazit, të cilit i ka hyrë koha, pra, i ka mbetur pa falur dreka dhe ky, duke harruar se nuk e ka falur, fal ikindinë. Në këtë rast e humb të drejtën e *tertibit*.

3. Kur i ngushtohet koha për t'i bërë *kaza* namazet e mbe-tura, para se të hyjë koha e namazit *eda*.

Shënim: Personi, i cili nuk është *sahibi tertib*, kur të bëjë *kaza* namazin e pa falur, duhet që së pari të falë njëherë namazin e kohës e pastaj namazin e mbetur. Kështu, nëse i ka kaluar namazi i drekës dhe ka hyrë koha e ikindisë, ai së pari duhet falur ikindinë e pastaj namazin e drekës. Ky rregull nuk vlen për atë që nuk është *sahibi tertib*.

### TE BËRIT KAZA ATO NAMAZE, KUR NUK U DIHET NUMRI

Atij personi, të cilit i kanë mbetur shumë namaze pa falur dhe nuk është në gjendje ta përcaktojë numrin e namazeve të mbetura, i obligohet që të falë *kaza*, deri sa të bindet se i ka plotësuar namazet e mbetura.

Sa i përket mënyrës së *nijetit*, *musaliu* në këtë rast ka mundësinë e zgjedhjes: ose të bëjë *nijet* që të falë, ta zëmë, ikindinë e parë që i ka mbetur pa falur ose të bëjë *nijet* të falë ikindinë e fundit që i ka mbetur pa falur.

Rezume:

Mosfalja e namazit farz në kohën e tij, pa arsyen e fortë, konsiderohet si mëkat i madh. Nga kjo rrjedhin dy mëkate. Njëri për lëshimin e namazit, i cili shlyhet me plotësimin e namazit më vonë, ndërsa i dyti për shtyrjen e kryerjes së namazit dhe që shlyhet duke bërë tevbe (pendim) dhe duke kërkuar falje (istigfar) prej Allahut (xh.sh.).

Një nga arsyet e drejta për shtyrjen e faljes së namazit është frika nga armiku, nëse nuk është e mundur të kryhet ulur, qoftë edhe nëse falësi nuk është drejtuar nga Kibla ose duke ikur. Gjithashtu, arsy e vlefshme është frika e mjekut për gjendjen e të sëmurit.

Falja në kohë (*edaen*) nënkupton kryerjen e obligimit në kohën e tij të caktuar. Kryerja e obligimeve, pas kalimit të kohës së caktuar saktësisht, është plotësim i namazit (*kadaen*). Përsëritja (*i'ade*) është bërja e veprimeve të njëjtë, qoftë në kohën e tyre ose më pas, në bazë të qëndrimit, që çdo namaz që kryhet krahas mekruh tahirimit, duhet të përsëritet, qoftë në kohën e tij ose më pas, si për shembull, nëse mungon një vaxhib i namazit,<sup>1</sup> siç është përmendor më sipër.

Plotësimi i namazit mund të bëhet në çdo periudhë të jetës. Nuk është i vlefshëm të bërit kaza në tri kohë, në të cilat është e ndaluar falja, siç është theksuar më sipër.

Është obligim të nxitohet me plotësimin e namazeve të lëshuar. Lejohet shtyrja e plotësimit, nëse ka shumë namaze të lëshuar me arsy. Arsy e vlefshme konsiderohet, ta zëmë, zënia me punë,

me të cilën njeriu mban familjen e vet.

Plotësimi i namazeve të lëshuar është më prioritari se falja e nafileve, përvèç suneteve të rregullta dhe atyre që theksohen në hadithet e Pejgamberit të Allahut (a.s.), siç është, për shembull, falja e namazit nafile, pas marrjes së abdestit, tehijjetul-mesxhid ose namazin e duha-s.

Plotësimi i namazit farz është obligim i prerë, ndërsa plotësimi i vaxhibëve, siç janë namazi i vitrit, namazi i përgjérimit (*nedhër*) ose nafiles, e cila është kryer gabimisht, është vaxhib.<sup>2</sup>

Argumenti për bazën sheriatiko-juridike të plotësimit të namazeve të lëshuar, është praktika e Pejgamberit të Allahut (a.s.) dhe fjalët e tij:

*Kush e harron namazin, le ta falë kur të kujtohet. Nuk ka kompen-sim tjetër për të pos kësaj (**dhe kryeje namazin për t'më kujtar Mua**)<sup>3</sup>*

Gjatë një udhëtimi, Muhamedi (a.s.), bashkë me sahabët e tij e kishin fjetur namazin e sabahut. Ebu Katade deklaron: "I pari që u zgjua ishte Pejgamberi i Allahut (a.s.), të cilit dielli tashmë ia kishte ndriçuar shpinën. U ngritëm me nxitim, ndërsa ai na tha: *kaleroni!* Hipëm në deve dhe udhëtuam, gjersa dielli u ngrit në qiell, pastaj ai zbriti dhe kërkoi t'i sillej ena për marrjen e abdestit, të cilën e kisha unë dhe ku kishte pak ujë. Mori abdest e pastaj Bilalli thirri ezanin për namaz. Pejgamberi (a.s.), fali dy reqate e pastaj edhe namazin e sabahut, mandej veproi njësoj siç bënte çdo ditë."

Nga Xhabiri transmetohet që Omer ibni Hattabi kishte ardhur ditën e betejës në Hendek, pas lindjes së diellit dhe kishte filluar t'i qortonte jobesimtarët nga fisi Kurejsh. Mandej tha: "O Pejgamber i Allahut, nuk arrita ta fal namazin e iqindisë, deri pak para perëndimit të diellit." Pejgamberi i tha:

*Për Allahun, unë ende nuk e kam falur.*"Shkuam në But'han dhe morëm abdest për namaz. Ai fali iqindinë pas perëndimit të diellit, pastaj edhe namazin e akshamit."<sup>5</sup>

Të bërit kaza namazin, është njësoj si edhe falja e tij në kohën e caktuar. Kështu, namazi i lëshuar, duhet të falet sipas radhës së tij. Nga Ibni Mes'udi transmetohet se idhujtarët e kishin penguar Pejgamberin (a.s.), të falte katër reqate namaz, ditën e betejës në Hendek. Kur kaloi një pjesë e mirë e natës, kërkoi nga Bilalli të thirre ezanin. Kur recitoi ikametin, falën namazin e drekës, pastaj sërisht bëri ikamet dhe falën iqindinë. Mandej sërisht bëri ikamet dhe falën namazin e akshamit. Sërisht bëri ikamet dhe falën jacinë."<sup>6</sup>

Radhitja e farzeve të pesë namazeve ditore dhe vitrit edhe me rastin e faljes plotësuese, edhe kur falet në kohë të caktuar, është obligim. Gjithashtu, është obligim të bëhet radhitja në mes namazeve të lëshuar dhe namazeve të rregullt, nëse ka mjaft kohë

2. Reddul-muhtar, 1/488.

3. Hadithin e shënon El-Buhariu, 597.

4. Hadithin e shënon Muslimi, 681.

5. Hadithin e shënon El-Buhariu, 596.

6. Hadithin e shënon Et-Tirmidhi.



1. Reddul-muhtar.

për t'u falë të gjitha namazet e pafalura.

Radhitja nuk është e obligueshme, nëse nuk ka mjaft kohë që të falet namazi i lëshuar, para namazit të rregullt. Nuk mund të shtyhet falja e namazit të rregullt dhe të lëshohet koha e tij, pér të kompensuar namazin e lëshuar. Gjithashtu, radhitja nuk është obligim, si pasojë e harresës, ngase në atë rast nuk mund të kompensohet namazi i lëshuar. Allahu nuk e rëndon asnjërin mbi fuqinë e tij.

Radhitja nuk është e obliguar gjithashtu edhe kur grumbullohen një numër i madh namazesh të lëshuar, si pér shembull, kur janë gjashtë namaze të lëshuar dhe namazi i vitrit, sepse namazet tashmë përsëriten, ndërsa obligimi i radhitjes në këtë rast paraqet vështirësi.<sup>7</sup>

Është obligim i atij që kompenson namaz, ta caktojë saktësisht cilin namaz të lëshuar kompenson (plotëson), nëse është fjalë pér një numër më të vogël namazesh të lëshuara. Mirëpo, nëse bëhet fjalë pér një numër më të madh, me rastin e kompensimit duhet bërë një cilin namaz plotëson (kompeson). Pér shembull, nëse i kompenson namazet e lëshuar të drekës, duhet të bëjë njët të kompensojë namazin e parë të lëshuar ose namazin e fundit të lëshuar.

Nuk është mirë që të kompensojë namazet para njerëzve, ngaqë mos-falja e namazit në kohën e tij është mëkat.

#### NAMAZET SUNETE DHE NAFILE

Namaze sunete konsiderohen ato namaze, të cilat Pejgamberi (s.a.v.s.), i ka kryer vullnetarisht, duke mos i pasur obligim, por vetëm që t'i afrohet sa më shumë Allahut të Lartësuar.

Namaze nafile janë ato namaze, të cilat myslimanë i kryen vullnetarisht, duke mos i pasur obligim, por pér respekt të Allahut të Mëdhëruar.

Në namazet nafile përfshihen të gjitha llojet e namazeve që nuk janë të obliguara pér t'u zbatuar. Në këtë grup hyjnë edhe namazet sunete, mirëpo, namazet sunete kanë më shumë sevab se sa namazet nafile.

#### NORMA E NAMAZEVE NAFILE

Myslimanit i rekomandohet që t'i zbatojë namazet nafile dhe, po qe se i zbaton, ka shpërblimin e Allahut (xh.sh.), e nëse nuk i zbaton, nuk ndëshkohet nga Ai.

Namazet sunete dhe llojet e tyre

Namazet sunete ndahen në dy lloje:

1. Sunetet e radhitura. Në këtë grup të suneteve bëjnë pjesë ato namaze të vullnetshme-joobligative, të cilat Pejgamberi (s.a.v.s.), i ka falur para dhe pas namazeve farze. Këto lloje të namazeve sunete ndahen në dy grupe:

a. - Sunetet e fortë. Si sunete të fortë konsiderohen ato sunete, të cilat Pejgamberi (s.a.v.s.), i ka kryer gjithmonë dhe rrallëherë ka ndodhur t'i ketë lënë pa falur. Si sunete të fortë konsiderohen:

7. El-Hedijjetul-'ata'ijje, 93.

1. Suneti i sabahut<sup>8</sup>. Po qe se namazi i sabahut falet me xhemat dhe personi e gjen xhematin në farz, atëherë, nëse fiton bindjen se do ta arrijë imamin, do ta falë sunetin dhe do t'i bashkohet imamit, qoftë edhe në rekatin e dytë. E nëse frikësohet se do t'i kalojë falja me xhemat, nuk e fal sunetin, por i bashkohet xhematin, kurse sunetin e sabahut e fal si kaza pas lindjes së diellit.

2. Katër rekaret e para të drekës.<sup>9</sup>

3. Dy rekaret e mbrame të drekës. E preferuar është që këtyre dy rekateve t'u bashkangjiten edhe dy rekate të tjera dhe të bëhen katër.<sup>10</sup>

4. Suneti i akshamit.

5. Dy rekate sunet pas farzit të akshamit.

6. Dy rekate sunet pas farzit të jacisë.

Shënim:

Vlera e faljes së këtyre suneteve mund të argumentohet vetëm me hadithin:

"Atij që gjatë ditës dhe natës fal dymbëdhjetë rekate, i është ndërtuar një shtëpi në xhenet". (Transmeton Muslimi). Në këtë hadith, me shprehjen dymbëdhjetë rekate, përfishihen

këto sunete: dy rekate para farzit të sabahut, katër rekate para farzit të drekës, dy rekate pas farzit të drekës, dy rekate pas farzit të akshamit dhe dy rekate pas farzit të jacisë.

7. Katër rekate para farzit të xhumasë dhe katër pas farzit të xhumasë **me një selam**. Pejgamberi (s.a.v.s.), ka falur gjithmonë katër rekate sunet para farzit të xhumasë me një selam e, po kështu, edhe pas farzit të xhumasë.

b. - Sunetet jo të fortë. Sunete jo të fortë konsiderohen ato sunete, të cilat nganjëherë Pejgamberi (s.a.v.s.), i ka lënë pa i falur. Sunete të tillë konsiderohen:

1. Të falurit katër rekate të dy suneteve të mbrame të drekës.

2. Katër rekate sunet para farzit të ikindisë.

3. Katër rekate para farzit të jacisë.

2. - Sunete jo të radhitura. Në këtë grup të suneteve bëjnë pjesë ato sunete, të cilat nuk kanë lidhmëri në duhen falur para apo pas farzeve. Edhe sunetet e tillë mund të jenë sunete të fortë dhe jo të fortë. Si sunete të tillë mund të përmendim:

1. - Namazi i teravisë. Ky lloj i namazit është suneti mukekedenet i fortë. Ky lloj i namazit është sunet pér t'u kryer si nga

8. Pér këtë Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "Dy rekaret e sabahut janë më të vlefshme se e tërë bota dhe ajo që është në të". (Transmeton Muslimi).

9. Transmetohet nga Aishja (r.a.), se: "Pejgamberi (s.a.v.s.), nuk i linte asnjëherë katër rekaret para farzit të drekës dhe dy rekaret para farzit të sabahut". (Transmeton Buhariu).

10. Pér këtë është argument fjala e Pejgamberit (s.a.v.s.) "Kush i fal katër rekate para farzit të drekës dhe katër pas farzit të drekës, Allahu (xh.sh.), do t'i ndalojë zjarrin e xhehenemit". (Transton Muslimi).

meshkujt, ashtu edhe nga femrat. Ky lloj i namazit përbëhet prej njëzet *rekeateve*, duke u bazuar në veprimin e tre hulefai rashiđinëve: Umerit (r.a.), Uthmanit (r.a.) dhe Aliut (r.a.). Për këtë janë unanimë që të katër imamët e *medh/hebeve*.

Koha e faljes së këtij namazi është pas namazit të jacisë dhe para namazit të vitrit. Mund të falet në atë mënyrë, që në çdo dy *rekeate* të jepet *selam*, por mund të jepet *selam* edhe në çdo katër *rekat*. Po qe se falet nga katër *rekeate*, falet njësoj si *suneti* i ikindisë: në uljen e parë lexohen *salavatet*, kurse në fillim të rekatit të tretë, kur qëndrojmë në kembë, të këndohet *subhaneka* para *fatihasë*. Ky namaz mund të falet vetmas dhe me xhemat, por më mirë është të falet me xhemat. Të falur e *teravisë* me xhemat, konsiderohet *suneti kifaje*.

2. - Namazi duha. Koha e këtij namazi është me zbardhjen e ditës, afërsisht njëzet minuta pas lindjes së diellit dhe zgjat deri para drekës. Mund të falen dy *rekeate*, katër *rekeate* më së shumti tetë *rekeate*. Për këtë lloj namazi kemi transmetimin e Aishes (r.a.), e cila tregon: "Pejgamberi (s.a.v.s.), e falte namazin e duhasë katër *rekeate*, ndonjëherë shtonte sa dëshironë"<sup>11</sup>

3. - Namazi tehexh-xhud. Ky lloj i namazit falet natën dhe ky namaz ka vlerë dhe shpërbirim të madh. Për vlerën e këtij namazi, Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "Më i vlefshmi namaz, pas farzeve, është namazi i natës."<sup>12</sup>

4. - Namazi pas abdestit. Ky namaz mund të kryhet pasi të merret *abdest* dhe përbëhet prej dy *rekeateve*.

5. - Namazi për nderim të xhamisë. Ky namaz falet kur hyhet në ndonjë xhami dhe ka dy *rekeate*.

6. - Namazi istihare. Ky namaz është dy *rekatësh*, falet në rast se njeriu nuk e di se ku është interesë i tij, në ndonjë gjë të lejuar. Kështu, kur njeriu dëshiron të fejohet dhe nuk di nëse fejesa është në dobi të tij apo jo.

7. - Namazi haxheh. Ky namaz përbëhet prej dy *rekeateve*. Këtë namaz mund ta falë *musaliu*, që Allahu t'ia lehtësojë veprimin e ndonjë gjëje.

8. - Namazi tesbih. Ky namaz përbëhet prej katër *rekeateve*, por mund të falen edhe dy *rekeate*. Ky lloj i namazit falet në këtë mënyrë: pasi lexohet *subhaneka*, thuhet pesëmbëdhjetë herë kjo shprehje:

"*Subhanallahi, vel-hamdulilahi ve la ilahé ilal-llahu vall-llahu ekber*" e pastaj lexohet *fatiha* dhe një *sure* dhe prapë lexohet dhjetë herë:

"*Subhanallahi, vel-hamdulilahi ve la ilahé ilal-llahu vall-llahu ekber*" e kur të shkohet në *ruku* dhe të lexohet tri herë ajo çka lexohet në *ruku*, duhet të lexohet dhjetë herë:

"*Subhanallahi, vel-hamdulilahi ve la ilahé ilal-llahu vall-llahu ekber*" e pasi të ngrihemë prej *rukus*, lexojmë dhjetë herë:

"*Subhanallahi, vel-hamdulilahi ve la ilahé ilal-llahu vall-llahu*

*ekber*". Pastaj, kur të shkohet në *sexhde* dhe të lexohet ajo që lexohet në *sexhde*, duhet të thuhet dhjetë herë:

"*Subhanallahi, vel-hamdulilahi ve la ilahé ilal-llahu vall-llahu ekber*" e pastaj në uljen në mes dy *sexhdeve* lexojmë dhjetë herë:

"*Subhanallahi, vel-hamdulilahi ve la ilahé ilal-llahu vall-llahu ekber*". Po ashtu, në *sexhden* e dytë veprojmë si në *sexhden* e parë, pra, lexojmë dhjetë herë:

"*Subhanallahi, vel-hamdulilahi ve la ilahé ilal-llahu vall-llahu ekber*". Në këtë mënyrë veprohet gjatë gjithë namazit. Duhet pasur të qartë që, kur ngrihemë në *rekatin* e dytë, nuk lexojmë *subhaneken*, por para *fatihasë* lexojmë pesëmbëdhjetë herë:

"*Subhanallahi, vel-hamdulilahi ve la ilahé ilal-llahu vall-llahu ekber*".

### DISA RREGULLA TË VEÇANTA QË KANË TË BËJNË ME NAMAZET SUNETE DHE NAFILE

Namazet *nafile* i kanë rregullat e njëjtë me namazet *farze*, por disa rregulla në namazet *nafile* mund të mos zbatohen për lehtësim. Përjashtimet e tillë janë:

1. Të qëndruarit në këmbë në namazet *farze* është *ruken* dhe ai që ka mundësi, duhet doe-mos ta kryejë këtë *ruken*, mirëpo në namazet *nafile*, *musaliu* mund të falet ulur dhe të mos qëndrojë në këmbë, por *thevabi* është përgjysmë. Se namazet *nafile* mund të falën ulur, argumenton hadithi:

"Kush falet në këmbë, është më mirë, ndërsa ai që falet ulur, ka gjysmën e shpërbimit".

2. Kur *musaliu* të fillojë faljen e namazit *nafile*, apo *sunete*, doemos duhet ta kryejë, nëse e prish, duhet ta përsërisë.

3. *Sunetet* e radhitura falen gjithmonë pa zë, pavarësisht a falen natën apo ditën. Sa u përket *suneteve* tjera, ato mund të falen me zë dhe pa zë, kjo varet kryesisht prej dëshirës së *musaliut*.

4. Në parim, namazet *nafile* falen nga dy *rekeate*, por nëse ndodh që *musaliu* t'i falë namazet *nafile* nga katër *rekeate*, duhet që pas *fatihasë* të lexojë edhe *suren* në *rekatin* e tretë dhe të katërt.

5. Nëse ndodh që *musaliu* në *sunetet* katër *rekatësh* të ulet në uljen e parë e pastaj të bëjë ndonjë gabim, i cili e prish *rekatin* e tretë ose të katërt, dy *rekatet* e para janë të vlefshëm.

6. Kur ndodh që *musaliu* të bëjë *nijet* të falë katër *rekeate sunet*, por fal vetëm dy, namazi i tij konsiderohet i vlefshëm.

7. Në *sunetet* e natës rekombinohet që në *kijam* të qëndrohet më gjatë se sa në *ruknet* e tjera.



11. Transmeton Muslimi

12. Transmeton Muslimi

# Fqinji i pangrënë

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

*T*ransmetohet nga Abdullah b. Abbas, *radjallahu anhu*, se Pejgamberi, *salallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Nuk éshtë besimtar ai që gdihet i ngopur, ndërsa fqinji i tij éshtë i uritur.*”

Hadithi u kujton myslimanëve, të cilët Krijuesi i Lartësuar i pëershkruan si “vëllezër” dhe si “gurët e një ndërtese, të cilët mbajnë njëri-tjetrin”, përgjegjësitë që duhet të kenë ndaj rrethit të të afërmve. Ekzistojnë edhe tekste me kuptime të njëjta me hadithin, të cilat na janë transmetuar me fjalë të tjera. Njëra prej tyre éshtë: “*Lejse-l mu'minu-lledhi jeshbeu' ue xharuhu xhaiun.*” (Nuk éshtë besimtar ai që éshtë i ngopur, ndërsa fqinji i tij éshtë i uritur.) Ndërsa tjetra éshtë: “*Ma amene bi, men bate sheb'anue xharuhu xhaiun bi xhenbihu ue huve ja'lemu bihi.*” (Nuk më ka besuar mua, ai që gdihet i ngopur dhe e di se fqinji i tij

éshtë me barkun bosh.)”

Sa herë që trajtojmë çështjen e ndjeshmërisë sociale dhe të solidaritetit, patjetër që na vjen ndër mend ky hadith. Pjesa e fundit e hadithit të transmetuar me fjalët: “...ai që gdihet i ngopur dhe e di se fqinji i tij éshtë me barkun bosh.” tregon se myslimanë që nuk ndihmon, nuk éshtë një mysliman i mirë. Madje, qëndrimi i tij indiferent dhe sjelljet e tij të ftohta, konsiderohen argumente që dëshmojnë se ai nuk éshtë besimtar i pjekur.

**Të ndihmosh, nuk éshtë një iniciativë, por një vendim përfundimtar. Ndërsa ndjenja e përkrahjes dhe ndikueshmëria e saj, janë faktorët dhe parimet e solidaritetit.**

## NË FILLIM NDJENJA E PËRKRAHJES

Të ndihmosh nuk éshtë një iniciativë, por një vendim përfundimtar. Ndërsa ndjenja e përkrahjes dhe ndikueshmëria e saj, janë faktorët dhe parimet e solidaritetit. Atëherë, éshtë thelbësore të vendoset në zemër “ndjenja e përkrahjes”, para se të ndihmosh dikë. Ata që nuk janë të dobishëm pér rrethin e tyre shoqëror, sado që e kanë një mundësi të tillë, janë ata që nuk kanë mundur ta vendosin në zemër “ndjenjën e përkrahjes”. Ata nuk ndjejnë kënaqësi të sillen ngrohtë me rrethin e tyre.

Nëse ndihma éshtë një ndjenjë para çdo veprimi, atëherë lidhja e saj me besimin éshtë e fiksuar qartë në të. Sepse forca më ndikuese që orienton veprimet e njerëzve, éshtë besimi dhe udhëheqja e brendshme. Atëherë pandjeshmëria dhe mosndihmesa ndaj rrethit shoqëror, natyrisht që do të jetë e varur nga shkalla e pjekurisë së besimit. Prandaj, gjykimi “nuk éshtë besimtar” në hadithin e sipërpërmendur, ka kuptimin “nuk éshtë në gjendje të kryejë diçka të nevojshme dhe nuk ka një besim të shëndoshë.” Kryesisht, mosinteresimi i myslimanëve ndaj fqinjë-



ve të tyre shumë të afërt, me të cilët duhet të jenë "të butë, të mëshirshëm dhe të dhembshur", është një tregues që lidhet ngushtë me besimin. Edhe hadithi ynë, këtë po bën: po na tërheq vërejtjen ndaj këtij realiteti.

## FQINJËSIA

Rreziku dhe ndërmarrja e vendimit, që përmenden në hadithin e sipërpërmendur, burojnë nga qëndrimi indiferent ndaj fqinjtit. Prandaj, ky hadith zakonisht përmendet në vendet që kanë lidhje me të drejtat e fqinjëve. Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, ka thënë për të drejtat e fqinjëve: "Aq shumë më këshilloi Xhibrili për të drejtat e fqinjit, saqë mendova se fqinji do të ishte trashëgimtar i fqinjit të tij." Në këtë aspekt, urtësinë e trajtimit të kësaj çështjeje do ta kuptojnë më mirë se të tjerët ata që njohin jetën e qyteteve të mëdha. Vetëm ata që jetojnë në apartamente, me vetmi shqetësuese dhe pa interesim, e dinë se sa shtresa të papërcueshme ka muri me tulla 20 cm.

## PËRKRAHJA SOCIALE

Mesazhi i hadithit, i cili në mënyrë interesante na paraqet çështjen e përkrahjes sociale, natyrisht që nuk u drejtohet vetëm fqinjëve të afërt, por çdo lloj fqinjësie.

Nuk ka asnjë forcë në rang shtetëror, që të ndalojë mendimin e diçkaje të njëjtë. Fqinji, i cili vuan për shkaqe të ndryshme dhe përpipet që ta shtyjë herë i ngopur e herë i uritur, ka nevojë për ndihmën dhe interesimin e të tjerëve. Përndryshe, i njëjti problem do të qarkullojë kudo.

Nga ana tjetër, përmendja e shprehjes "fqinji i uritur", në mënyrë absolute e të pakushtëzuar dhe transformimi e përkufizimi si një "fqinj mysliman", e përçon ndjesinë e një myslimanit të pjekur tej kufijve të besimit.

Preokupimi ndaj "fqinjit të uritur", cilësdo feje dhe besimi t'i përkasë, tregon se në këtë situatë duhet synuar zgjidhja e hallit të tij, e jo verifikimi se ç'feje i përket.

## NJË NGJARJE

Umeri, *radijallahu anhu*, dërgoi për në *Kufe* pa asnjë furnizim Muhamed b. Mesleme'në për të

inspektuar Sa'd b. Ebi Uakkas'in, i cili, kur ishte prefekt, donte të çlirohej nga zhurma e pazarit dhe të ndërtonte një vilë për veten e tij. Muhammed b. Mesleme, pasi kthehet për në *Medine* nga një udhëtim nëntëmbëdhjetë ditor, pyeti Umerin, *radijallahu anhu*, se përsë ai e kishte dërguar atë pa asnjë furnizim me ushqim. Umeri, *radijallahu anhu*, tha: "Nuk dua të të jap diçka, ndërsa myslimanët e *Medines* janë të dërmuar nga uria; dhe ti të mbartësh begatinë, ndërsa unë të mbart mëkatin. Sepse unë e kam dëgjuar Profetin, *salallahu alejhi ue selem*, duke thënë: "Nuk i ka hije besimtarit të shëtisë me barkun plot, ndërsa fqinji i tij është i pangrënë."

Sic u kuptua edhe nga kjo ngjarje, në botën tonë, e cila sa vjen e po zvogëlohet, është detyra themelore e besimtarit, që t'u vijë në ndihmë të varfërvë dhe këtë ta fillojë nga fqinji më i afërt. Ky është një tregues i besimit. Nuk duhet harruar

se i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, ka thënë: "Nëse në një lagje mbetet i uritur një person, populli i asaj lagjeje largohet nga mbrojtja e Allahut." Ibn Hazmi, duke vlerësuar të njëjtat argumente, arrin në përfundimin: "Nëse në një qytet vdes një njeri, populli i atij qyteti konsiderohet si vrasësi i të vdekurit dhe shpagimi i të vdekurit

do të mblidhet prej tyre."

## DISA PËRFUNDIME:

Është haram për të pasurin, që të lërë fqinjin e tij të pangopur.

Është detyrë (uaxhib) që t'i ushqesh ata, aq sa t'u largosh urinë dhe t'i veshësh, nëse janë lakuriq.

Në pasuri ka edhe disa përgjegjësi të tjera. Ata që japid zekatin vjetor, nuk mund të shpëtojnë nga përgjegjësitë. Ata kanë edhe disa detyra të tjera, sipas gjendjes së tyre. Përndryshe, do të marrin ndëshkinin e ajitet që ka lidhje me ndalesën e pasurisë.

Besimtarët e vërtetë dhe të pjekur nuk kalojnë në indiferentizëm dhe në pandjeshmëri ndaj rrethit të tyre shpqëror.

Zgjidhja e hallevë të personave në nevojë është tregues i përsosmërisë së besimit.

# PËRPLASJA *e injorancës*

Eduard W. Said

**A**rtikulli i Samuel Huntington-it "Përplasja e qytetërimeve?", u publikua në "Foreign Affairs", në verën e vitit 1993 dhe tërroiq menjëherë vëmendje, duke shkaktuar reagim mbresëlënës. Duke qenë se artikulli synonte të ushqente amerikanët me një tezë origjinale rrëth "një faze të re" në botën e politikës pas fundit të Luftës së Ftohtë, termat e argumentit të Huntington-it dukeshin gjërësisht imponues, të spikatur dhe madje vizionarë. Ai qartësisht synonte t'u përgjigjej rivalëve të tij në radhët e hartimit të politikave, teoristëve të tillë si Francis Fukuyama dhe ideve të tij mbi "fundin e historisë", si dhe legjioneve që kishin filluar të festonin globalizmin, tribalizmin dhe davaritjen e shtetit. Por, sipas tij, ata kishin kuptuar vetëm disa aspekte të kësaj periudhe të re. Ai do të pohonte "atë aspekt thelbësor, në të vërtetë qendror" të asaj se si "do të ishte politika globale në vitet e ardhshme." Pa hezituar, ai pohoi se:

*"Hipoteza ime është se burimi themelor i konfliktit në këtë botë të re nuk do të jetë kryësisht ideologjik apo kryësisht ekonomik. Ndarjet e mëdha mes njëzimit dhe burimi dominues i konfliktit, do të janë kulturore. Shtetet do të mbeten aktorët më të fuqishëm në çështjet botërore, por konfliktet kryesore të politikës globale do të ndodhin mes shteteve dhe grupeve të qytetërimeve të ndryshme. Përplasja*

*e qytetërimeve do të dominojë politikën botërore. Linjat e gabimeve mes qytetërimeve do të janë linjat e betejave të së ardhmes."*

Shumica e argumenteve në faqet pasuese mbështeten mbi një nocion të paqartë të asaj që Huntington e quan "identiteti i qytetërimit" dhe "bashkëveprimi mes shtatë ose tetë qytetërimeve kryesore", mes të cilave, vëmendja e tij përqendrohet në konfliktin e dy prej tyre, Islamit dhe Perëndimit. Në këtë lloj mendimi armiqësor, ai mbështetet ndjeshëm në artikullin e veteranit orientalist Bernard Lewis (1990), ngjyrimet ideo-logjike të të cilit janë manifestuar që në titull, "Rrënjet e tërbimit mysliman." Në të dy artikujt, personifikimi i entitetave të mëdha, të quajtura "Perëndimi" dhe "Islami" është pohuar në mënyrë të shkujdesur, a thua se çështje gjërësisht të komplikuara si identiteti dhe kultura ekzistojnë në një botë filmash vizatimore, ku Popeye dhe Bluto godasin pa mëshirë njëri-tjetrin dhe ku njëri syresh është mundës më i virtytshëm dhe del gjithnjë mbi kundërshtarin e tij.

Sigurisht, as Huntington, as Lewis nuk kishin mjaftueshëm kohë për të vënë në dukje dinamikat e brendshme dhe pluralitetin e çdo qytetërimi, ose për faktin se diskutimi kryesor në shumicën e kulturave moderne lidhet me përkufizimin ose interpretimin e çdo kulture, ose për mundësinë

e pakëndshme, sipas së cilës, ndërsa supozohet të flitet për një fe apo qytetërim, përfshihet një dozë e lartë demagogjje dhe injorance të çiltër. Jo, Perëndimi është Perëndimi dhe Islami Islam.

Sfida e hartuesve të politikave në Perëndim, thotë Huntington, është të sigurojnë që Perëndimi të forcohet dhe të shmangë gjithë të tjerët, sidomos Islamin. Akoma më shqetësuese është pandehma e Huntington-it se perspektiva e tij, e cila vlen për të studuar të gjithë botën nga një pozitë e lartë, jashtë të gjitha lidhjeve të zakonshme dhe luajaliteteve të fshehura, është e sakta, a thua se çdokush tjetër po vrapon vërdallë për të gjetur përgjigjet, të cilat ai tashmë i ka gjetur. Në fakt, Huntington është një ideolog, dikush që dëshiron t'i shndërrojë "qytetërimet" dhe "identitetet" në çfarë ato nuk janë: entitete të myllura, që janë çliruar nga rrymat dhe kundërrymat e panumërtë që i japid jetë historisë njerëzore dhe që ndër shekuj kanë bërë të mundur që në histori të ketë jo vetëm luftëra fetare dhe pushtime perandorake, por edhe shkëmbim, fertilizim kryq dhe bashkëndarje mes qytetërimeve të ndryshme.

Kjo histori, ndjeshëm më pak e dukshme, injorohet për shkak të nxitimit, me qëllim nxjerrjen në pah të luftës qesharake, të ngjeshur dhe të shtrënguar, e cila sipas "përplasje e qytetërimeve" është realiteti. Kur botoi librin me të njëtin titull në vitin 1996, Huntington u përpooq të jepte argumentin e tij me pak më shumë finesë dhe me shumë më tepër shënime plotësuese; gjithë sa ai arriti megjithatë, ishte të çorientonte veten dhe të tregonte se ishte një shkrimitar i ngathët dhe një mendimtar pa shije.

Paradigma kryesore e Perëndimit kundrejt pjesës tjetër (opozita e Luftës së Ftohtë, e riformular) mbeti e paprekur dhe kjo ka vazhduar të përsëritet pa pushim, shpesh fshehtas dhe në mënyrë implicite, në diskutimet që prej ngjarjeve të tmerrshme të 11 Shtatorit.

Vrasjet masive dhe sulmet vetëvrasëse, të pa-kontrollueshme, të tmerrshme dhe të planifikuara me kujdes nga një grup militantësh të marrë, janë kthyer në prova për tezën e Huntington-it. Në

vend që ngjarja të shihet ashtu siç është – si kapja e ideve të mëdha (e përdor lirshëm këtë fjalë) nga një bandë e vogël fanatikësh të çmendur, për qëllime kriminale – drejtuesit ndërkombëtarë, që nga ish kryeministri pakistanez Benazir Bhutto, deri tek kryeministri italian Silvio Berlusconi, nën-vizuan problemet e Islamit dhe më vonë përdorën idetë e Huntington-it për të përcartur rreth superioritetit të Perëndimit, se si "ne" kemi Mozart-in dhe Michelangelo-n, ndërsa ata nuk kanë. (Më vonë, Berlusconi do të kërkonte falje me gjysmë zemër për fyerjen ndaj "Islamit")

Po pse, në vend të kësaj, të mos shohim paralele, duke pranuar se ato janë më pak spektakolare në destruktivitetin e tyre, mes Osama bin Laden-it dhe pasuesve të tij në kulte, si Branch Davidians ose dishepujt e Rev-it. Jim Jones në Gujanë ose japonezi Aum Shinrikyo? Edhe "The Economist", e përvjetorja britanike, normalisht e matur, në një artikull nga 22-28 shtator, nuk mundi t'i rezistonte përgjithësimit të lartë, duke lavdëruar me ekstravagancë Huntington-in për vëzhgimet e tij "mizore dhe gjithëpërfshirëse, por megjithatë të mprehta" rreth Islamit. "Sot", shkruhet në gazetë me një solemnitet të pahijshëm, Huntington shkroi se "një miliardë a më shumë myslimanë janë të bindur për superioritetin e kulturës së tyre dhe të pushtuar nga inferioriteti i pushtetit të tyre." A janë anketuar 100 indonezianë, 200 marokenë, 500 egjiptianë dhe 50 boshnjakë për të dalë në këtë përfundim? Edhe nëse po, çfarë lloj metode është kjo?

Janë të panumërt editorialet në çdo gazetë dhe revistë amerikane dhe evropiane, të cilët po rrisin fjalorin e gjigantizmit dhe apokalipsit, përdorimi i të cilët është i skicuar qartë jo për të udhëzuar, por për të ndezur pasionin e zemëruar të lexuesve, si anëtarë të "Perëndimit", si dhe duke shtuar atë çka nevojitet të bëhet. Retorika çurçilliane përdoret pa vend nga luftëtarët e vetëcaktuar në luftën e Perëndimit dhe sidomos të Amerikës, luftë kundër atyre që e urrejnë, e plaçkitin dhe e shkatërrojnë atë, duke u kushtuar vëmendje të mangët historive të ndërlikuara që kundërshtojnë një reduktivizëm të tillë dhe që kanë depërtuar nga një territor në tjetrin në procesin e tejkalimit

të kufijve që supozojnë të na ndajnë të gjithëve në kampe të veçuara të armatosura.

Ky është problemi me etiketimet demoralizuese si Islami dhe Perëndimi: ato çorientojnë dhe konfuzojnë mendjen, e cila përpinqet t'i gjejë kuptim realitetit të çrregullt që nuk mund të injorohet apo të izolohet kaq lehtë. Kujtoj ndërhyrjen e një burri, i cili pas një leksioni që dhashë në Universitetin e Bregut Perëndimor në vitin 1994, u ngrit nga audiencia dhe filloj të sulmonte idetë e mia si "perëndimore" e si në kundërshti me idetë islame strikte që ai përkrahte. "Pse vesh kostum e kollare?", ishte gjëja e parë që më erdhi në mendje. "Edhe ato janë perëndimore." Ai u ul i zënë ngushtë, por incidenti m'u rikujtua kur filloj të dilte informacioni mbi terroristët e 11 Shtatorit: si kishin shtënë në dorë të gjitha detajet teknike të nevojshme për të shkaktuar fatkeqësinë vdekjeprurëse në Qendrën Botërore të Tregtisë, në Pentagon dhe për avionin që kishin sekuestruar? Ku përcaktohet vija ndarëse midis teknologjisë "perëndimore" dhe, siç deklaroi Berlusconi, "paaf-tësisë së Islamit për të qenë pjesë e modernitetit"?

Askush nuk mund ta përcaktojë qartë këtë, sigurisht. Sa të papërshtatshme janë në fund etiketimet, përgjithësimet dhe pohimet kulturore. Në njëfarë niveli, për shembull, pasionet primitive dhe njohuritë e sofistikuara, puqen në atë soj mënyre, që mundëson shtrirjen e kufirit të fortifikuar, jo vetëm midis "Perëndimit" dhe "Islamit", por edhe midis së shkuarës dhe së tashmes, mes nesh dhe atyre, për të mos përmendur konceptet e identitetit dhe kombësisë, rreth të cilave ka mosmarrëveshje dhe debat pa fund. Vendimi i njëanshëm për të caktuar vija në rërë, për të ndërmarrë kryqëzata, për t'iu kundërvënë të keqes së tyre me të mirën tonë, për të asgjësuar terrorizimin dhe, sipas fjalorit nihilist të Paul Wolfowitzs, për t'i dhënë tërësish fund kombeve, nuk e bën më të lehtë dallimin e këtyre entitete të supozuara; përkundrazi, tregon se sa më e thjeshtë është të bëhen deklarata luftarake, me qëllim mobilizimin e pasioneve kolektive, krahasuar me reflektimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e asaj me të cilën përballemi në realitet, ndërlidhjen e jetëve

të panumërtë, "tonat" dhe "të tyret".

Në serinë e tre artikujve, të publikuar midis janarit dhe marsit të vitit 1999 në Dawn, e përvjavshmjë e respektuar në Pakistan, Eqbal Ahmad, duke shkruar për audiencën myslimanë, analizoi atë që ai e quan rrënjet e së drejtës fetare dhe trajtoi ashpër gjymtimet që i bëhen Islamit nga absolutistët dhe tiranët fanatikë, obsesioni i të cilëve, për të rregulluar sjelljen personale, promovon një "rend islamik të reduktuar në një kod penal, të zhveshur nga humanizmi, estetika, kërkimet intelektuale dhe devotshmëria shpirtërore." Dhe kjo "përfshin pranimin e një aspekti absolut të fesë, përgjithësia jo kontekstual, dhe shpërfilljen totale të një aspekti tjeter. Ky fenomen shfyturon fenë, cënon traditën dhe ndryshon proceset politike, kudo ku shpaloset."

Si shembull të kohës për këtë cenim, Ahmad fillimisht paraqet kuptimin e pasur, kompleks dhe pluralist të fjalës "xhihad" dhe pastaj vijon të tregojë se me kufizimin aktual të fjalës, si luftë pa dallim kundër armiqve të supozuar, është e pamundur "të njoftesh fenë, shoqërinë, kulturën, historinë dhe politikën islamë, ashtu siç është jetuar nga myslimanët ndër shekuj." Islamikët modernë, përfundon Ahmad-i, janë "të interesuar për push-tetin dhe jo për shpirtin; përmobilizimin e njerëzve për qëllime politike dhe jo për bashkëndarjen dhe lehtësimin e vuajtjeve dhe aspiratave. Kjo është një axhendë politike e limituar dhe e lidhur me kohën." Ajo që e ka përkeqësuar çështjen, është fakti se shfytirime dhe fanatizma të ngjashme vihen re edhe në diskursin "hebre" dhe "të krishterë"

Konrad e kuptoi, më fuqishëm se ç'do ta kishte imagjinuar çdo lexues i tij në fund të shekullit XIX, se dallimet midis Londrës së qytetëruar dhe "zemrës së errësirës" degjeneruan shumë shpejt në situata ekstreme dhe se majat e qytetërimit evropian mund të kthehesin menjëherë në praktika nga më barbare, pa parapërgatitje apo tranzicion. Ishte sërisht Konrad, i cili në "Agjenti Sekret" (1907), përshkroi prirjen e terrorizmit me abstraksione të tilla, si "shkencë e saktë" dhe degradimin e fundit moral të terroristëve.

Me sa duket, mes qytetërimeve ndërluftuese ka lidhje më të ngushta nga sa shumica prej nesh do të donin të besonin; Frojd dhe Niçe treguan se si trafiku i ruajtur me kujdes, madje edhe kufijtë e patrulluar, shpesh lëvizin me lehtësi të tmerrshme. Ide kaq të paqëndrueshme, plot ambiguitet dhe skepticizëm, sa i takon nocioneve pas të cilave kapemi, zor se na japin udhëzime të përshtatshme dhe praktike për situata si kjo me të cilën po përballemi tani. Prandaj lufta më e sigurt për të vënë rendin (kryqëzata, e mira kundër së keqes, liria kundër frikës etj.), nxirret nga supozimi i Huntington-it për kundërvënien mes Islamit dhe Perëndimit, supozim nga i cili diskursi zyrtar formuloi fjalorin e tij, që ditët e para pas sulmeve të 11 Shtatorit. Që atëherë, ka një rënie të ndjeshme të këtij diskursi, por, nëse gjykohet nga sasia e qëndrueshme e fjalimeve dhe veprimeve të urrejtjes, shto edhe raportet për përpjekjet e forcimit të ligjit, drejtuar arabëve, myslimanëve dhe indianëve në të gjithë vendin, paradigma vazhdon të jetë ekzistuese.

Një arsy më shumë për vazhdimin e saj është prania në rritje e myslimanëve në të gjithë Evropën dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mendoni për popullsinë e sotme të Francës, Italisë, Gjermanisë, Spanjës, Britanisë, Amerikës, madje edhe Suedisë, dhe do të duhet të pranoni se Islami nuk gjendet më në skajet e Perëndimit, por bash në qendrën e tij. Po ç'ka kaq kërcënuese rrëth kësaj? Në kulturën kolektive janë fshehur kujtimet e pushtimeve të para të mëdha arabo-islamike, të cilat filluan në shekullin VII dhe, siç ka shkruar historiani i njohur belg Henri Pirenne në librin e tij "Mohammed and Charlemagne" (1939), shkatërruan një herë e përgjithmonë unitetin e vjetër mesdhetar dhe sintezën kristiano-romake dhe i dhanë hov një qytetërimi të ri të dominuar nga fuqitë veriore (Gjermania dhe Franca karolin-gjiane), misioni i të cilit, duket të thotë ai, është rifillimi i mbrojtjes së "Perëndimit" nga armiqjtë historiko-kulturorë.

Ajo që Pirenne lë pa përmendur, përfat të keq, është fakti se në krijimin e kësaj linje të re mbrojtjeje, Perëndimi mori shumë nga humanizmi,

shkenca, filozofia, sociologjia dhe historiografia e Islamit, e cila tashmë ishte vetndërmjetësuar midis botës së Karlit të Madh dhe antikititetit klasik. Islami ka qenë brenda që prej fillimit, madje edhe Dante-s, armik i madh i Muhamedit, iu desh ta pranonte këtë, kur e vendosi Profetin në zemër të ferrit të tij.

Veç kësaj, është edhe vetë trashëgimia e monoteizmit, e feve abrahamike, siç i quajti me vend Louis Massignon. Duke filluar me Judaizmin dhe Krishterimin, secila syresh është pasardhës i asaj që ishte më parë; për myslimanët, Islami plotëson dhe përfundon vargun e profecisë. Ende nuk ka ndonjë histori të përshtatshme ose demistikim të diskutimit shumëanësh mes këtyre tre ndjekësve-asnjë prej tyre, përmes ndonjë kampi monolitik e të unifikuar -, ndonëse konvergjenca moderne e përgjakshme në Palestinë na jep një shembull të pasur të laicizmit për atë që ka qenë tragjikisht e papajtueshme rrëth tyre. Nuk është habi që pastaj myslimanët flasin me lehtësi për kryqëzatat dhe xhihadët, duke lënë jashtë praninë judaike, shpesh me mospërfillje sublime. Një axhendë e tillë, siç thotë Eqbal Ahmad, është "shumë qetësuese për burrat dhe gratë, të cilët janë në mes të cekëtinës, mes ujërave të thella të traditës dhe modernitetit."

Por ne të gjithë po notojmë në këto ujëra, perëndimorë, myslimanë dhe të tjerë. Duke qenë se ujërat janë pjesë e oqeanit të historisë, përpjekja për t'i ndarë ato me bariera, është e kotë. Këto janë kohë të tensionuara, por është më mirë të mendojmë në termat e komuniteteve të pushteshme dhe komuniteteve të dobëta, të politikave laike të arsyses dhe injorancës dhe të parimeve universale të drejtësisë dhe padrejtësisë, se sa të bëjmë ecejake në kërkim të abstraksioneve të gjera që mund të japin kënaqësi castore, por fare pak vetënjohje apo analizë informuese. Teza e "Përplasjes së qytetërimeve" është dredhi mashtruese, po aq sa "Lufta e Botëve", e cila shërbën më shumë për forcimin e vetë-krenarisë mbrojtëse, sesa për kuptimin kritik të ndërvarësisë çorientese të kohës sonë.



# Historia e dy vëllezërve në Kur'an

Mustafa Erish

**N**ë Kur'anin Fisnik ka histori shumë të bukura dhe mësimdhënëse.

Zoti i Lartësuar ia tërheq vëmendjen njeriut me këto histori dhe vendos parime, të cilat janë masa të jetës.

Ai i tregon rrugën e drejtë robit të tij, që të fitojë lumturinë e përhershme.

Kështu e edukon njeriun, duke i shprehur me shembuj bukuritë apo ligësitë, të cilat janë të fshehura në botën e tij të brendshme.

Zoti thotë se ata që i respektojnë këto masa, do të arrijnë lumturinë e të dy botëve.

Ata njerëz që besojnë, këto histori i lexojnë shumë shpesh, nxjerrin mësimë prej tyre dhe i zbatojnë në jetë ato.

Njëri prej këtyre shembujeve kalon në suren el-Kehf në tefsirin e "Ruhu'l-Bejan".

Aty tregohet gjendja e një njeriu, i cili bie në shirk, duke u mburrur për shkak të pasurisë, maliit e servetit që i ka dhënë Allahu dhe historia e shokut të tij, i cili e këshillon: "Sikur të thoshe, kur hyre në kopshtin tënd:

"Mashallah! Askush nuk ka fuqi ta ndryshojë, përveç Allahut!", i cili ishte shembull me jetën e tij duke dhënë në rrugë të Allahut nga pasuria që i kishte dhënë Ai, i cili nuk toleronte në besimin e tij dhe tha: "Por Allahu është Zoti im. Unë nuk i bëj ortak asgjë atij."

Zoti i Lartësuar e fillon kështu këtë histori, e cila është mësim i madh për ne: "Jepu atyre si shembull këta dy njerëz!" dhe pastaj vazhdon:

**"Jepu atyre si shembull këta dy njerëz: Njërit prej tyre i kemi dhënë dy vreshta dhe i kemi rrethuar ato me hurma e në mes tyre kemi bërë ara.**

*Të dy vreshtat dhanë frutat e tyre, asgjë nuk ka munguar dhe kemi bërë që në mes tyre të rrjedhë një lumë.*

*Ai ka pasur edhe një tjetër pasuri. Për këtë arsy, i tha shokut kur foli me të: "Unë kam më shumë pasuri se ti dhe, unë jam më i fortë se ti me pasardhës".*

*Kështu, hyri në kopshtin e vet, duke i bërë vetes dëm (zullum) me mendjemadhësi dhe tha: "Unë nuk mendoj se do të humbë kjo ndonjëherë.*

*Po ashtu nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Dita e Kijametit e, nëse unë do të kthehem te Zoti im, me të vërtetë, do të gjej vend më të mirë se ky!"*

*Shoku i tij, duke biseduar me të, i tha: "Mohove Atë, i cili të ka krijuar prej dheut, pastaj nga pika e farës (sperma) dhe më në fund të bëri njeri të plotë?"*

*Por unë besoj se Allahu është Zoti im dhe nuk i bëj ortak asgjë Atij.*

*Sikur ti, kur hyre në kopshtin tënd, të thoshje: Mashallah! Askush nuk ka fuqi (që ta ndryshojë), përveç Allahut. Nëse ti shikon se unë kam më pak pasuri dhe pasardhës, unë shpresoj se Zoti im do të më japë më mirë se kopshti yt. Ndërsa në kopshtin tënd Ai mund të dërgojë shtatërrim nga qielli e të bëhet tokë e thatë.*

*Ose bën që uji të humbasë në greminë (në nëntokë) e të mos e gjesh kurrë më".*

*Kështu u shkatërrua pasuria e tij (e mohuesit) e ai rrihte duart e veta (nga pikëllimi), për atë që harxhoi në të. Tendat e vreshtës ranë për-*

*dhe, ndërsa ai thoshte: "Ah sikur të mos i kisha bërë asgjë ortak Zotit tim!" Ai nuk kishte asnjë ndihmës që t'i ndihmonte, përveç Allahut. Po ashtu, nuk kishte mundësi ta shpëtonte veten.*

*Këtu, mund të ndihmojë vetëm Allahu, i cili është i Vërteti. Ai shpërblen në mënyrën më të bukur dhe jep përfundimin më të mirë." (Surja el-Kehf, 32-44.)*

Shirku dhe dashuria ndaj kësaj bote e shpien njeriun në shkatërrim, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

Edhe përqafimi i tevhidit dhe lënia e dashurisë ndaj dynjasë, bëhen shkak për shpëtim në të dy botët.

Pejgamberi ynë i Dëshur, duke kërkuar që ta themi gjithmonë fjalën "Mashallah, la havle ve la kuvvete illa billah" kundër syrit të keq, thotë:

*"Nëse ai, i cili shikon se dikujt i është dhënë një familje dhe pasuri e mirë thotë: Mashallah, la havle ve la kuvvete illa billah, atëherë nuk ndikon asnjë gjë e keqe." (Sujuti, ed-Durru'l-Mensur, V, 393-394.)*

*"Fjala "La havle ve la kuvvete illa billah" është ilaç për nëntëdhjetë e nëntë lloje sëmundjesh. Më e lehta prej këtyre është pikëllimi." (Dejlemi, nr i hadithit: 7284; Munavi, VI, 425.)*

Allahu i Madhëruar na bëftë prej atyre që kampemi fort pas tevhudit, duke qëndruar larg shirkut e larg dashurisë së kësaj bote dhe na bëftë prej atyre që arrijnë lumturinë e të dy botëve!

Amin.

# Nji hap përparimit

Prej se ramë më nji gjumë të randë a ma mirë të thomi pse mësuem më lënguem prej mjerimit konservativ qi dita me ditë vintë tuj na hangër shpirtin e tuj na bre Imanë, s'deshti të na bijë kurr në mend të mendohemi pakës me gjetun mënyren se si më muejtun e më çuem krye prej kësajë humnerje qi kemi ra, ndoshta që mëkat më besuem se nësërmja mund të bahej ma mirë për ne se sodja.

Nji mentalitet kësodorë, pa dyshim dhe ati qi ka besim të plotë se puna e qindrimi nga dhnojn mbi të gjitha veshtirësinat, i a them kurajën civile, i ndalon aspiracionin (frym) e lirë qi merr në fantazi të njaj ditë të lumnuëshme eçon s'mramit me thanë se kët element fatalist si t'onin, asht krejt si e pa mundun më ja hi qi të bahet nji punë e mirë.

T'ishtë të gjith njërzija njisoji, s'do t'u gjindte kushi t'i baje ballë më punë këtij mentaliteti, por dësht Zoti e ndollën dhe në mes t'onë ca gjymtyrë të vjefshem qi s'u tunden farë në mendimet e tynë të lira e të mira; e luftuen kët mentalitet e i thanë se më ndejë kështu si jemi e me pritë me duër ndij Mehdin qi të dalë njëhej mekat, pse asht fik'e konak e m'u kondëndue me gjëndje të sodshme, s'asht tjetër veç si me dashtë me ngulë kambë për m'e dbuem sa ma parë këndej pari Islamije-

tin. E që se njimend, rrokull vitit qi jemi, u formue Xhemë-atë Ismailija në heqipëni më qëllim qi elementi Mysliman të ngjallohet e të më kambet për mbas parimeve të shëndoshta e të lira qi ka në vet vëdi fëja Islame e t'i thojë lamtumirë nji-herë e përgjithmonë këti mjerimi qi sot mjesrisht na ka rrëthuem. Sot ...u hudh nji themel. Moti qi të vij. Kongresi i dytë ka me mbushë e plotsuam të metat qi ka me pa e nevojët tjera qi ka me ndië Kongresist vjeta me vjetë kan me tfaqë mendimet e tynë ilrisht ashtu sikuërr e lypë interesa e besës e nevoja e ynë në kohen e sodit.

Unë s'due të shkoj aq larg e kët po ja la kohës; due të këthehem të Kongresi i sivjetshem i cili me statutin e bukur qi na la në dorë, na i çfaqi mëndimet e tija për organizimin t'onë. Brendija e Statutit i përgjëgjet pikërisht nevojve t'ona. Në mess a e sa tjerave, shohim me shum gjerrim qi Këshilli i Naltë i Xhemë-atë Islamijes, ngarkohet më nxjerrë nji rivistë për cilën Myslimani i sotshëm ka të madhen nevojë. Randësija e rivistës asht e madhë, sidomos për në qi s'kemi të botueme libra feje në gjuhën t'onë. Rivista Zani i Naltë qi ka m'u pritë me duer hapët prej çdo Myslimani, si organ i Xhemë-atë në fjalë, veç qi do të na çpallë veprimet me randësi qi kryehën

apo qì do tè kryhen, me artikuj tè bukur qì ka me botue, ka më qënë dhe nji ushqim moral e material pér shpirt e mënde tè çdo Myslimsni pse në te do tè gjejnë sende qì i vinë pér vehte, do tè mësojnë gjana tè reja qì s'i ka digjume asnjiherë e do tè shohë se si feja e ynë i ka dhanë shkasin e hovin ma tè madhin qytetnimit e pérparimit ndjérzuer.

Me anë tè ksajë rivisfe, do kemi rastin e bukur tè njohim njerzit e mëdhaj tè Myslimanve qì kan ardhë e tè shohim veprimet e shkelqyëshme qì na kan lanë. Shkurt, kjo rivistë, do tè jetë pér Myslimanin nji pasqyrë e gjallë, me ndihem tè cillës ka me muejtn tè luftoj lirisht sendet qì pa kurr nji tè drejtë në vet vedi kan marrë nji fytyrë e ngjyrë fëtarë e na dalin pér ballë.

Këshill i Naltë i Xhemë-atë Islamijes tue botuem kët rivistë, po na thot në elemen-  
tit Mysliman, se me përkrahjen e nxehë qì ka më pasë prej nësh, ka me u përpjekë me mish e me shpirt me krye edhe pikat e tjera tè statutit, realizimi i tè cilavë na i kondetë tè gjitha ndisit e nevojët t'ona qì kemë.

Mue nji detyrë fëtare pér nji-heri dhe kom-  
bëtarë më nxiti tè shpëtoj me falënderue Këshillin e Naltë tè Xhemë-atë Islamijes qì pati mirësin tè nisi me xjerrë në dritë Zanin e Naltë tuej i uruem qì dita me ditë t'a rrijë me kryem me fitim tè math dëtyruem shejte qì ka marrë pqr sipri, qì kështu dhe Myslimanit tè ngartë në Shqipën e lirë, përgjithsisht t'i hapet orizandi i pemjes, ashtu sikur paten qënë dikuer Myslimant në botë.

## Zjalë tè arta

1. Njerzit flejnë, e kuër tè vdesin kanë pér t'u zgjue.
2. Nuk humbet ai qì e çmon vehten e vet.
3. Kush njef vehten ka njoft Perëndinë.
4. Vlefta e çdo njeriut shifet nën gjuhë tè vetë.
5. Gjojë ambli shton miqt e vetë.
6. Shiko ç'flet e jo kush flet.
7. I liri me besnikërinë e vetë bahet rob i bindur.
8. Jepni sihariq dor shtrëngusit se pasunija e tij në rasë tè ndonji ndodhije ose tè ramen në duer tè trashgimtarëve tè pa kursyeshëm, shuhet.
9. Ankimi në rasë tè mënyrës plotëson hidhrimin.

Nr. 2. Nantuer Vit'i I.

Shtypur në shtypëshhronjët "Mbrothësia" Kristo Luarasi 1923 Fq. 51-54, 61

## Mbikëqyrja e Allabut

*Allahu (xh.sh.), thotë: "O njerëz! Frikëso-juni Allahut, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej tij krijoi bashkëshorten e tij dhe prej atyre tē dyve krijoi shumë meshkuje femra. Frikësojuni Allahut, me emrin e tē Cilit ju kérkonni tē drejtat e ndërsjella dhe ruajini lidhjet farefisnore. Vërtet, Allahu əshtë pér-herë Mbikëqyrés mbi ju.." (Nisa,1)*

Mbikëqyrja e Allahut (xh.sh.), do tē thotë se Ai kontrollon dhe rregullon sjelljet e njeriut.

Ne kemi frikë dhe largohemi sa herë që e ndjejmë se kamera əshtë drejtar nga ne. Po asantu, kemi frikë dhe ruhemri nga sytë e njerëzve. Si əshtë e mundur tē neglizhojmë dhe tē mos ruhemri prej syrit tē Atij që na vëzhgon çdo sjellje tonën?!

Nga ne lypset që né çdo veprim, tē ndjejmë prezencen dhe mbikëqyrjen e Allahut (xh.sh.): "*Ai əshtë me ju kudo që jeni dhe ju sheh gjith-čka që veproni...*" (Hadid, 4) Prandaj ne duhet ta rregullojmë veten tonë né ményrë që ajo që kemi brenda nesh, tē jetë e njëjtë me pamjen tonë tē jashtme.

Pér mbikëqyrjen e njeriut, Allahu (xh.sh.), ka caktuar edhe melekë që e vëzhgojnë atë pér çdo veprim që bën. Allahu (xh.sh.), thotë: "*Pér çdo fjalë që thotë, njeriu ka pranë vetes një mbikëqyrés tē gatshem (pér ta shënuar atë.)*" (Kaf, 18.) Ne nuk e ndjejmë prezencen e mbikë-

qyrjes së melekëve. Nëse do tē kishim tē instaluara mijëra kamera, kudo që tē lëviznim, nuk do tē ndiheshim tē lirë. Ndërsa Allahu i Madhruar ka caktuar melekët, tē cilët na mbikëqyrin dhe ne nuk i shohim. Kjo na jep liri né veprim dhe né mendim.

Sot shpenzohen shuma tē mëdha pér mbikëqyrjen e lëvizjeve tē njerëzve tē ndryshëm. Vallë, sa pasuri do tē kurseheshin, nëse né vend tē kamerave, policëve dhe rojeve, do tē mbillnim né zemrat e njerëzve ndjenjën e mbikëqyrjes së Allahut. A nuk mendoni se shumë mos-marrëveshje mes çifteve do tē zgjidheshin, pa vajtur çështja né gjykatë? A nuk mendoni se tē gjithë punonjësit do tē punonin me sinqueritet dhe prodhimet do tē ishin më cilësore, po tē mbillnim né zemrat e njerëzve ndjenjën e mbikëqyrjes së Allahut?

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "*Në ditën e Gjykimit do tē takohem me disa persona nga populli im, tē cilët do tē vijnë me shumë vepra tē mira, por Allahu (xh. sh.), do t'ua bëjé pluhur e hi. Ata janë véllezérít tuaj, tē cilët falen ashtu siç faleni edhe ju, mirépo kur janë vetëm, shkelin urdhrat e Allahut (xh.sh.).*" (Ibn Maxhe)

Ky hadith əshtë një ftesë e qartë pér tē gjithë ne, që tē ndërgjegjësöhemi pér faktin se Allahu na mbikëqyr, tē ushqejmë ndjenjën e turpit ndaj Tij, né fshehtësi dhe né publik, né vetmi dhe né bashkësi.



*“Për çdo fjalë që thotë, njeriu ka pranë vetes  
një mbikqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”*

*-Kaf, 18 -*

**Për t'u edukuar me idenë e mbikëqyrjes së Allahut (xh.sh.), në zemrat tonë, duhet të kemi parasysh:**

1. Bindjen (besimin) e plotë se Allahu (xh.sh.), është i informuar për çdo vepër që ne bëjmë, në fshehtësi ose haptazi, Allahu (xh. sh.), thotë në Kur'anin Famëlartë : **“Allahu (xh.sh.), i di fs-hehtësitë dhe veprimet tuaja publike dhe di se çfarë veproni”.** (Enam, 3)

Në qoftë se kjo e vërtetë rrënjoset thellë në zemrën e besimtarit, atëherë ai do të ndjejë turp që Allahu (xh.sh.), ta shikojë aty ku ia ka ndaluar të shkojë. Nëse besimtari e përjeton këtë gjendje, atëherë ai do të fillojë të respektojë me përpikmëri urdhrat e Allahut (xh.sh.).

2. Besimin e plotë se Allahu (xh.sh.), do ta gjykojë njeriun për çdo vepër në Ditën e Gjy-kimit, kur ai do të shpërblehet ose do të dënohet, sipas veprave që ka bërë. Në qoftë se ai ka vepruar keq, do të gjejë keq. Në qoftë se ai ka vepruar mirë, do të gjejë mirë. Në qoftë se njeriu është i bindur plotësisht për këtë të vërtetë, atëherë ai do t'i korrigojë gabimet e tij dhe do të kthehet në rrugën e drejtë, përpara se t'i vijë vdekja.

Allahu (xh.sh.), thotë: **“Libri (i veprave të tyre) do t'u vihet përpara dhe do të shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: «Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnje vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar». Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt.”** (Kehf, 49)

Ndjenja e mbikëqyrjes së Allahut, në çdo çast do të jetë për ne një ndihmë e madhe në respektimin e urdhrale të Allahut (xh.sh.), me përpikmëri dhe, po ashtu, do të jetë mbrojtëse nga gjynahet dhe gabimet.

Omeri (r.a.), lëvizte natën, për t'u interesuar mbi gjendjen e njerëzve. Teksa lëvizte, dëgjoi zërat e dy grave që po bisedonin brenda një shtëpie. Ai dëgjoi zërin e një néné që i thoshte vajzës së saj: “O bija ime, përzieje qumështin me ujë, që ta shesim dhe të fitojmë më shumë para.” Vajza ia ktheu: “O nënë! A nuk e di se Umer ibn Hatabi (r.a.), ka dhënë urdhër të mos e përziejmë qumështin me ujë?” Nëna i tha: “O bija ime, Omeri (r.a.), nuk po na shikon tan!” Por vajza iu përgjigj: “O nënë, nëse nuk na shikon Omeri, na shikon Zoti i Omerit.”

## Letërsia Islame

Ma. Artur Tagani

Kur bëhet fjalë për letërsinë islame, duhet të flasim për një trashëgimi kulturore tejet të gjerë, të shkruar dhe orale, gjë e cila është e pamundur të ezaurohet në kuadrin e një këndi të një reiste. Por do të përpinqemi t'i japim panoramën që meriton kjo temë.

### 1. KURANI DHE LETËRSIA

Ashtu siç kemi shpjeguar edhe në temat e tjera, Kurani Famëlartë ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e diturive të ndryshme në botën islame. Ai ka trajtuar qindra tematika, si urtësinë, të drejtën, etikën, historinë e popujve të ndryshëm, moralin, edukimin, njohjen intutive, të fshehtat e natyrës, të fshehtat e hapësirës etj, etj... Por natyra letrare e tij, mund të themi se padiskutim është në formën e përsosur. Aspekti letrar i Kurantit është mjaft i fuqishëm. Që në ditët e para dolën disa disciplina për t'i shërbyer më mirë njohjes së Kurantit. Më pas, filloj interesimi për njohjen e Kurantit nga letrarët dhe njerëzit me shije të ndryshme, artistike të cilët mbetën nën ndikimin e tij. U tërroqi vëmendjen mënyra e të shprehurit dhe e shprehjeve. Kështu, Kurani edukoi aftësitë dhe shijet e njerëzve. Kurani u bë prototipi dhe frymëzimi i atyre që kishin aftësi për prozë, poezi, oratori dhe për shkrimitarë të fushave të ndryshme. Në këtë mënyrë, Kurani u

bë bazë e shkencave letrare. Ai gjallëroi shpirtin letrar në forma të ndryshme, duke i dhënë mundësinë të fuqizohet dhe të përhapet. Nga Kurani nuk u ndikua vetëm gjuha arabe, por të gjitha gjuhët e popujve myslimanë.

Si rezultat i ndikimit që bëri Kurani në gjuhën arabe, lindën disa shkenca:

Shkenca e linguistikës, shkenca e ishtikakut, shkenca e sarfit, shkenca e nahivit, shkenca e me-anit, shkenca e bejanit, shkenca e bedi't, shkenca e insha, shkenca e kritikës së prozës, shkenca e aruzit, shkenca e rimës, shkenca e kritikës së poezisë, shkenca e oratorisë, shkenca e hatt-it, shkenca e historisë së letërsisë, logjika linguistike, filozofia e gjuhës etj.

### 2. LETËRSIA KURANORE

Shkaku se përse Hz. Aliu i mësoi shkencën e nahvit Ebu'l-Esved ed-Dueli-t, është që njerëzit ta njihnin sa më mirë Kuranin. Vërtet, çdo shkencë në islam ka lidhje pak apo shumë me Kuranin, madje disa shkenca janë tërësisht kuranore, si këto më poshtë:

Teologjia kuranore, etika kuranore, fikhu kuranor, psikologjia kuranore, filozofia kuranore e historisë, politika kuranore, shkencat kuranore të natyrës, shkenca kuranore e ahiretit, shkenca e

terminologjisë së Kur'anit, shkenca e të kuptuarit të ajeteve alegorike të Kur'anit, shkenca e të kundërshtuarit të kritikave ndaj Kur'anit, shkenca e fjalorit të huaj të Kur'anit, shkenca e sarfit dhe nahvit të Kur'anit, shkenca e shkruarjes së Kur'anit, shkenca e texhvidit dhe kiraetit të Kur'anit etj.

Këto janë shkenca që kanë lindur nga nevoja për të kuptuar sa më mirë gjuhën e Kur'anit, të lidhura me gjuhën, gramatikën, belagatin, sarfin letrar kuranor. Një prej veprave më të mira për njojen e Fjalës Hyjnore, Keshfudh-Dhununi, i shpjegon gjatë këto, në mënyrë të detajuar. Le të ndalemi tek njëra prej shkencave më të njoitura që i ka shërbyer njojen së Kur'anit në mënyrë masive.

## 2.1. LETËRSIA E PËRKTHIMIT DHE E KOMENTIMIT TË KURANIT

Kjo disiplinë analizon hollësishët çështjet shkençore dhe letrare, të lidhura me Kur'anin. Veçanërisht, vepra "Tibjan" e Tusit dhe "Keshshaf-i" i Zemahshërit, mund të themi me siguri që janë dy prej veprave më të spikatura që trajtojnë letrarisht Kur'anin.

Gjithashtu, mund të bëhet fjalë edhe për një letërsi të veçantë që është krijuar përmes përkthimit të Kur'anit në gjuhë të ndryshme. Pa dyshim, çdo gjuhë ka karakteristikën e saj, por kur bëhet fjalë për përkthimin e Kur'anit në gjuhë të ndryshme, vërejmë se kujdesi për t'i qëndruar sa më

besnik origjinalit dhe për të përcjellë imazhin e duhur tek lexuesit, ka sjellë një letërsi të veçantë mbarëbotërore të përkthimit të Kur'anit.

## 3. LETËRSIA E HADITHEVE

Një prej argumenteve që Kurani nuk është fjalë e Muhamedit (a.s.), është se fjala profetike dallon në shumë drejtime nga Fjala Hyjnore. Dallon për nga sintaksa, stili, terminologjia etj. Hadithet përbëjnë një letërsi më vete. Po ashtu edhe shkenca e njojjes së hadithit është bërë shkak që të lindin disiplina të ndryshme akademike apo letrare, si: shkenca e fikhut të hadithit, shkenca e fjalorit të huaj të haditheve, shkenca e termilogjisë së hadithit, shkenca e njojjes së transmetuesve, shkenca e komentimit të hadithit etj.

Edhe për përkthimet e haditheve të bëra në gjuhë të ndryshme të botës, mund të bëhet fjalë për një letërsi të caktuar, si pasojë e ekuilibrit që ndiqet për t'u përkthyer mes të qëndruarit besnik të tekstit dhe të përshtatjes në gjuhën që përkthehet.

## 3.1. LETËRSIA E MEVLUDEVE

Një prej pasurive më të mëdha letrare në këtë fushë, është edhe përpjekja e njerëzve me shije të holla artistike dhe me shpirt të madh mistik, të cilët kanë sjellë letërsinë e të përshkruarit në vargje të jetës së Profetit Muhammed (a.s.), që ndryshe njihen edhe si kultura e Mevludeve.

# Xhamia e Kordovës

Kordova i meriton titujt e saj si "nusja e qyteteve" dhe "thesari i shekullit X". Kordova ishte qyteti i fabrikave dhe i punishteve, që tërroqji shumë dijetarë dhe prodhoi dijetarët e saj. Ai ishte qyteti i parë me drita nëpër rrugë në gjithë Evropën. Ai u bë i njohur si pishtari i nxënies dhe i qytetërimit, në një kohë kur normanët kishin shkatërruar Parisin dhe Anglia ishte plaçkitur nga danezët dhe vikingët. Krenaria e saj ishte xhamia e saj e mrekullueshme, që është ndërtesa më e njohur e Spanjës, pas pallatit Alhambra në Granada.

Themelet e xhamisë u ndërtuan nga Abdurrahmani I në vitin 785 në vendndodhjen e një kishte të vjetër kristiane. Që nga koha e pushtimit në vitin 711, kisha ishte përdorur nga myslimanët dhe nga të krishterët. Myslimanët e blenë kishën, për shkak të rritjes së popullsisë në atë kohë dhe jo për shkak të mungesës së tolerancës fetare. Ajo u zgjerua ndërmjet viteve 832-848, pastaj në vitin 912 dhe kryesisht në vitin 961, nga Hakimi II, me mihrabin e saj të mrekullueshëm. Në vitin 987, el-Mansuri dyfishoi hollin e faljes, që u bë me 600 kolona. Në vitin 1236, pasi Kordova ra në duart e Ferdinandit III të Kastiljes, brenda saj u ndërtuan kishëza dhe në vitin 1523, në qendër të xhamisë u ndërtua një katedrale. Thuhet se Mbreti Çarls V ka thënë pasi ka parë katedralen e re: "Po ta kisha ditur se çfarë ishte, nuk do të kisha lejuar të prekej e vjetra, sepse ju po bëni atë që ekziston në shumë vende të tjera dhe keni prishur atë që është

unike në botë". Ashtu si mund ta shohim sot, pavarësisht nga kundërshtimi i qeverisë spanjolle për projektin e UNESCO's për ta zhvendosur katedralen ashtu si është, pa përjashtuar as detajin më të vogël (si tempullin e Ebu Simbalit në Egjipt), Xhamia e Kordovës pasqyron akoma më së miri imazhin e artit mysliman.


Problemi praktik me të cilin u përball arkitekti i xhamisë së Kordovës për ndërtimin e një dhome të madhe për një komunitet të madh, ishte ngritja e çatisë së oratorit në një lartësi në përpjesëtim me zgjerimin e ndërtësës, në mënyrë që të mos ekzistonte ndjenja që kemi kur hyjmë në një parking nëntokësor. Shtyllat antike nuk ishin të mjaftueshme. Ishte e nevojshme që ato të shtoheshin dhe shembulli i Damaskut sugjeroi pasazhe në dy nivele. Por modeli i Kordovës ka një tipar të habitshëm: pasazhet e poshtme dhe të sipërme nuk janë pjesë e murit, por ulen tek shtyllat dhe harqet e tyre pa ndërtim të ndërmjetëm. Harqet e sipërme që mbajnë çatinë, mbështeten në të njëjtat kolona ku mbështeten harqet e poshtme. Ky koncept, pa precedent në historinë e arkitekturës dhe unik në xhaminë e Kordovës, është një sfidë reale për peshën dhe inercinë e gurëve.

Për të krijuar një tablo më të saktë për imazhin që shkakton kjo arkitekturë, le të themi se vijat e lakuara të të dyja radhëve të harqeve ngrihen si gjethet e palmave të të njëjtë trung, që qëndron mbi një shtyllë relativisht të hollë,

pa pasur ndjesinë se është shumë e rëndë përtë. Harqet me format e tyre dhe ngjyrat e ndryshme, kanë një fuqi zgjeruese që largon çdo sugjerim peshe. Kjo shprehje me terma statikë të një realiteti që shkon përtëj planit material, ekziston falë planit të harqeve. Harqet e ulëta zgjaten përtëj formës së një gjysmërrethi, ndërsa harqet e sipërme janë më të hapura dhe gjysmërrethore.

Shumë arkeologë kanë sugjeruar se ky ndërtim i harqeve, i përdorur nga arkitekti i Kordovës, u frymëzua nga kanali romak në Merida. Megjithatë, mes tyre ekziston një ndryshim rrënënjesor. Arkitekti romak kishte respektuar logjikën e gravitetit, pjesa mbështetëse e ndërtesës duhet të jetë në përpjesëtim me peshën, pra harqet e sipërme duhet të jenë më të lehta sesa elementet mbështetëse. Për arkitektin e Kordovës dhe në përgjithësi përtë gjithë arkitekturën islamë, një rregull i tillë nuk funksionon. Po përsë?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje duhet të largohemi nga faktoret teknikë drejt shprehjes simbolike të hapësirës në faljen myslimanë, që ishte faktori kryesor që e shqetësonte "mjeshtrin" e Kordovës. Qëllimi nuk ishte arritja e një vepre të madhe arkitekturore, por krijimi i një hapësire të përshtatshme për besimtarët. Kufijtë e hapësirës nuk luajnë asnjë rol; muret e holli të faljes zhduken përtëj serisë së pasazheve. Përsëritja e tyre (në xhaminë origjinale kishte rrëth 900 prej tyre), të jepte përshtypjen e zgjerimit të pafund. Këtu hapësira nuk përcaktohet nga kufijtë e saj, por nga lëvizja e pasazheve, nëse mund të përshkruhet si lëvizje.



Ky zgjerim është i fuqishëm, por në realitet i pëlavizshëm. Titus Burckhardt e përshkruan këtë si "art logjik, statik objektivisht, por asnjëherë antropomorf".

Për këtë mihrab të mrekullueshëm, që është kryevepra e artit të Kordovës, i detyrohem i Hakkimit II, gjithashtu i detyrohem i duke përfshirë themellet e tyre në pasazhet e gërshetuara.

Pjesa kryesore e këtij mihrabi, që është shumë i thellë, rrëthohet në pjesën e sipërme nga një hark, që është si një vegim dhe burim drite, prej së cilës duket se zgjerohet vija e lakuar, si një kraharor që thith ajrin e pafundësisë. Si pas spiritualitetit më të lartë mysliman, bukuria është një prej "shenjave" që ndjell praninë hyjnore. Mbishkrimi mbi simfoninë e ngjyrave, me shkrim kufi, deklaron njëshmërinë e Zotit.


Xhamia e Kordovës është mishërimi i mesazhit universal islam.

Dituria filozofike dhe shkencore e andaluzianëve shkoi përtëj Pirenejve, përtë ujitur kuillotat e thata të jetës intelektuale evropiane. Studentët e Evropës perëndimore frekuentojnë bibliotekat dhe universitetet e ngritura nga myslimanët në Spanjë. Kjo ndryshoi mendjen evropiane dhe nuk është e tepërt të themi se qytetërimi perëndimor i detyrohet për ringjalljen e tij, energjisë intelektuale të çliruar nga Islami. Kësaj periudhe rigjallërimi, që filloi në Firence, në Itali në shekullin e XVI, perëndimi i referohet si Rilindja. Ajo ishte rezultati direkt i një Rilindjeje tjetër evropiane, që filloi në universitetin e Kordovës në Spanjë në shekullin e IX-të. Kjo e

vërtetë e thellë e historisë sonë të përbashkët, bëhet e qartë kur dimë si ta dëgjojmë muzikën e gurëve të Kordovës. Megjithatë, ekziston një ndryshim rrënjosor mes dy "rilindjeve"; ajo që filloj në Kordovë bazohej mbi besim dhe ishte e vetëdijshme për universalitetin e hyjnores; ajo që filloj në Firence ishte kundër Zotit dhe projekti i saj thelbësor ishte shekullarizimi i të gjitha aspekteve të jetës.

Arsyet që çuan në zhdukjen e rilindjes së Kordovës që lindi nga Islami, mund të kuptohen më mirë duke iu referuar shkaqeve të suksesit të tij. Islami i detyrohej për suksesin e madh Kuranit dhe Sunetit të profetit Muhammed (a.s.). Forca aktive e sistemit u neutralizua, apo myslimanët filluan ta konsiderojnë Kuratin si një traktat mbi dogmat dhe sunetin thjesht si një sistem ligjesh pa ndonjë kuptim të gjallë. Në "Mukaddime", Ibn Hal-duni dënon metodat e edukimit të praktikuara nga disa prej fukahave të Andaluzisë, duke thënë se në vend që ta ndihmonin nxënësin të kuptonte përbajtjen e librit me të cilin po punonte, ata e detyruan atë ta mësonte përmendsh.

Shkolla maliki e mendimit mbizotëronte në Andaluzi, deri në atë pikë, saqë asnjë medhheb tjetër nuk mësohej dhe, të dije përmendsh "Mu-vatta" e Imam Malikut dhe komentet, mjaftonte që një fakih të konsiderohej si dijetar i shquar. Mbyllja e derës së ixтиhadit (gjykimit të paravar), që do të ishte dënuar nga vetë Maliku, nëse do ta shihte një gjë të tillë, u nxit nga pjesa më e madhe e drejtuesve në Andaluzi, sepse nënkupton një bindje pa kushte të pushtetit



të shpallur. Kjo çoi në një degjenerim intelektual dhe trajtimi i personave të shquar që përmendëm më lart, e tregon këtë. Ibn Masara u detyrua të mërgonte. Ibn Hazmi u dëbuia nga Majorka. Librat e Gazaliut u dogjën. Biblioteka universale e Hakimit II u hodh në lumë. Ibn Tu-fajl dhe Ibn Rushdi u dëbuan si dhe Ibn Arabi. Të gjitha këto nuk u kryen nga të krishterët, por nga vetë myslimanët! Këto ishin shenjat se kjo strukturë e madhe, e përfaqësuar nga Islami, kishte arritur në një etapë ku vitaliteti i brendshëm po thahej dhe një shpërthim i fuqishëm mund ta shkulte nga toka ku kishte jetuar për shekuj me radhë.

Çlirimtarët e hershëm në Spanjë kishin një mision që e bënte të pamundur që ata të ishin egoistë, mizorë apo jo-tolerantë. Në atë çast që kjo u humb nga pasardhësit e tyre, fryma e tyre e klanit e zëvendësoi unitetin e tyre të qëllimit. Njëherësh ekziston deri në 12 dinasti. Ky ishte sinjal i dështimit. Shoqëria myslimanë filloj të përfaqësonte një rend social dekadent, që nuk mund të kishte rritje dinamike dhe pa kapacitet për rezistencë

efektive. Në këto rrethana, është e vështirë që një shoqëri t'i mbijetojë një kërcënim serioz të jashtëm. Sundimi mysliman në gadishullin Iberik filloj të zmbrapsej, për shkak të tradhtisë së disa princërve myslimanë, derisa Granada ra në duart e kryqtarëve, më 2 janar 1492.

Kur mbreti i fundit i Granadës, Ebu Abdullah, shikoi Alhambrën për herë të fundit, sytë iu mbushën me lot. E ëma e tij i tha: "O Ebu Abdullah, qaj si grua për një mbretëri që mund ta mbronit si burra".

# *Historiku i ndërtimit të Qabes*

**Q**abja e bekuar zë një vend të rëndësishëm në fenë islamë dhe konsiderohet si një ndër simbolet kryesore të saj. Kjo ndodh për shumë arsy. Pa dashur të vendos numra, po paraqes disa prej tyre në mënyrë që lexuesi ta kuptojë sadopak vlerën e kësaj shtëpie shekullore, për të cilën i Madhi Zot na tregon: **"Me të vërtetë shtëpia e parë e caktuar (për adhurim dhe lutje) për njerëzit është ajo në Bekë (Mekë)..."** [Ali Imran, 96.]

Kjo tregon se ekzistanca e këtij tempulli, ku adhurimi kryhet vetëm pér të Madhin Zot, ka qenë i pranishëm qysh para krijimit të njerëzimit, me qëllim që fajtorët të kërkojnë në të faljen e gabimeve nga Zoti i tyre, siç do ta shohim dhe nga historiku i ndërtimit të saj.

Qabja, Shtëpia e Shenjtë, është një lloj dualizmi i Shtëpisë Mamur (Bejtul Mamur), e cila gjendet në qellin e shtatë, pikërisht sipër Qabes, në të cilën futen çdo ditë shtatëdhjetë mijë melekë pér adhurim, e kurri nuk dalin, nuk kthehen më po të njëjtët, por futen gjashtëdhjetë mijë të tjerë.

Në këtë shtëpi kanë bërë haxh të gjithë pejgamberët e Zotit, siç tregohet nga një thënie e pejgamberit. Megjithatë, personi i cili të vjen menjëherë në mendje, sapo tëpermendësh Qaben, është pejgamberi Ibrahim, alejhi

selam, kjo, jo pa qëllim, por sepse ai, pasi e rindërtoi atë në themel e saj ekzistuese bashkë me Ismailin, ishte edhe i pari që i ftoi të gjithë njerëzit të kryenin adhurimin e Haxhit, i urdhëruar pér këtë gjë nga Zoti i Madhëruar: "Dhe thirri njerëzit pér haxh..." [Haxh, 27.]

Ibrahimini njihet si babai i Pejgamberëve, ngaqë shumë Pejgamberë, ndër ta: Jakubi, Jusufi, Davudi, Sulejmani, Musai, Isai dhe Muhamedi, paqja qoftë mbi të gjithë ata, rrodhën nga Ishaku dhe Ismaili, dy djemtë e Ibrahimit. Me njohjen dhe respektin që myslimanët i bëjnë Shtëpisë së Shenjtë, ata njëkohësisht nxjerrin në pah edhe lidhjen e ngushtë që ekziston mes fesë së praktikuar nga Ibrahimi dhe pejgamberët e tjerë, me fenë Islame, gjë që tregon se Islami nuk është një fe e re, e cila u shpall në shekullin e gjashtë në Gadishullin Arabik. Islami është vazhdimësi e feve të mëparshme, i cili është dhe revealata e fundit pér mbarë njerëzimin. Qabja është simboli që i fton të gjithë njerëzit të drejtohen vetëm tek ajo pér haxh, adhurim dhe lutje, duke iu përgjigjur kështu thirrjes së Ibrahimit.

Feja Islame e ka ligjëruar haxhin (vizitën), tavafin dhe drejtimin në falje, vetëm drejt Qabes, e cila është njëkohësisht edhe simboli i monoteizmit.

Përveç këtyre arsyeve, Shtëpia e Lashtë ka një pozitë të veçantë në zemrën e çdokujt. I Madhi Zot na tregon se Qaben e ka bërë magjepsëse, vend sigurie dhe qetësie.



Njerëzit mezi presin të shkojnë atje, megjithatë, dëshira për të shkuar është vazhdimisht e pashtershme, e kurrë nuk të neveritet, nëse shkon me qëllimin e bindjes ndaj ftesës së Zotit për Haxh ose Umre (vizita e Qabes jo në kohë Haxhi). Për një ndjenjë të tillë mund të flasë çdokush që e ka provuar, qoftë dhe një herë të vetme.

Duke i anashkaluar mendimet e shumta, të cilat flasin për numrin e ndërtimeve dhe riparimeve të Qabes, do të përmendim detajet më të rëndësishme.

Të parët që e kanë ndërtuar Qaben janë melekët. Për këtë shkak, Ali bin Husejn, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, tregon se, kur Allahu u tha melekëve se do të vendoste në tokë njerëzit, ata, të nisur nga veprimet gjakderdhëse të xhinëve, iu përgjigjën: "O Zoti ynë, a do të vendosësh në tokë ata që do të bëjnë shkatërrime dhe gjakderdhje?" Kur panë se Allahu u zemërua me ta, filluan të kérkonin falje duke ardhur përreth Arshit të Tij, tri orë a shtatë rrotullime për të kérkuar kënaqësinë e Zotit të tyre. Allahu u kënaq me një gjë të tillë dhe u tha: "Ndërtoni në tokë një shtëpi, ku të kérkojë mbrojtje nga dënimimi im çdokush ndaj të cilit jam i mërzitur, siç vepruat edhe ju me Arshin e ta fal ashtu siç ju fala dhe ju."

Pas melekëve e ndërtoi Qaben Ademi, alejhi selam.

Ibn Abasi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, për shkak të ndërtimit të Qabes nga Ademi, alejhi selam, tregon se, kur Allahu e zbriti Ademin në tokë, ky tha: "O Allah, pse nuk po i dëgjoj më zërat e melekëve?"

Allahu i përgjigjet. "Për shkak të gjynaheve të tua, o Adem, por shko dhe ndërto një shtëpi e bëj tavaf rrëth saj, ashtu siç i pe melekët duke bërë tavaf rrëth Arshit tim. Kështu Ademi, alejhi selam, e ndërtoi Qaben, pasi Xhibrili me krahun e tij, i zbuloi themelat e saj dhe melekët hodhën në të gurë aq të mëdhenj, saqë nuk i mbanin dot tridhjetë burra.

Pas Ademit e rindërtuan bijtë e tij, por ne do të ndalemi pak në rindërtimin e katërt, të cilin e ka bërë Ibrahimim me djalin e tij, Ismailin, paqja qoftë mbi ta. Në tregimin e gjatë për historikun e ujit të Zemzemit, tregohen vizitat që pejgamberi Ibrahim i bënte Ismailit. Më poshtë po vazhdojmë me një vizitë tjetër, e cila ishte edhe shkaku i rindërtimit të Qabes: "... pastaj qëndroi larg tyre për


një kohë sa dëshiroi Allahu dhe, pas kësaj, ai i vizitoi ata. Ai e pa Ismailin nën një pemë pranë Zemzemit, duke mprehur shigjetat e tij. Kur ai e pa Ibrahimin, u ngrit ta mirëpriste atë (dhe përshëndetën njëri-tjetrin siç bën babai me të birin dhe i biri me babanë e tij). Ibrahimimi tha: "O Ismail, Allahu më ka dhënë një urdhër." Ismaili tha: "Bëj çfarë të ka urdhëruar Zoti yt, të bësh." Ibrahimimi e pyeti: "A do të më ndihmosh ti?" "Po, - tha Ismaili, - unë do të të ndihmoj." Ibrahimimi tha: "Allahu më ka urdhëruar të ndërtoj një shtëpi këtu, duke bërë me shenjë drejt një kodrine më të lartë sesa vendi përreth saj."

Pejgamberi alejhi selam shtoi: "Pastaj ata ngritën themelat e Shtëpisë (Qabes). Ismaili sillte gurët, ndërsa Ibrahimimi po e ndërtonte dhe, kur muret u ngritën lart, Ismaili solli këtë gur dhe ia dha Ibrahimit, i cili qëndroi mbi të dhe vazhdoi ndërtimin. Ismaili i jepte në dorë gurët dhe që të dy vazhdonin të thoshnin: "Zoti ynë pranoje këtë prej nesh, vërtet, Ti je Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri." [Bekare,127.]

Guri i madh, të cilin ia ofroi Ismaili, është guri ku edhe sot e kësaj dite duken gjurmët e Ibrahimit. Deri në kohën e Omerit, ky gur ka qenë afër murit të Qabes, por kur njerëzit që bënë tavaf u shtuan dhe guri i pengonte Omeri dha urdhër të vendoset aty ku gjendet edhe sot. Për sa i përket Gurit të Zi, i cili tregon edhe pikënisjen e fillimit të rrotullimit rrëth Qabes, thuhet se ai ka qenë më i bardhë se qumështi, por për shkak të mëkateve të njerëzve është nxirë. Këtë gur, të ardhur nga xheneti, meleku Xhibrili ia solli Ibrahimit, alejhi selam,

kur e përfundoi ndërtimin e Qabes.

Kur Muhamedi, alejhi selam, më pas i Dërguari i Allahut, ishte tridhjetë e pesë vjeç, Kurejshët vendosën të ndërtojnë Qaben, e cila gjë atëherë ishte një grumbull gurësh në një truall paksa të ngritur. Ishte e lartë nënëtë arshin (6.30 m), që nga koha e Ismailit, alejhi selam. Nuk kishte kulm (çati) dhe disa hajdutë kishin vjedhur prej saj një arkë ari, e cila në atë kohë ndodhej brenda këtij grumbulli. Për shkak të traditës së vet dhe vlerës së madhe historike, si dhe të ndërtimit që i bëri Ibrahimimi alejhi selam, Qaben gjithnjë e kanë vizituar të gjithë kallimtarët e Mekës. Ndodhë që shumë prej tyre të merrnin me vete nga një copë dhé apo gur, si simbol shenjtërie



apo bereqeti (veprim i ndaluar ky). Pesë vjet para pejgamberisë së të Dërguarit, alejhi selam, Qabja përmbytet nga shpërthimi i pendës Arem. Kurejshët u frikësuan, sepse Qabja ishte gati të rrënohej, prandaj vendosën ta rindërtonin, duke i ruajtur themelet dhe vendin e saj të mëparshëm. Vendosën ta ndërtonin vetëm me pasurinë e fituar në mënyrë të ndershme, pa përzierje të kamatës, ryshfetit, të hollave të vjedhura dhe të plaçkitura. Ata frikësosheshin t'i rrëzonin mbetjet ekzistuese të Qabes. Këtë e filloj Velid bin Mugire Mahzumi e të tjerët pas tij, kur panë se Velidit gjatë pastrimit nuk i ndodhi asgjë e keqe. Pasi e rrëzuan Qaben gjer në themelet që i kishte ndërtuar Ibrahimini, alejhi selam, përpiluan edhe planin e ndërtimit të saj. Çdo fisi i caktuan sasinë e gurëve që do të sillnin dhe pjesën e murit që do të ndërtonin, kështu, të gjithë ishin pjesëmarrës në ndërtim. Sollën një ndërtues romak, të quajtur Bakum, dhe ndërtimi shkoi sipas planit, derisa erdhën në lartësinë e vendit ku duhej vendosur haxherul-esvedi (guri i zi). Çdo fis e konsideonte veten të privilegjuar, që këtë punë të ndershme ta bënte ndonjëri prej tyre. Grindja mes tyre zgjati katër apo pesë ditë dhe kanosej reziku që të shpërthente një përleshje e përgjakshme rreth tempullit të Shenjtë, në tokën e Shenjtë. Në tërë këtë rrëmuje, më i maturi ishte Ebu Umeje bin Mugire Mahzumi, i cili dha këtë propozim: Personi i parë, i cili do të paraqitet në dyert e Haremit të Qabes, le të vendosë dhe të zgjidhë këtë problem.

Desh Allahu që ky person të jetë Muhamedi, alejhi selam. Kur e panë, brohoritën "El-Emin El-Emin" (ngaqë ishte i njohur me këtë ofiq, që do të thotë: i besueshmi, besniku), jemi të kënaqur që ky të vendosë.

Kur i Dërguari i Allahut, alejhi selam u afrua më afër, ata ia parashtruan çështjen dhe kërkuan zgjidhje nga ai. I Dërguari i Allahut, alejhi selam, kërkoi një copë pëlburë, e shtriu në tokë dhe në mes të saj vuri "Gurin e Shenjtë", pastaj u tha kryetarëve të fiseve të ngatërruara që të afroheshin, të kapnin nga një cep të pëlburës dhe të gjithë së bashku ta ngrinin "Gurin e Shenjtë" gjer te vendi ku do të vendosej. Pastaj i Dërguari i Allahut, alejhi selam, e mori atë me duart e veta dhe e vendosi ku duhej. Me këtë veprim të mirë ishin të kënaqura të gjitha palët.

Kurejshëve u harxhohej pasuria e pastër (hallall) për ndërtim, prandaj nga ana veriore ndërtuan murin në lartësi prej gjashtë arshin, sot i quajtur muri Hatim apo muri i gurit. Në këtë mur bënë derën dhe e ngriten nga toka që të mos hynte në Qabe kush të donte, por vetëm ai, të cilit i lejohej. Kur ndërtimi i Qabes arriti lartësinë pesëmbëdhjetë arshin, bënë plafonin e mbështetur në gjashtë shtylla. Me këtë ndërtim Qabja mori trajtën e vet katrore (duke mos e përfshirë të tërë sipërfaqen e ndërtuar që nga Ibrahimini), me përmasa përafërsisht të njëjtë. Lartësia është përafërsisht pesëmbëdhjetë metra, gjatësia e murit, në të cilin është Guri i Zi, është dhjetë metra, sikurse edhe muri tjetër kundruall tij. Guri i Zi

gjendet në lartësi prej 1.5 metra nga themelet ku bëhet tavafi. Muri ballor, në të cilin gjendet dera, është i gjatë dympëdhjetë metra, sikurse edhe ai kundruall tij. Dera e Qabes është e vendosur në lartësi dy metra nga toka. Nga ana e jashtme, Qaben e rrëthon rrëthi i gurëve në lartësi njëzet e pesë centimetra e në gjerësi tridhjetë centimetra.

Në realitet, këto janë blloqe gurësh nga godina e parë, të ruajtura në këtë mënyrë. Për një kohë të gjatë njerëzit u mësuan me këtë formë të Qabes, e cila nuk ishte e plotë. Nisur nga ky fakt, Pejgamberi Muhamed, alejhi selam, i thotë Aishes se, nëse populli nuk do të ishte i ri në Islam (për ta kuptuar të vërtetën), do të urdhëroja që të rindërtohej Qabja në formën e ndërtuar nga Ibrahimini. Nisur nga ky fakt, dhe nga shkatërrimi i Qabes që ndodhi në kohën e Abdullah bin Zubejrit, ky i fundi e rindërttoi, në vitin 65 sipas Hixhrit, Qaben në themelet e Ibrahimit.

Mirépo Qabja u ndërtua edhe një herë pas tij, në atë mënyrë që e ndërtuan Kurejshët, duke mos e ditur se si ishte e vërteta. Kur e dëgjoi mbreti i asaj kohe, deshi ta rindërtonte të plotë, por dijetari Malik bin Enes e ndaloj, duke pasur frikë se mos kthehej Qabja në një ndërtesa që e prish një mbret dhe e ndërton një tjetër. Aktualisht Qabja mbetet në përmasat që u ndërtua nga Kurejshët pesë vite para pejgamberisë.

Qabja pësoi sërisht një shkatërrim të pjesshëm në kohën e sulltan Muratit, ngaqë për shkak të një vërvshimi të ujit ishte rrëzuar muri nga Shami, muri nga Lindja deri tek dera dhe nga perëndimi rreth 2/3 e murit. Sulltan Ahmed, i biri i sulltan Muratit, shpenzoi për ndërtimin e saj tetëdhjetë mijë dinarë. Kjo ndodhi në vitin 1020 sipas hixhrit.

Qabja mbulohet me një pëlburë, e cila i ndërrohet çdo vit në periudhën e Haxhit, si dhe lyhet me erë të mirë.

Ambienti i xhamisë (jo ndërtesa në formë katrore) është zgjeruar vazhdimesh në varësi të shtimit të nevojave të besimtarëve.

Sot, Xhamia e Shenjtë ka:

Sipërfaqe ndërtimore: 202.000 m<sup>2</sup>

Sipërfqaqe e oborreve: 61.000 m<sup>2</sup>

Sipërfaqja e përgjithshme: 40.000 m<sup>2</sup>

Numri i besimtarëve që mund të falen njëherësh: 695.000

Numri i minareve: 9

Lartësia e minareve: 89 metra

Numri i shkallëve të zakonshme: 11

Numri i shkallëve lëvizëse: 5

Sistemi i ajrimit të kondicionuar, me kapacitet: 40.000 tonë.

"Kibla", pika e drejtimit për të gjithë myslimanët, në jetë dhe vdekje. Falja e namazit në të ka vlerën e 100.000 namazeve në xhamitë e tjera.



# Kur koha bën të vetën në martesë...



## TË DUA

**Java e 6-të:** Të dual!

**Muaji i 6-të:** Normal që të dua.

**Viti i 6-të:** Sikur mos të të kisha dashur, do të të braktisja me kohë.

## NË TELEFON

**Java e 6-të:** E dashur, po të kërkon motra në telefon.

**Muaji i 6-të:** Po të thërrasin në telefon.

**Viti i 6-të:** Telefoononiiii.

## ARDHJA NË SHTËPI

**Java e 6-të:** Zemër, erdha unë!

**Muaji i 6-të:** Ç'kemi?

**Viti i 6-të:** Çfarë ka gatuar jot ëmë, more bir?

## FËMIJËRI

**Java e 6-të:** Paske kaluar një fëmijëri me të vërtetë të vështirë.

**Muaji i 6-të:** Kjo nëna jote, sa e çuditshme bëhet nganjëherë.

**Viti i 6-të:** Ja ke këputur kokën sat ëme.

## TROKET DERË

**Java e 6-të:** Mos u trazo, e hap vetë.

**Muaji i 6-të:** A ta hap unë derën?

**Viti i 6-të:** A po e hap atë derë, moj?

## PLAÑET PËR PUSHIME

**Java e 6-të:** Këtë verë do shkojmë bashkë jashtë shtetit.

**Muaji i 6-të:** Këtë verë po shkojmë në



Velipojë.

**Viti i 6-të:** Çu bë këtu , të rrimë në shtëpi një herë.

## DHURATAT

**Java e 6-të:** Shpresoj të të pëlqejë kjo unazë.

**Muaji i 6-të:** Mora një kornizë fotografish, ndoshta na duhet ndonjëherë.

**Viti i 6-të:** Merri këto para e blej ç'të duash.

## NDARJET E MENDIMEVE

**Java e 6-të:** Unë nuk jam fort i këtij mendimi.

**Muaji i 6-të:** Nuk mendon ashtu siç duhet.

**Viti i 6-të:** Mos fol marrëzira, pash Zotin!

## USHQIMET

**Java e 6-të:** Kënaqem me këto ushqime, të lumshin duart!

**Muaji i 6-të:** Çfarë do të hamë sonte?

**Viti i 6-të:** Përsëri makarona?

## RROBAT DHE BLERJET

**Java e 6-të:** Ky fustan të shkon shumë.

**Muaji i 6-të:** Ke blerë përsëri fustan tjetër?

Viti i 6-të.: Sa e more këtë?

## KËRKOJ FALJE

**Java e 6-të:** S'bëre gjë, që të kërkosh falje.

**Muaji i 6-të:** Ki kujdes pak më tepër!

**Viti i 6-të:** Dërr vërr, s'di gjë tjetër!



## Superbrokoli kundër kancerit

Shkencëtarët kanë arritur të zhvillojnë një "superbrokoli", i cili mund të luftojë më me efikasitet disa lloje të kancerit dhe disa sëmundje të zemrës dhe të damarëve.

Shkencëtarët e Qendrës John Innes dhe të Institutit të kërkimeve ushqimore Norwich në Anlgji, arritin që tek brokoli normal të shtojnë materiale natyrore dhe të dobishme për shëndetin.

Në vitin 1983, shkencëtarët gjetën tek brokoli i egër sasi të mëdha glukorafanine. Duke u nisur prej kësaj, shkencëtarët zhvilluan një lloj brokoli që i ngjan brokolit normal, por që përmban 2-3 herë më shumë glukorafaninë dhe e quajtën "beneforte". Gjithashtu, studiuesit theksuan se tek *beneforte* është shtuar 2-4 herë më shumë edhe lënda e sulforafanit.

Superbrokoli është hedhur për konsum të përditshëm në tregun anglez dhe këshillohet që të përdoret duke u zier pak ose duke u skuqur lehtë.

Kur glukorafanina vjen në kontakt me mikroorganizmat që ndodhen në sistemin e tretjes, ka aftësinë që të aktivizojë sulforafanin, që ndodhet tek brokoli dhe tek perimet e tjera

të së njëjtës familje. Ndërsa nga disa studime që janë bërë më parë, është vërtetuar se sulforafani ka ulur disa infeksione kronike dhe ka luftuar me disa lloje kanceresh.



## Ushqimet që heqin erën e keqe të gojës

Në 87% të rasteve, era e gojës shkaktohet nga infeksionet e gjuhës dhe mishit të dhëmbëve. Këto raste mund të diagnostikohen shumë lehtë nga doktori. Por era e gojës mund të jetë edhe lajmëtare e disa sëmundjeve, si sinusiti, infeksione të mushkërive, diabeti, mosfunkcionimi normal i veshkave, çrrëgullimi i metabolizmit trupor etj.

Për të parandaluar erën e gojës, në radhë të parë këshillohet konsumimi i disa ushqimeve:

**Limoni:** Limoni është shumë efikas ndaj erës së gojës. Merret një limon dhe, pasi të pritet në gjysmë, të thithet. Limonin mund ta përdorim edhe me ujë mineral. Që të jetë edhe më praktike, mund të konsumohen edhe karamele me aromë limoni.

**Majdanozi dhe Rozmarina:** Majdanozi ka aftësinë që të freskojë frymën. Bashkë me të, për të qenë edhe më efikase, mund të përdoret edhe rozmarina.



**Molla, dardha, karrota, rrepa:** Këto janë disa nga perimet që janë shumë efikase në ruajtjen e freskisë së gojës. Në sajë të fibrave ushqimore që përbajnjë, pastrohet pështyma dhe në të njëjtën kohë lënë një shije të ëmbël në gojë.

**Mendra dhe kanella:** Mendra është një bimë shumë efikase në pastrimin e erës së gojës. Sidomos nga era e hudhrës dhe e qepës. Ndërsa vaji që ndodhet në lëvoren e kanellës, luan rol në eliminimin e bakterieve që ndodhen në gojë.

**Kosi:** Kosi ndihmon në eliminimin e erës së acidit sulfidik brenda të gojës. Në përgjithësi, ajo që e bën gojën të mbajë erë veze të prishur, është pikërisht acidi sulfidik. Kosin mund ta pasuroni dhe t'i jepni shije edhe me fruta që janë të pasura me vitaminë c.

## Kjo makinë skuq me ajër, jo me vaj



Për ata që duan të ushqehen me ushqime pa yndyrna, éshtë zhvilluar dhe nxjerrë në treg një mjet kuzhine, i cili, në vend të vajit, përdor ajrin.

Prodhimi i ri, i cili éshtë nxjerrë në treg nga firma e njojur Philips, mund të skuqë ushqime, pa përdorur vajin. Në sajë të një ventilatori të vogël dhe një zgare, nga çdo anë qarkullon ajër me një temperaturë shumë të lartë, i cili realizon skuqjen në mënyrë perfekte.

Sipas specialistëve të firmës, kjo makinë, e cila ka sjellë risi në kuzhinë, mund të skuqë patate, pulë, salçiçe dhe ushqime të tjera të ngjashme, pa përdorur, qoftë edhe një pikë vaj. Për arsy se skuqja realizohet me ajër, edhe ajri i shtëpisë nuk ndotet me aroma të padëshirueshme.

## Gjethja artificiale që prodhon energji

Studiuesit amerikanë, prodhuan një gjethje artificiale, e cila mund të mbledhë energjinë diellore dhe ta ruajë për një përdorim të mëvonshëm.

Sipas këtij studimi, i cili éshtë publikuar edhe në revistën *Science*, profesorët e universitetit prestigjioz amerikan, Massachusetts Institute of Technology (MIT), arritën të prodrojnë një gjethje artificiale, duke përdorur materiale katalitike dhe silic. Për ta vënë në punë, ajo s'ka nevojë për ndonjë qark elektrik apo ndonjë lidhje të jashtme.

Prof. Daniel, Nocera, i cili drejtton ekipin e studiuesve, tha se mjafton që gjethen ta vendosim në një gotë me ujë dhe ta lëmë të ekspozuar në diell. Pas pak, nga një anë e saj do të fillojnë të prodhohen bulëza oksigjeni, ndërsa nga ana tjetër do të prodhohen bulëza hidrogjeni.

Nëse gjethja vendoset në një vend me ujë, ku ka një ndarëse, e cila ndan të dyja anët e gjethes, bulëzat e oksigjenit dhe të hidrogjenit që prodhohen, mund të mblidhen dhe të ruhen për t'u përdorur më vonë. Kështu që bulëzat e oksigjenit dhe hidrogjenit, që mbushin baterinë, bashkohen



në ujë, duke prodhuar energji.

Studiuesit theksuan se disa materiale, me të cilat éshtë prodhuar kjo gjethje, si silici, kobalti, dhe nikeli, gjenden lehtë dhe me çmim të lirë dhe punojnë në ujë normal. Por disa materiale të tjera, të cilat përdoren për të ndarë oksigjenin dhe hidrogjenin nga rrezet e diellit, si solucionet korozive dhe platini, janë të kushtueshëm dhe të vështirë për t'u gjendur.

## Shqipëria mbetet jashtë statusit të kandidatit

Bllokimi i situatës politike në Shqipëri u cilësua nga Komisioni i BE-së si shkaku i mosplotësimit të kushteve për statusin e kandidatit.

Komisionari i BE-së për zgjerimin Füle, me keqardhje shpalli sot se nuk do të bëjë rekomandimin për dhënien e statusit të kandidatit për anëtarësim të Shqipërisë. Duke folur për Shqipérinë dhe Kosovën gjatë një seance të jashtëzakonshme të Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, ai si arsyë për këtë përmendi bllokadën politike, mungesën e dialogut dhe mospërparimin në fushën e reformave. Sidoqoftë, ai shprehu shpresën për fillimin e dialogut, mbështetur në disa shenja të para, siç tha. Në këtë rast Komisioni do të ishte i gatshëm të bënte të mundur një përfshirje më të shpejtë të Shqipërisë pa pritur për kalimin e një viti të plotë.

Ndërsa në Kosovë sfidë mbetet lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Duke folur për Kosovën, komisionari Füle tha se procesi i gjatë zgjedhor kishte si rrjedhojë që progresi i bërë dhe axhenda e reformave ishin të kufizuara. Megjithatë, in-

stitucionet e reja janë të përkushtuara ndaj perspektivës evropiane të Kosovës. Ato kanë prodhuar disa reforma fillostante. Sfida madhore mbeten kriminaliteti i organizuar dhe korrupsioni. Kosova duhet me çdo kusht të fuqizojë administratën publike. Reforma në drejtësi është një çështje që nuk pret. Komisioni propozon të niset një dialog i strukturuar me Kosovën mbi sundimin e ligjit, me qëllim që të trajtohen këto sfida.

Ndërkojë integrimi i serbëve të Kosovës është përmirësuar në jug, tensioni në veriun e Kosovës është rritur. Është e një rëndësie të jashtëzakonshme që Kosova të nisë një axhendë gjithëpërfshirëse për veriun. Ne do të vazhdojmë të mbështesim përpjekjet e Kosovës për të arritur synime kyç si marrëveshja tregtare dhe pjesëmarria në programet e Komunitetit, tha komisionari Füle. Për vizat do të nisë një dialog rreth fundit të këtij viti. Ne do të rishikojmë gjithashtu komunikatën tonë të vitit 2009 në mënyrë që të garantojmë se Kosova mund të përfitojë më tej prej procesit të anëtarësimit të Bashkimit Evropian, ka dekluaruar komisionari i BE-së për zgjerimin.

Pas negociatave, të cilat zgjatën disa vite, më në fund

## Shkëmbim historik midis Hamasit dhe Izraelit

Izraeli dhe Hamasi ranë dakord në lidhje me shkëmbimin e pengjeve. Sipas marrëveshjes së miratuar nga parlamenti i Izraelit, Hamasi në këmbim të njëmijë të burgosurve palestinezë do të lirojë ushtarë izraelit Gilad Shalit që u mor peng në vitin 2006. Mes të burgosurve palestinezë që pritet të liron, do të jetë edhe Mervan Barguti njëri prej liderëve koordinues të Al Fatahit që u dënuar 5 herë me burgim të përjetshëm. Burimet diplomatike turke njoftuan se lideri i Hamasit, Halid Meshal para arritjes së marrëveshjes në fjalë ka zhvilluar një bisedë telefonike me Ministrin e Jashëm turk, Ahmet Davutollu të cilin e informoi në lidhje me çështjen dhe falënderoi Turqinë për përpjekjet e bëra deri më sot për zgjidhjen e këtij problemi.

Sipas marrëveshjes së arritur mes palëve, u lirua ushtari izraelit, Gilad Shalit, i cili mbahej i burgosur prej 5 vitesh nga ana e Hamasit dhe 477 të dënuar palestinezë që dergjeshin nëpër burgjet e Izraelit. Gilad Shalit fillimisht iu dorëzua autoriteteteve egjiptiane nga Hamasi dhe pastaj u kthye në vendin e tij. Bëhet e ditur se



ushtari izraelit, i cili mbahej peng prej vitit 2006 e këtej, është në gjendje të mirë shëndetësore. Në një intervistë për televizionin shtetëror egjiptian, Gilad Shalit deklaroi se shpreson që marrëveshja për këmbimin e të burgosurve t'i shërbejë paqes ndërmjet dy palëve. Me anë të një helikopteri të forcave të armatosura izraelite Gilad Shalit kaloi në bazën ajrore Tel-Nof, ku është pritur nga afërmit e tij, Kryeministri Netanjahu dhe shumë autoritete izraelite. Ndërkaq u realizua edhe procesi i lirimt të 477 të dënuarve palestinezë, që mbahezin nëpër burgjet izraelite. Familjet e personave në fjalë, të cilat deri në çastin e fundit ndruheshin nga mundësia e anulimit të marrëveshjes, me fillimin e procedurës së lirimt u gëzuan pa masë. Në fazën e parë shumica e pengjeve të liruara do të kthehen në shtëpitë e tyre në Gazë dhe qytete

të tjera. Kurse 40 prej tyre do të deportohen drejt Turqisë, Sirisë dhe Katarit. Bazuar tek marrëveshja e sipërcituar, pritet që më vonëtë lironedhe 550 të burgosur të tjerë palestinezë.